

DITURIA ISLA ME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 426 • MAJ 2026



HAXHI – UDHËTIM SHPIRTËROR DHE SIMBOL I UNITETIT TË YMETIT

BASHKËJETESA NDËRFETARE – VLERË
IDENTITARE DHE NEVOJË E KOHËS SONË

DIMENSIONI SOCIAL
DHE EDUKATIV I HAXHIT

NORMAT E IHRAMIT DHE NDIKIMI I
TYRE NË PËRGATITJEN SHPIRTËRORE

FOTOGRAFI NGA CEREMONIA E NDARJES SË SHPËRBLIMEVE PËR FITUESIT NË GARAT E KURANIT NË NIVIVEL VENDI



EDITORIAL

- 4 Dogmatizmi s'mund të gjejë strehë tek Islami

FETARE

- 5 Hoxhë Sherif Ahmeti, një dijetar që jetoi për dije dhe me dije
Kumtesa e Myftiut Naim ef. Tërnavë në promovim të dy librave për dhe nga Sherif ef. Ahmeti
- 9 Bashkëjetesa ndërjetare – vlerë identitare dhe nevojë e kohës sonë
Fjala e Myftiut Naim ef. Tërnavë në tyrezën për bashkëjetesën ndërjetare
- 12 Haxhi – udhëtim shpirtëror dhe simbol i unitetit të ymetit
Rexhep ef. Sulejmani
- 15 Dimensioi social dhe edukativ i haxhit
Dr. Selatin Mehani
- 19 Të kuptuarit e haxhit përtej ritualeve
Maulana Vahiduddin Khan
- 22 Normat e ihramit dhe ndikimi i tyre në përgatitjen shpirtërore
Dr. Rijad Imeri
- 26 Kurbandi si akt adhurimi – analizë e normave dhe qëllimeve
Dr. Azmir JUSUFI
- 29 E drejta e besimit dhe e adhurimeve të jomuslimanëve në shoqërinë islame
Samir Gjonoviq
- 32 Krijimi i njeriut nga dheu – analizë ndërdisiplinore ndërmjet qasjes fetare dhe kimike
Mr. Njomza Sadriu



FAMILJE & EDUKIM

- 34 Përgjegjësia fetare dhe verifikimi i informacionit në epokën digjitale
Festim Rizanaj, PhD
- 37 Ndryshoje veten dhe fjalët tua para se ta ndryshosh botën!
Elfete Sinanaj

KULTURË


- 40 Nga kujtimet e mia studentore në universitetin mijërvajçar "Al Az'har"
Ejup Ramadani
- 42 Shteti laik dhe neutraliteti fetar në praktikën e jurisprudencës evropiane dhe Kushtetutës së Kosovës
Zyhdi Hajzeri
- 45 Malli që nuk harxhohet, shtohet
Anita Gërguri
- 47 Festa e Bajramit – traditë dhe përjetim shpirtëror në kulturën tonë
Ramadan Shkodra

REPORTAZH

- 49 Dija që lidh brezat – trashëgimia e gjallë e haxhi Sherif ef. Ahmeti
- 53 Myftiu Tërnavë qëndroi për vizitë zyrtare në Ankara

AKTIVITETE

- 59 U mbajtën Garat e memorizimit të Kuranit fisnik në vendet e Ballkanit



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 426 • viti 38 • Maj 2026
• Dhul Ka'de 1447
• Çmimi 2 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



Dogmatizmi s'mund të gjejë strehë tek Islami

“Ai që e filloi krijimin (e njeriut) e pastaj e përsëriti atë (e ringjall pas vdekjes) dhe Ai që ju furnizon nga qielli e toka. A mos ka zot tjetër pos Allahut? Thuaj: “Sillni argumentet tuaja, nëse jeni të sinqertë!”

(En Neml, 64)


Polarizimet ideologjike, skizmat që lanë gjurmë në rrjedhat historike, si dhe akuzat e ndërsjella për irracionalitet, kanë qenë gjithnjë prezente te pasuesit e feve dhe ideologjive të ndryshme njerëzore. Në këtë kontekst, edhe nocioni i dogmatizmit, që moti, është shndërruar në një etiketë diskredituese, e përdorur shpesh nga ithtarët e ideologjive dhe rrymave të ndryshme për t'ua mveshur kundërshtarëve të tyre, me synimin për t'i delegitimuar dhe për të krijuar epërsi për bindjet e veta. Edhe Islami, në kontekste të shpeshta historike, ka qenë objekt i këtyre etiketimeve, ndonjëherë nën pretekstin e debatit kritik, e shumë më shpesh si strategji diskredituese.

Në hulumtimin për domethënien eksplicite të nocionit dogmatizëm, te fjalori i Oxfordit e gjejmë se ai përvijohet si “bindje që besimet tua janë të sakta dhe se të tjerët duhet t'i pranojnë ato, pa u kushtuar vëmendje provave ose mendimeve të tjera.” Thënë ndryshe, dogma është: “Një bindje ose tërësi bindjesh të një grupi apo organizate, që kërkohet të pranohen pa debat.” (Oxford Learner's Dictionaries. “Dogmatic.”). Pra, kërkesa e një pasuesi të një feje a filozofie për përqafim të një koncepti a ideologjie të caktuar, nuk e bën atë dogmatik, por insistimi me ngulm se të njëjtat ide duhen pranuar pa debat dhe shoshitje të provave është vetë dogmatizmi. Nisur nga ky përkufizim, t'ia atribuosh Islamit dogmatizmin është shmangie e objektivizmit hulumtues dhe korrektësisë shkencore. Është kështu, ngase Vetë Allahu i Plotfuqishëm, në shpalljen e Tij të fundit-Kuran, në ajete të panumërta, nuk ndaloi së kërkuari nga besimtarët, madje edhe nga femohuesit, që ata të meditojnë në faktet vizuale në horizont e në vetveten e tyre, e të cilat shpijnë natyrshëm në besimin e çiltër në njëshmërinë e Tij. Ai xh.sh., në njërin prej tyre thotë: *“Ai që e filloi krijimin (e njeriut) e pastaj e përsëriti atë (e ringjall pas vdekjes) dhe Ai që ju furnizon nga qielli e toka. A mos ka zot tjetër pos Allahut? Thuaj: “Sillni argumentet tuaja, nëse jeni të sinqertë!”* (En Neml, 64). Ftesa hyjnore për të shpalosur e sjellë argumentet, nga pala femohuese që mohon krijim e universit nga Zoti, apo mundësinë e ringjalljes, nuk tregon për prirjen e Islamit që të dogmatizojë parimet e veta. Ajo më tepër tregon se cilado nga ato parime mund t'i nënshtrohen debatit të mirëfilltë racional e polemikës shkencore, nga i cili po të frikësohej Islami, kurrë nuk do të ftonte me kaq insistim në të. Kjo është metodologjia kuranore e konstatimit të të vërtetave e aksiomave të veta, e bazuar në meditim të thellë e analizë të gjatë racionale, e distancuar krejtësisht nga dogmatizmi autoritar.

E spikatur ishte pikëpamja e juristit e filozofit të mirënjohur islam, Ibën Rushdit, kur thoshte: “Nëse Sheriati është i vërtetë dhe na fton të mendojmë thellë për të arritur njohjen e së vërtetës, atëherë është e sigurt se arsyetimi racional i drejtë dhe i bazuar në argumente nuk mund të bie kurrë në kundërshtim me atë që ka shpallur Zoti”. (Ibën Rushd, Fasl el mekal ve takrir ma bejne esh sheriati ve-l hikmeti min el it-tisal, 35). Islami nuk e legjitimon besimin e verbër, as pasimin pa dije-argument, por nxit vështrimin kritik dhe ndërlihd besimin me arsyeshmëri racionale. Prandaj, ai është më afër një racionaliteti të udhëzuar e të ndihmuar nga shpallja hyjnore, sesa që mund t'i atribuohet atij ndonjë dogmatizëm i mbyllur e rixhid.

Shikuar realisht, ideologjitë moderne shpesh ftojnë më me ngulm sesa vetë feja, për përqafimin të teorive të tyre relative, të cilat edhe i kanë shndërruar në dogma. Shumë filozofë, si K. Popper dhe Th. Kuhn e të tjerë, kanë paralajmëruar se shkenca, kur refuzon kritikën dhe mbyllet ndaj alternativave, mund të marrë tipare dogmatike, duke e larguar atë nga natyra e saj kërkimore dhe kritike. Andaj, dogmatizimi i shkencës ndodh, jo kur ajo praktikohet si metodë kërkimi, por kur shndërrohet në ideologji që pretendon monopolin e së vërtetës. Historia e shkencës tregon se edhe teoritë më të pranuar në ndonjë kohë, janë rrëzuar pas shoshitjes në dritën e provave e argumenteve të patundshme, çka dëshmon se absolutizimi i tyre, edhe atëherë edhe sot mbetet i pajustificuar.

Mr. Driton Arifi



Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në promovimin e librit të haxhi Sherif ef. Ahmetit, “Akaidi Islam – parimet, zhvillimi dhe shkollat”

Haxhi Sherif ef. Ahmeti, një dijetar që jetoi për dije dhe me dije

Inderuar reis i BFI-së së Maqedonisë së Veriut, hafëz Shaqir ef. Fetahu, me bashkëpunëtorë,

E nderuar familja e myderrizit tonë të nderuar h. Sherif Ahmeti,

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Te nderuar efendilerë, profesorë,

Te dashur studentë,

Zonja dhe zotërinj,

IMadhi Zot xh.sh., në Kuranin fisnik, ndër të tjera thotë: “..
se Allahu do t’i ngrëjë në shkallë të lartë ata midis jush që

besojnë dhe që u është dhënë dija. Allahu di çdo gjë që punoni.” (El Muxhadele, 11).


Ngritja në shkallë të lartë të Zoti xh.sh., e atyre dijetarëve që janë pajisur me dije, nënkupton një vlerësim të shumëfishtë shpirtëror, intelektual dhe shoqëror, e i cili tejkalon kufijtë e vlerësimit të zakonshëm njerëzor. Kjo ngritje nuk është thjesht status, por funksion: një mandat për të ndriçuar, reformuar dhe orientuar ndërgjegjen kolektive. Në thelb, ajo përfaqëson gradën e afërsisë me të vërtetën dhe me vullnetin hyjnor, të fituar përmes dijes së dobishme dhe veprimit të drejtë.

Në lidhje me këtë, i Dërguari ynë i fundit, Muhamedi a.s., ka thënë: “Vërtet dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve.”

Haxhi Sherif Ahmeti përfaqëson figurën e dijetarit që mishëron në praktikë parimin pejgamberik, ngase veprimtaria e tij dëshmon përkushtimin e thellë ndaj ruajtjes dhe transmetimit të dijes islame. Në këtë mënyrë, ai vazhdoi denjësisht rrugën e dijetarëve si trashëgimtarë të misionit të Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s..

Prandaj, kam nderin e veçantë dhe ndihem i privilegjuar që sot, para jush, të them disa fjalë dhe vlerësime për veprën të cilën po e promovojmë sot: “Akaidi Islam: parimet, zhvillimi dhe shkollat”, të autorit dhe myderrizit tonë, dhe të shumë brezave para nesh, haxhi Sherif ef. Ahmetit.

Në të vërtetë, kjo vepër, të cilën po e promovojmë sot, është hartuar mbi bazën e ligjëratave që haxhi Sherif ef. Ahmeti i ka mbajtur për dy vjet para studentëve të brezit të parë të



Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, përkatësisht midis viteve 1992-1994.

Që në fillim, më lejoni të theksoj se, kur u njoha me materialin e shtjelluar për dy vjet radhazi nga haxhi Sherif ef. Ahmeti para studentëve të Fakultetit të Studimeve Islame, mendja mu kthye menjëherë në periudhën e rinisë sime, në kohën kur isha nxënës i Medresesë “Alauddin” vitet 1974-1979. Ishte pikërisht ajo kohë kur haxhi Sherif efendiu ushtronte detyrën e drejtorit të këtij institucioni arsimor dhe, njëkohësisht, ishte profesor i lëndës së Akaidit. Ky rikthim në kujtesën time më solli para syve figurën e haxhi Sherif ef. Ahmetit, këtij personaliteti të rrallë pedagogjik dhe akademik.

Si ish-nxënës i haxhi Sherif ef. Ahmetit dhe, njëkohësisht, si vazhdues i misionit që ai e konceptoi dhe e mishëroi me përkushtim të jashtëzakonshëm në mësimdhënien e lëndës së Akaidit, si në Medrese ashtu edhe në Fakultetin e Studimeve Islame, redaktimin e këtyre ligjëratave e konsiderova si një privilegj të veçantë dhe një nder të thellë për mua, si dhe për kolegët e mi, që kontribuuan në përgatitjen, redaktimin dhe botimin e këtij korpusi ligjërimesh, e e cila përfaqëson një trashëgimi të çmuar intelektuale dhe teologjike.

Ky angazhim yni, sado modest në përmasë, synon të jetë një shprehje mirënjohjeje dhe respekti ndaj një personaliteti të rrallë të dijes islame, i cili me mendimin e tij të kthjellët, me disiplinën metodologjike dhe me përkushtimin e palëkundur ndaj edukimit, ka lënë gjurmë të pashlyeshme në formimin intelektual dhe shpirtëror të brezave të tërë. Në këtë kuptim, ky botim përbën jo vetëm një akt redaktorial, por edhe një dëshmi të vazhdimësisë së misionit të tij arsimor dhe një përpjekje për ta ruajtur dhe transmetuar më tej këtë trashëgimi në hapësirën akademike bashkëkohore.

Leximi i këtyre ligjëratave më riktheu gjithashtu në vitet e hershme, vitet e tetëdhjeta të shekullit që kaloi. Një periudhë historike e mbushur me sfida të jashtëzakonshme politike, shoqërore dhe institucionale për popullin e Kosovës. Mund të them se ishte edhe koha e një rizgjimi të gjerë kombëtar ndër shqiptarë, kur përpjekjet për çlirim nga sistemet represive të dorës së hekurt shoqëroreshin me aspirata për zëvendësimin e strukturave autoritare me vlera demokratike, liri qytetare dhe një riorganizim të thellë konceptual të shoqërisë në tërësi, në harmoni me zhvillimet evropiane dhe universale.

Megjithatë, në kundërthënie të plotë me këto procese emancipuese, në Kosovë ishte instaluar një regjim i institucionalizuar diskriminimi dhe apartheidi nga ana e Serbisë, i cili e bënte mbijetesën individuale dhe shoqërore jashtëzakonisht të vështirë. Në një realitet të tillë, jeta fetare, kulturore dhe arsimore e shqiptarëve po rindërtohej me sakrificat e mëdha, nën trysninë e vazhdueshme dhe dhunën sistematike të riokupimit të ri serb, dhe marrjes me dhunë



edhe të asaj autonomie të kufizuar që kishim 1974-89. Okupim, i cili çdo ditë e më shumë shtrinte mekanizmat e tij të kontrollit dhe represionit kundër shqiptarëve.

Në këtë kontekst të ndërlikuar historik dhe ekzistencial, angazhimi i dijetarëve të përmasave të haxhi Sherif ef. Ahmetit përbente një burim orientimi dhe një dritë udhërrëfyese për shoqërinë në përgjithësi, e në mënyrë të veçantë për studentët e Fakultetit të Studimeve Islame dhe për besimtarët që kërkonin dije të qëndrueshme, qartësi doktrinare dhe stabilitet shpirtëror. Kontributi i tij nuk kufizohej vetëm në transmetimin e njohurive teologjike, por shtrihej edhe në ruajtjen e kohezionit moral, fetar dhe kombëtar në rrethana të skajshme historike.

Të nderuar të pranishëm,

Ligjëratat e përfshira në këtë vëllim u mbajtën në një fazë themelore të historisë institucionale të Fakultetit të Studimeve Islame, në kohën kur ky institucion sapo kishte hapur dyert si një qendër e re akademike e dijes islame. Edhe pse formalisht i pensionuar, haxhi Sherif ef. Ahmeti u rikthye në auditor me një ndjenjë të thellë përgjegjësie intelektuale dhe morale, për të vazhduar misionin e tij jetësor: mësimdhënien, transmetimin e dijes së pastër dhe formimin e brezit të ardhshëm të studiuesve dhe udhëheqësve fetarë.

Ligjëratat e përmbledhura në këtë vepër, të cilën përgatitësi i saj, ish-studenti i tij, dr. Sadik Mehmeti, me të drejtë e ka titulluar “Akaidi Islam – parimet, zhvillimi dhe shkollat”, ofrojnë një trajtim të gjerë dhe të thelluar të çështjeve themelore të besimit islam, duke u fokusuar në dimensionin teologjik, etik dhe praktik të tyre.

Në qendër të këtyre ligjëratave qëndron njohja e Njëshmërisë së Zotit xh.sh., si parimi themelor i besimit, i cili shtjellohet në lidhje të ngushtë me ndjeshmërinë fetare, me emrat dhe cilësitë e Zotit të Madhëruar, si dhe me ndikimin që këto koncepte kanë në formimin e vetëdijes te besimtari dhe sjelljes njerëzore. Autori ju qaset këtyre temave jo vetëm



si çështje doktrinare, por edhe si baza të një morali dhe përgjegjësie të qëndrueshme individuale dhe shoqërore.

Në këto ligjërata, një vëmendje e veçantë i kushtohet problematikës së lirisë dhe përgjegjësisë njerëzore, raportit ndërmjet vullnetit të lirë dhe kaderit (caktimit hyjnor), si dhe çështjes së mëkatit dhe pasojave të tij. Këto tema trajtohen në mënyrë të balancuar, duke synuar të sqarojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet veprimit njerëzor dhe vullnetit hyjnor, si dhe duke nxitur një kuptim të drejtë të përgjegjësisë morale dhe fetare të individit.

Në këtë kontekst, ligjëratat ofrojnë një kornizë konceptuale, që ndihmon lexuesin të kuptojë se besimi nuk e përjashton veprimin aktiv dhe të ndërgjegjshëm, por përkundrazi e fuqizon atë. Haxhi Sherif efendiu gjithëherë thënie e tij i argumenton me ajete kuranore dhe hadithe, por edhe më mendime të ndryshme të dijetarëve islamë. Disa nga ligjëratat në këtë vëllim ndalen gjithashtu edhe në temat që lidhen me dimensionin metafizik të ekzistencës njerëzore, siç janë: shpirti, vdekja dhe jeta pas saj, si dhe konceptet e shpërblimit dhe ndëshkimit. Këto çështje trajtohen me një qasje reflektuese dhe edukative, duke synuar të nxisin vetëdijen për përkohshmërinë e jetës tokësore dhe për përgjegjësinë e njeriut për veprat e tij.

Një pjesë e rëndësishme e ligjëratave i kushtohet edhe praktikave shpirtërore dhe marrëdhënies së njeriut me Zotin xh.sh., dhe me të tjerët, përfshirë lutjen, ndërmjetësimin – shefatin dhe ndihmën ndaj të tjerëve. Këto aspekte paraqiten si mjete thelbësore për forcimin e lidhjes shpirtërore, për ndërtimin e solidaritetit shoqëror dhe për kultivimin e një etike të përgjegjshme dhe humane.

Në shtjellimin e temave të Akaidit, myderriz Sherif ef. Ahmeti, sikurse u tha, aplikonte një qasje analitike dhe racionale, duke i nxitur studentët të angazhoheshin në mendim kritik dhe reflektim të pavarur. Logjika zinte një vend qendror në metodologjinë e tij pedagogjike; ai e konsideronte arsyen si një mjet thelbësor për të kuptuar dhe përvetësuar të vërtetat e besimit.

Në këtë kontekst, ai theksonte vazhdimisht se në Kuran nuk ka asgjë që bie ndesh me logjikën e shëndoshë, përkundrazi, shpallja hyjnore është në harmoni të plotë me arsyen njerëzore.

Sipas qasjes së tij didaktike, njeriu, si krijesë e Zotit xh.sh., është i pajisur me aftësi njohëse dhe perceptuese, që e bëjnë të aftë të kuptojë dhe të përvetësojë edhe temat më të ndërlikuara teologjike dhe filozofike. Ky besim në potencialin intelektual të studentit, e bënte procesin mësimor dinamik dhe gjithëpërfshirës, duke krijuar një ambient ku çështjet e ndërlikuara të besimit trajtoheshin me qartësi, argumentim dhe vetëbesim intelektual. Si rezultat, mësimdhënia e Haxhi Sherif Ahmetit jo vetëm që transmetonte njohuri, por edhe formësonte një mënyrë të menduarit të strukturuar, racionale dhe të përgjegjshme ndaj çështjeve themelore të besimit islam.

Një dimension i veçantë i këtyre ligjëratave është edhe trajtimi i zhvillimit historik të shkencës së Akaidit. Autori ndalet në etapat kryesore të formimit të saj, në sfidat intelektuale dhe polemikat teologjike që e kanë shoqëruar këtë disiplinë, si dhe në kontributet e mendimtarëve dhe shkollave kryesore të mendimit islam.

Ky kontekst historik i jep ligjëratave një thellësi shtesë analitike, duke e ndihmuar lexuesin të kuptojë Akaidin jo si një sistem të ngurtë doktrinash, por si një shkencë dinamike, e formësuar në dialog të vazhdueshëm me realitetet shoqërore, kulturore dhe intelektuale të kohëve të ndryshme.

Në këtë kuptim, ligjëratat ofrojnë një pasqyrë tërësore të strukturës intelektuale të Akaidit islam, duke ndërthurur dimensionin normativ, racional dhe historik të tij. Kjo qasje e bën materialin veçanërisht të vlefshëm jo vetëm për studentët e shkencave islame, të cilët gjejnë këtu një bazë solide teorike dhe metodologjike, por edhe për studiuesit dhe lexuesit e interesuar për themelet e besimit dhe të mendimit islam, të cilëve u ofrohet një kornizë e qartë orientuese për reflektim dhe hulumtim të mëtejshëm.

Autori i këtyre ligjëratave paraqet gjithashtu një trajtim të konsoliduar historik dhe konceptual të themeluesve dhe të procesit të formimit të shkollave tradicionale të Akaidit Sunit, në veçanti të drejtimit maturidi dhe eshari. Duke e promovuar këtë trashëgimi klasike të mendimit teologjik islam, ai sqaron se debatet doktrinare nuk lindën si kundërvënie ndaj besimit, por si përpjekje intelektuale për të kuptuar dhe artikuluar me saktësi çështjet më delikate të shkencës së Akaidit.

Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë u kushtohet interpretimeve të ajeteve mutashabih - synonuese apo alegorike (jo bollshëm të qarta për njeriun në kuptim), veçanërisht atyre që lidhen me emrat dhe cilësitë e Allahut xh.sh..

Me raportin ndërmjet lirisë dhe përgjegjësisë njerëzore, me çështjen e kaderit (caktimit hyjnor) dhe me problematikën e mëkatit, haxhi Sherif efendiu, argumenton se divergjencat ndërmjet shkollave nuk përfaqësojnë devijime doktrinare, por refleksione të metodave të ndryshme dhe racionale në shërbim të ruajtjes së pastërtisë së besimit.

Prandaj, ligjëratat e këtij vëllimi, ofrojnë një lexim të ekuilibruar dhe të përgjegjshëm të trashëgimisë akaidologjike islame, duke e pozicionuar atë si një disiplinë dinamike, reflektuese dhe thellësisht racionale në shërbim të besimit të drejtë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Mësimdhënia e tij në Medresenë “Alauddin” të Prishtinës për gati dy dekada, puna si drejtor i Medresesë, si myfti i Prishtinës dhe si kontribuues i pashoq në periodikët islamë, dëshmojnë për integritetin, përkushtimin dhe vizionin e tij të gjerë.

Kulmi i veprimtarisë së tij shkencore është padyshim përkthimi dhe komentimi i Kuranit fisnik më (1988), një ndër veprat themelore të literaturës islame në gjuhën shqipe. Kjo biografi e pasur e myderriz haxhi Sherfi ef. Ahmetit na bën të qartë se botimi në fjalë nuk është një përmbledhje e zakonshme ligjëratash, por një thesar i mendimit të një dijetari me përvojë të gjerë, i cili ka ditur të ndërthurë traditën, argumentin dhe saktësinë shkencore me qartësinë, butësinë dhe metodologjinë pedagogjike.

Prandaj me bindje them se kjo përmbledhje e këtyre ligjëratave të haxhi Sherif ef. Ahmetit në një libër është një akt me rëndësi të veçantë shkencore, kulturore dhe institucionale. Ky botim hedh dritë mbi trashëgiminë islame të haxhi Sherif Ahmetit, njërit prej mendimtarëve më me ndikim në hapësirën shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XX. Përmbledhja e ligjëratave në një vëllim të vetëm i shpëton ato nga harresa dhe humbja në fletore studentësh, duke iu dhënë atyre statusin e merituar të një burimi akademik të qëndrueshëm.

Të nderuar të pranishëm,

Për fund themi se ligjëratat e h. Sherif ef. Ahmetit, të mbajtura para më shumë se tri dekadash për studentët e Fakultetit të Studimeve Islame të Prishtinës dhe të paraqitura sot në formë vëllimi të botuar nën kujdesin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, tejkalojnë kufijtë e një përmbledhjeje të zakonshme akademike. Ato përfaqësojnë vazhdimësinë e zërit të një mësuesi të paharruar, i cili, përmes qartësisë së mendimit, thellësisë doktrinare dhe përgjegjësisë pedagogjike, vazhdon të frymëzojë brezat e rinj të studiuesve dhe të besimtarëve.

Këto ligjëratat ndërtojnë ura të qëndrueshme ndërmjet traditës klasike islame dhe kërkesave intelektuale të kohës bashkëkohore, duke ofruar një orientim të qartë në fushën e



besimit, etikës dhe formimit moral. Ato përbëjnë një thesar të çmuar të dijes akaidologjike, i cili jo vetëm që pasuron literaturën e studimeve islame në gjuhën shqipe, por edhe kontribuon në konsolidimin e mendimit teologjik islam në kontekstin tonë kulturor dhe shoqëror.

Përkujdesja dhe angazhimi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës në përkrahjen, përgatitjen dhe realizimin e këtij botimi dëshmojnë qartë vetëdijen institucionale për rëndësinë e ruajtjes, ndriçimit dhe afirmimit të trashëgimisë intelektuale të dijetarëve tanë. Ky botim, si i tillë, përfaqëson jo vetëm një akt botues, por një obligim moral dhe shkencor ndaj kujtesës kolektive, dijes së trashëguar dhe misionit arsimor të Islamit ndër shqiptarë.

Ky botim përfaqëson një trashëgimi të qëndrueshme shpirtërore dhe intelektuale, një dëshmi të qartë të përkushtimit të një dijetari të madh siç ishte h. Sherif Ahmeti, ndaj dijes dhe misionit arsimor, si dhe një dhuratë të çmuar akademike për të gjithë ata që synojnë ta njohin, ta kuptojnë dhe ta jetojnë besimin islam me thellësi konceptuale, vetëdije kritike dhe përgjegjësi morale.

Bashkësia Islame e Kosovës, sikurse deri më sot, edhe në të ardhmen do të vazhdojë me përkushtim të botojë, promovojë dhe nderojë veprën e pedagogëve dhe ulemave tanë të çmuar, të cilët me punën e tyre, qoftë përmes fjalës së shkruar, qoftë përmes ligjëritimit, kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në shpjegimin, ruajtjen dhe përhapjen e fesë.

I tillë ishte dhe i tillë mbetet haxhi Sherif ef. Ahmeti, një shembull i dijetarit që jetoi me dije dhe për dije, dhe një burim frymëzimi për të gjithë ata që synojnë t'i shërbejnë në vërtetë dhe dijes me përkushtim e sinqeritet.

Dhe krejt në fund ju ftoj që për shpirtin e tij të këndojmë nga një Fatiha!

*Myftiu Naim ef. Tërnavë
Prishtinë, më 23 prill 2026*

Bashkëjetesa ndërjetare – vlerë identitare dhe nevojë e kohës sonë

FJALIMI I MYFTIUT TË KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA, I MBAJTUR NË TRYEZËN E DIALOGUT NDËRFETAR ME TEMËN “BASHKËJETESA NDËRFETARE NDËR NE, VIRTYT HYJNOR APO DOMOSDOSHMËRI SHOQËRORE”

Të nderuar prijës të komuniteteve fetare,

Të nderuar të pranishëm,

Bashkëjetesa fetare paqësore në Republikën e Kosovës dhe brenda kombit shqiptar, është një model qytetërues, i ndërtuar mbi parimet e qytetarisë dhe vëllazërisë shqiptare.

Historikisht, Kosova ka treguar modele të suksesshme të bashkëjetesës, dhe këtë trashëgimi mund ta përdorim në vazhdimësi si referencë për promovimin e paqes dhe stabilitetit kombëtar.

Ky angazhim është i rëndësishëm jo vetëm për marrëdhëniet brenda vendit, por edhe për dialogun ndërkombëtar, si dhe për modelimin e një paradigme të bashkëjetesës fetare dhe qytetare, e cila mund të shërbejë si shembull edhe për rajone të tjera me diversitet fetar.

Marrëdhënia ndërmjet njerëzve dhe popujve pa dallim, duhet të jetë marrëdhënie njohjeje, bashkëpunimi, vëllazërie



dhe shkëmbimi interesash të dobishme, për të ndërtuar jetën njerëzore sa më të mirë me një perspektivë të sigurt për të gjithë.

Prandaj, nisur nga kjo, edhe sot ishte një ditë produktive e karakterizuar nga reflektimi dhe diskutimi i thelluar mbi vlerat themelore të shoqërisë sonë. Në fokus ishte bashkëjetesa ndërjetare, e trajtuar jo vetëm si një çështje aktuale, por si një trashëgimi e rëndësishme historike dhe shpirtërore e popullit tonë.

Që në fillim, më lejoni të theksoj se komunitetet fetare në vendin tonë, ndër shekuj, kanë kultivuar me përkushtim dhe mirëbesim, harmoninë dhe respektin ndërjetar. Sot, me plot të drejtë, mund të konstatojmë se harmonia ndërjetare te ne nuk është vetëm një realitet i jetuar, por edhe një vlerë identitare, që na dallon dhe na nderon përpara botës.

Populli ynë ka ruajtur dhe zhvilluar ndër shekuj një vlerë të lartë universale. Kjo vlerë mishëron dimensione të thella humane dhe shpirtërore. Respekti i ndërsjellë ndërmjet besimeve ka qenë themel i qëndrueshmërisë shoqërore. Bashkëjetesa ndërjetare është dëshmi e kulturës sonë të dialogut dhe tolerancës. Ajo përbën një trashëgimi të çmuar, që vazhdon të udhëheqë shoqërinë tonë.

Për këtë vlerë, merita të veçanta kanë prijësit fetarë, teologët dhe besimtarët e të gjitha feve, të cilët, duke u mbështetur në mësimet e tyre, kanë kultivuar një qasje të drejtë ndaj fesë së tyre dhe një respekt të sinqertë ndaj besimit të tjetrit.

Kjo kulturë e ndërtuar ndër shekuj nga imamë, priftërinj dhe udhëheqës të tjerë fetarë, ka bërë që populli ynë të krijojë një trashëgimi të pasur me vlera të veçanta.

Kemi dëshmuar se është e mundur të jetohet në paqe dhe harmoni jo vetëm brenda një shoqërie, por edhe brenda një

familjeje me besime të ndryshme, duke bashkëjetuar ndërmjet dy besimeve të mëdha – atij islam dhe atij të krishterë.

Veçanti e rëndësishme e kësaj tradite është, se populli ynë, jo vetëm që ka kultivuar harmoninë brenda vetes, por ka treguar të njëjtën qasje edhe ndaj komuniteteve të tjera etnike dhe fetare. Asnjëherë feja nuk është përdorur si mjet për përçarje apo për nxitje të urrejtjes.

Në kohën që po jetojmë, kohë globalizimi, migrimesh të mëdha dhe sfidash të shumta, harmonia ndërjetare bëhet edhe më e domosdoshme. Bota sot po përballet me konflikte, luftëra dhe tensione të shumta, dhe pikërisht në këtë kontekst, modeli ynë i bashkëjetesës është një shembull i çmuar që duhet ruajtur dhe promovuar.

Të gjitha fetë, në thelbin e tyre, na mësojnë dashurinë për njëri-tjetrin, paqen dhe mirëkuptimin. Krijuesi e ka bërë njeriun të lirë në besim; po të kishte dashur, do ta kishte bërë njerëzimin të një besimi të vetëm. Teoritë që ëndërrojnë unifikimin e gjithë njerëzimit në një fe, apo kulturë të vetme, duken si ëndrra të paarrtshme.

Zoti i Madhërishtëm, në Kuranin fisnik, i thotë Muhamedit a.s.: *“Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t’i kishte bërë njerëzit një popull të vetëm, por ata vazhdojnë të jenë të ndryshëm.”* (Hud, 118).

Pra, urtësia hyjnore ka dashur larmi në gjuhë, kombe dhe besime, që njerëzit të njihen, të respektohen dhe të bashkëjetojnë në paqe. Feja, në thelbin e saj, nuk na ndan, përkundrazi, ajo na afron. Ajo na mëson ta duam njëri-tjetrin, ta respektojmë dinjitetin njerëzor dhe të jetojmë në paqe.

Zoti i Madhëruar, në Kuranin fisnik, thotë: *“O ju njerëz! Ne ju kemi krijuar nga një mashkull dhe një femër dhe ju kemi bërë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete...”* (El Huxhurat, 13).

Kjo thënie kuranore thekson se i gjithë njerëzimi ka një origjinë të përbashkët, dhe se dallimet ndërmjet nesh si në (popuj, fise, kultura), nuk janë për përçarje apo mburrje, por për njohje, bashkëpunim dhe mirëkuptim. Mesazhi i tij kryesor është barazia e njerëzve dhe vlera e respektit të ndërsjellë, ku nderi i vërtetë nuk matet me prejardhje, por me moral dhe devotshmëri.

Po ashtu, një nga parimet më të fuqishme të fesë islame është liria e besimit. Kurani këtë e shpreh qartë: *“Nuk ka dhunë në fe...”*

Parimi *“Nuk ka dhunë në fe”* artikulon një normë themelore islame universale: besimi autentik nuk mund të imponohet përmes forcës, ngase ai buron ekskluzivisht nga bindja e lirë dhe nga ndërgjegjja e pavarur. Çdo përpjekje për ta detyruar dikë për besim, fenë e shndërron në një akt formal pa përmbajtje shpirtërore, duke e mohuar vetë thelbin e saj. Në këtë kuptim, thënia kuranore afirmon sovranitetin e



ndërgjegjes njerëzore dhe e vendos lirinë e besimit si kusht të domosdoshëm për vlefshmërinë e tij.

Në një tjetër verset kuranor, Zoti xh.sh., na mëson: *“Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time.”*

Kjo thënie e Zotit të Madhërishtëm shpreh një parim të qartë të bashkëjetesës paqësore: respektimin e plotë të lirisë së besimit dhe mosndërhyrjen në bindjet e tjetrit. Kjo liri në besim nuk duhet të keqpërdoret për ta cenuar tjetrin. Përkundrazi, ajo duhet të shërbejë si bazë për respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë. Parime të tilla gjenden në të gjitha librat e shenjtë dhe përbëjnë thelbin e mesazhit fetar.

Historia jonë ka njohur edhe periudha të vështira, sidomos gjatë sistemeve që tentuan ta dobësojnë ose zhdukën besimin fetar. Megjithatë, populli ynë nuk e humbi lidhjen me fenë. Me rënien e atij sistemi, besimi u rikthye fuqishëm, ndërsa komunitetet fetare rifilluan misionin e tyre me përkushtim, duke ruajtur dhe forcuar vlerat e trashëguara.

Pas luftës së fundit në Kosovë 1998-1999, komunitetet fetare kanë luajtur rol të rëndësishëm në uljen e tensioneve, në rivendosjen e dialogut dhe në ndërtimin e paqes ndërmjet komuniteteve. Në këtë rrugë, ato kanë pasur edhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar. Sot, sfida jonë kryesore është: si ta ruajmë dhe ta forcojmë këtë harmoni në rrethanat bashkëkohore?

Sfida sot nuk është vetëm ruajtja, por edhe forcimi i kësaj harmonie në një realitet në ndryshim të vazhdueshëm.

Kam bindjen se këtë mund ta mbështesim në këto shtylla thelbësore dhe të qëndrueshme siç janë:

- Interpretimi autentik i mësimave fetare – mbështetur në burime të sakta dhe në kontekstin e tyre të mirëfilltë;

- Roli i dijetarëve dhe udhëheqësve fetarë – promovimi i mesazheve të moderuara, paqësore dhe gjithëpërfshirëse;

- Edukimi kritik dhe etik – zhvillimi i aftësisë për të dalluar mes interpretimit të drejtë dhe keqinterpretimit;



-Edukimi për bashkëjetesë dhe diversitet – kultivimi i respektit ndërfetar që në moshë të hershme;

-Dialogu i vazhdueshëm ndërfetar – krijimi i hapësirave të rregullta për komunikim dhe mirëkuptim;

-Kujtesa dhe trashëgimia kulturore – ruajtja dhe promovimi i traditës sonë të bashkëjetesës.

Në një kohë të materializmit dhe ndikimeve të ndryshme ideologjike, roli i institucioneve fetare dhe i prijësve shpirtërorë është më i rëndësishëm se kurrë. Nëse arrijmë t'i edukojmë drejt besimtarët dhe t'i ruajmë vlerat tona, atëherë kemi përmbushur misionin tonë para Zotit dhe shoqërisë. Natyrisht, sfida do të ketë gjithmonë. Mund të ketë zëra që nuk përputhen me këto vlera, por detyra jonë është të qëndrojmë të palëkundur në misionin tonë për ruajtjen e harmonisë dhe unitetit shoqëror.

Në përfundim, dëshiroj të riafirmoj me theks të veçantë angazhimin tonë të qëndrueshëm për ruajtjen dhe konsolidimin e bashkëjetesës ndërfetare. Kjo nuk përbën thjesht një vlerë të trashëguar, por një detyrim të vazhdueshëm moral dhe shoqëror. Si komunitete fetare, bartim një rol thelbësor në kultivimin e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Në cilësinë e udhëheqësve shpirtërorë, përgjegjësia jonë shtrihet përtej së tashmes, drejt formësimit të së ardhmes.

Ruajtja e kësaj harmonie kërkon përkushtim të ndërgjegjshëm dhe veprim të koordinuar.

Ajo duhet të përcillet me integritet dhe vizion te brezat që vijnë, si një themel i qëndrueshëm i shoqërisë.

Të nderuar të pranishëm,

Një gjë dua ta theksoj me bindje të plotë: Ndjenja e besimit është nevojë e brendshme e njeriut, është pjesë e natyrës së tij dhe e rrjedhës së jetës shoqërore. Njeriu pa besim është i varfër shpirtërisht, ndërsa shoqëria pa vlera shpirtërore është e brishtë.

Megjithatë, harmonia ndërfetare që gëzojmë sot nuk është as rastësi, as vlerë e imponuar nga faktorë të jashtëm. Ajo nuk buron thjesht nga formulime teorike të kodifikuara në libra, e as nuk është produkt i dijes së përvetësuar në hapësira shkollash apo kolegësh. Kjo harmoni është mësuar dhe është jetësuar në vendet më të shenjta për ne, në objektet tona fetare: në xhami, në kisha, në manastire e sinagoga. Aty ku njeriu lidhet me shumë me Zotin e Madhërishtëm, aty ku është mësuar edhe si ta respektojë tjetrin. Aty është kultivuar fryma e mirëkuptimit, e durimit dhe e dashurisë për njeriun.

Kjo ndjenjë nuk është sipërfaqësore, ajo është e rrënjosur thellë në identitetin tonë fetar, kulturor dhe shoqëror. Është pjesë e qenies sonë, pjesë e mënyrës sonë të të jetuarit.

Prandaj, është e domosdoshme që këtë vlerë ta ruajmë me përkushtim dhe ta kultivojmë vazhdimisht. Sepse ajo nuk është vetëm trashëgimi që e kemi marrë, është amanet që duhet ta përcjellim te brezat që vijnë.

Ne jemi një popull jo shumë i madh në numër, por me vlera të mëdha, vlera që shumë të tjerë i admirojnë dhe i lakmojnë. Prandaj, le të vazhdojmë t'i ruajmë dhe t'i forcojmë ato me përkushtim.

Ju faleminderit!

*Myftiu i Kosovës,
Naim ef. Tërnavë*

Prishtinë, më 16.04.2026

Haxhi – udhëtim shpirtëror dhe simbol i unitetit të ymetit

Rexhep ef. Sulejmani

Rëndësia e haxhit nuk qëndron vetëm në përmbushjen e tij si obligim, por edhe në kuptimin e thellë që ai bart.

Haxhi është një ndër adhurimet më madhështore në Islam, sepse në të ndërthuren bindja ndaj Allahut, sakrifica personale, pastrimi shpirtëror dhe ndjenja e përkatësisë ndaj ymetit islam. Ai nuk është vetëm një obligim fetar për atë që ka mundësi, por edhe një udhëtim i thellë shpirtëror, i cili e transformon besimtarin dhe e lidh atë me një traditë të lashtë që fillon me Ibrahimin a.s.. Allahu xh.sh., thotë: *“Dhe për hir të Allahut, vizita e Shtëpisë është detyrim për atë që ka mundësi të udhëtojë tek ajo...”* (Ali Imran, 97). Ky urdhër hyjnor e vendos haxhin

në zemër të praktikës islame dhe e bën atë një shtyllë të pandashme të besimit.

Megjithatë, rëndësia e haxhit nuk qëndron vetëm në përmbushjen e tij si obligim, por edhe në kuptimin e thellë që ai bart. Prandaj, kjo trajtesë synon ta paraqesë haxhin si një ndërthurje të dimensionit juridik, edukimit shpirtëror dhe manifestimit të unitetit të ymetit islam.

HAXHI SI OBLIGIM FETAR

Haxhi është farz për çdo mysliman dhe myslimane, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Sheriati. Ky obligim është i





bazuar në Kuran, Sunet dhe konsensusin e dijetarëve islamë.¹

Kushtet kryesore janë: të qenët mysliman, arritja e moshës madhore, mendja e shëndoshë dhe mundësia reale për ta kryer atë. Kjo mundësi përfshinë: aftësinë fizike, sigurinë e rrugës dhe përgatitjen materiale pa e dëmtuar jetesën bazë të individit.

Pejgamberi Muhamed a.s., ka thënë: “Islami është ndërtuar mbi pesë (shtylla), ... kryerja e haxhit...”² Po ashtu, ai ka theksuar shpërblimin e madh të këtij adhurimi: “Nuk ka shpërblim tjetër për haxhin e pranuar përveç Xhenetit”³, si dhe: “Kush e kryen haxhin dhe nuk bën mëkate e as fjalë të pahijshme, kthehet si dita kur e ka lindur nëna e tij”⁴

Këto dhe hadithe të tjera tregojnë se haxhi nuk është vetëm detyrim, por edhe mundësi për pastrim të plotë shpirtëror.

PËRGATITJA PËR HAXH – DIMENSIONI I BRENDSHËM

Haxhi fillon në zemër përpara se të fillojë në rrugëtim. Kur besimtari e kupton rëndësinë e tij, tek ai lind një dëshirë e sinqertë për të qenë në mesin e atyre që i përgjigjen thirrjes së Allahut.

Vendimi për të shkuar në haxh është një hap i madh që kërkon sakrificë. Ai nënkupton largimin nga familja, rehatia dhe zakonet e

Haxhi fillon në zemër përpara se të fillojë në rrugëtim. Kur besimtari e kupton rëndësinë e tij, tek ai lind një dëshirë e sinqertë për të qenë në mesin e atyre që i përgjigjen thirrjes së Allahut.

përditshme për t’u nisur drejt Shtëpisë së Allahut. Në këtë kuptim, haxhi e mëson besimtarin se afrimi tek Allahu kërkon përkushtim dhe përpjekje.

Allahu xh.sh., thotë: “E kush largohet nga vendlindja e tij për hir të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, e pastaj e zë vdekja, shpërblimi i tij tek Allahu është i sigurt.” (En Nisa, 100).

Përgatitja për haxh përfshinë edhe pendimin, zgjidhjen e padrejtësive dhe kërkimin e faljes nga njerëzit. Besimtari duhet ta pastrojë zemrën e tij dhe të largohet nga mëkatet, në mënyrë që të hyjë në këtë adhurim me sinqeritet. Po ashtu, pasuria që shpenzohet për haxh duhet të jetë hallall, sepse vetëm veprat e pastra pranohen tek Allahu xh.sh.. Në këtë kontekst, dijetarë të mëdhenj, si Imam Gazaliu, kanë theksuar se kuptimi i vërtetë i haxhit qëndron në përjetimin e tij të brendshëm, e jo vetëm në kryerjen e jashtme të riteve.⁵

IHRAMI DHE BARAZIA

Ihrami përfaqëson një gjendje të veçantë shpirtërore, në të cilën njeriu lirohet nga dallimet e kësaj bote dhe paraqitet i barabartë me të gjithë besimtarët para Allahut xh.sh.. Në këtë gjendje, njeriu kujton edhe qefinin dhe momentin kur do të qëndrojë para Allahut xh.sh. pa asgjë tjetër, përveç veprave

të tij. Kështu, ihrami e orienton zemrën drejt Ahiretit dhe e largon atë nga lidhjet e tepërta me dynjanë.

RITET E HAXHIT DHE KUPTIMI I TYRE

Ritet e haxhit kanë kuptime të thella shpirtërore dhe edukative, të cilat synojnë formësimin e besimtarit dhe afrimin e tij me Allahun xh.sh.. Secili prej tyre bart një mesazh të veçantë, që shkon përtej veprimit të jashtëm dhe ndikon drejtpërdrejt në gjendjen e brendshme të njeriut.

Telbija është përgjigje ndaj thirrjes së Allahut dhe shprehje e dorëzimit ndaj Tij. Me fjalët “Lebbejke Allahumme lebbejk”, besimtari shpall gatishmërinë e tij për bindje dhe përmbushje të urdhrave hyjnorë.

Tavafi rreth Qabesë simbolizon qendrën e jetës së besimtarit, e cila duhet të jetë bindja ndaj Allahut xh.sh.. Ai nuk është vetëm një rrotullim fizik, por një përqendrim i zemrës dhe mendjes tek Allahu, duke e bërë Atë boshtin kryesor të jetës.

Saji ndërmjet Safasë dhe Merves shpreh përpjekjen dhe shpresën e njeriut për mëshirën e Allahut xh.sh.. Ky rit e mëson besimtarin se arritja e mëshirës hyjnore kërkon përkushtim, durim dhe përpjekje të vazhdueshme.

Qëndrimi në Arafat, për të cilin Pejgamberi Muhamed a.s., ka thënë: “Haxhi është Arafati”⁶, përbën kulmin e haxhit dhe një moment të thellë afrimi me Allahun xh.sh.. Në këtë çast, besimtari qëndron me përlulesi, lutje dhe shpresë për falje.



Hedhja e guralecëve simbolizon refuzimin e së keqes dhe luftën kundër shejtanit. Ky veprim nuk është vetëm një rit i jashtëm, por edhe një shprehje e vendimit të brendshëm për t'u larguar nga mëkati. Ashtu siç haxhiu merr guralecin dhe e hedh atë, ashtu ai simbolikisht shpreh largimin e së keqes nga vetja e tij, duke e nxjerrë atë nga brendësia e tij dhe duke e refuzuar me vendosmëri.

Therja e kurbanit përfaqëson sakrificën dhe bindjen ndaj Allahut xh.sh.. Ajo rikujton shembullin e Ibrahimit a.s. dhe e mëson besimtarin të jetë i gatshëm të sakrifikojë për hir të Allahut xh.sh..

Këto rite nuk duhen parë vetëm si veprime të jashtëme, por si mjete për edukimin e brendshëm të besimtarit.

HAXHI SI SHKOLLË MORALE

Haxhi është një shkollë e disiplinës dhe moralit. Allahu xh.sh., thotë: “...nuk duhet të ketë shthurje, as mëkate e as grindje gjatë haxhit...” (El Bekare, 197). Ky ajet kërkon nga besimtari vetëkontroll, durim dhe sjellje të mirë. Haxhi e mëson njeriun të largohet nga konfliktet dhe të përqendrohet në adhurim.

Vlera e vërtetë e haxhit shihet në ndikimin që ai lë në jetën e njeriut pas kthimit: në sjellje, në adhurime dhe në marrëdhëniet me të tjerët.

MANIFESTIMI I UNITETIT TË YMETIT

Haxhi është një nga manifestimet më të fuqishme të unitetit të ymetit islam. Miliona besimtarë nga e gjithë bota mblidhen në një vend dhe kryejnë të njëjtat rite. Të gjithë veshin ihram të njëjtë, drejtohen nga e njëjta Qabe dhe i drejtohen të njëjtit Zot. Në këtë mënyrë, haxhi zhdruk dallimet racore, kulturore dhe shoqërore. Ai është dëshmi praktike e fjalës së Allahut xh.sh.: “Vërtet, kjo është feja juaj, fe e vetme...” (El Enbija, 92).

Haxhi është një adhurim gjithëpërfshirës, i cili bashkon dimensionin juridik, shpirtëror dhe shoqëror. Ai është një udhëtim drejt Allahut xh.sh., një proces pastrimi dhe një manifestim i unitetit të ymetit. Në një botë të ndarë nga dallimet, haxhi mbetet një model i gjallë i barazisë dhe vëllazërisë, duke e dëshmuar madhështinë dhe universalitetin e Islamit.

- 1 Vehbe Zuhejli, *El Fikh el Islami ve Edilletuhu*, (Damask: Dar el Fikër, 1985).
- 2 Muhamed ibën Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, hadithi nr. 8.
- 3 Po aty., hadithi nr. 1773.
- 4 Po aty., hadithi nr. 1521.
- 5 Ebu Hamid el Gazali, *Ihja Ulumi Din*, (Bejrut: Dar el Marife).
- 6 Muhamed ibën Isa et Tirmidhi, *Sunen et Tirmidhi*, hadithi nr. 889.

Dimensioni social dhe edukativ i haxhit

Dr. Selatin Mehani

HYRJE

Haxhi përbën një nga shtyllat themelore të Islamit dhe një nga manifestimet më të plota të adhurimit në jetën e besimtarit. Haxhi është një përvojë gjithëpërfshirëse, që ndërthur dimensionin shpirtëror, social dhe edukativ të Islamit. Në këtë kuptim, Haxhi përfaqëson një institucion të veçantë, i cili synon transformimin e individit dhe ndikimin e tij në shoqëri.

Në literaturën islame, haxhi shpesh trajtohet në aspektin juridik dhe ritual, duke u fokusuar në rregullat dhe kushtet e vlefshmërisë së tij. Megjithatë, dimensionet e tij sociale dhe edukative, mbeten po aq të rëndësishme, pasi ato lidhen drejtpërdrejt me objektivat e përgjithshme të Sheriatit (مقاصد الشريعة), si: realizimi i drejtësisë, ruajtja e unitetit dhe përmirësimi moral i shoqërisë.

Ky punim synon të analizojë haxhin në dimensionin e tij social dhe edukativ, si dhe ndikimin që ai ushtron në formësimin e individit dhe në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të balancuar.

KUPTIMI, OBLIGUESHMËRIA DHE OBJEKTIVAT E HAXHIT

Në aspektin gjuhësor, fjala “haxh” (arab. الحج), nënkupton synimin dhe drejtimin drejt një qëllimi të caktuar.¹ Ndërsa, në

Haxhi është obligim për çdo mysliman, i cili i plotëson kushtet e mundësisë fizike dhe materiale, dhe përbën një akt adhurimi që përfshin përkushtim të plotë fizik, shpirtëror dhe ekonomik. Ai është një nga format më të plota të ibadetit, sepse përfshin të gjitha dimensionet e jetës së njeriut.

terminologjinë islame, haxhi përkufizohet si synimi dhe vizita e Shtëpisë së shenjtë (Qbesë, dhe e vendeve të tjera të shenjta në Mekë), në një kohë të caktuar dhe sipas një rendi të përcaktuar ritualesh të rregulluara nga Sheriati.² Ky përkufizim nënkupton se haxhi nuk është thjesht një vizitë fizike, por një akt adhurimi i strukturuar, i cili realizohet përmes kryerjes së veprimeve të posaçme, si: hyrja në gjendjen e ihramit, kryerja e tavafit rreth Qabesë, saji ndërmjet Safasë dhe Mervas, si dhe qëndrimi në Arafat, i cili përbën kulmin e këtij adhurimi.

Haxhi është obligim për çdo mysliman, i cili i plotëson kushtet e mundësisë fizike dhe materiale,³ dhe përbën një akt adhurimi që përfshin përkushtim të plotë fizik, shpirtëror dhe ekonomik. Ai është një nga format më të plota të ibadetit, sepse përfshin të gjitha dimensionet e jetës së njeriut.

Obligueshmëria e haxhit përbën një nga dispozitat themelore të Sheriatit islam, e vërtetuar në mënyrë të qartë përmes burimeve primare. Në Kuran theksohet: “Dhe për hir të Allahut, njerëzit e kanë për detyrë ta kryejnë haxhin në Shtëpi, për atë që ka mundësi ta përballojë rrugën” (Ali Imran, 97), duke e bërë atë obligim për çdo besimtar, që i plotëson kushtet e mundësisë (الاستطاعة). Po ashtu, në Sunetin e Pejgamberit Muhamed a.s., haxhi



përmendet si një nga pesë shtyllat e Islamit, çka e ngre atë në nivelin e obligimeve themelore fetare. Po ashtu, konsensusi i dijetarëve (الإجماع) e ka konfirmuar njëzëri këtë dispozitë, duke e konsideruar mohimin e obligueshmërisë së tij si devijim nga parimet bazë të fesë.⁴ Në këtë mënyrë, haxhi paraqitet si një detyrim individual (فرض عين), i lidhur me kushtin e mundësisë fizike dhe materiale të besimtarit.

Objektivat e haxhit janë të shumta dhe të ndërthurura. Në radhë të parë, ai synon realizimin e adhurimit të pastër ndaj Allahut dhe forcimin e lidhjes së besimtarit me Krijuesin e tij. Në këtë kontekst, haxhi shërben si një mjet për pastrimin shpirtëror dhe faljen e mëkateve.⁵

Një tjetër objektiv thelbësor është arritja e devotshmërisë, e cila përbën thelbin e edukimit islam. Përmes përjetimit të haxhit, besimtari mëson ta kontrollojë veten, të përmbahet nga ndalesat dhe të përqendrohet në përmirësimin e vetes. Po ashtu, haxhi ka një dimension të fortë kolektiv, pasi ai synon realizimin e unitetit të ymetit mysliman. Ai krijon një vetëdije të përbashkët që tejkalon kufijtë kombëtarë, kulturorë dhe gjuhësorë, duke i bashkuar myslimanët në një identitet të përbashkët fetar.⁶

DIMENSIONI SOCIAL I HAXHIT

1. Barazia njerëzore si parim themelor

Një nga aspektet më të dukshme të dimensionit social të haxhit është realizimi praktik i parimit të barazisë njerëzore. Veshja e ihramit, e përbërë nga dy copa të thjeshta pëlhure, përfaqëson një simbolikë të thellë të zhveshjes nga dallimet sociale, ekonomike dhe statusore, duke e vendosur individin në një gjendje të pastër barazie përpara Allahut. Në këtë gjendje, relativizohen dallimet ndërmjet të pasurit dhe të varfrit, ndërmjet udhëheqësit dhe qytetarit të zakonshëm, teksa të

gjithë besimtarët paraqiten në një nivel të njëjtë, duke reflektuar në mënyrë konkrete një nga parimet themelore të Islamit – barazinë universale të njerëzve.

Ky parim nuk mbetet vetëm në nivelin simbolik, por gjen mbështetje të qartë në burimet themelore të fesë islame. Në Kuran theksohet: “O ju njerëz! Ne ju kemi krijuar nga një mashkull dhe një femër dhe ju kemi bërë popuj dhe fise që të njiheni ndërmjet vete; më i nderuari tek Allahu është ai që është më i devotshëm.” (El Huxhurat, 13). Ky ajet vendos një standard normativ vlerësimi, që tejkalon kriteret racore, etnike dhe shoqërore, duke e përqendruar epërsinë në dimensionin moral dhe shpirtëror të njeriut, përkatësisht në devotshmëri (takva).

Islami artikulon një koncept të barazisë, që nuk është vetëm deklarativ, por synon të reflektohet në strukturat reale të marrëdhënieve shoqërore, duke promovuar drejtësi, dinjitet dhe respekt reciprok.

Në planin normativ, ihrami përbën një nga kushtet thelbësore të vlefshmërisë së haxhit, pa të cilin ky adhurim nuk realizohet.⁷ Kjo lidhje ndërmjet dispozitës juridike dhe simbolikës së saj, bart implikime të rëndësishme shoqërore. Ashtu siç haxhi nuk përmbushet pa hyrjen në gjendjen e ihramit, po ashtu edhe jeta shoqërore nuk mund të ndërtohet në mënyrë të qëndrueshme në mungesë të parimeve të barazisë, ndjeshmërisë reciproke dhe bashkëpunimit ndërmjet individëve. Në këtë kuptim, ihrami tejkalon funksionin e tij ritual dhe shndërrohet në një model konceptual që orienton rendin shoqëror drejt drejtësisë, solidaritetit dhe kohezionit njerëzor.

2. Uniteti i ymetit islam

Haxhi përfaqëson manifestimin më të plotë dhe më gjithëpërfshirës të unitetit të myslimanëve në nivel global.

Miliona besimtarë nga vende, kultura dhe kontekste të ndryshme shoqërore, mbledhen në një hapësirë të vetme, duke kryer të njëjtat rituale dhe duke ndjekur një qëllim të përbashkët adhurimi. Ky tubim tejkalon dimensionin thjesht fizik, duke u shndërruar në një përjetim kolektiv të identitetit fetar, ku dallimet gjuhësore, etnike dhe kulturore, zbehen përballë përkatësisë së përbashkët islame.

Në këtë kuadër, uniteti merr trajtë konkrete përmes orientimit të përbashkët drejt një Zoti të vetëm dhe një qendre të vetme – Qabesë, si dhe përmes sinkronizimit të riteve në kohë dhe formë. Ky harmonizim i veprimit dhe i qëllimit prodhon një kohezion të thellë shoqëror, duke forcuar ndjenjën e përkatësisë ndaj ymetit dhe duke rritur ndërgjegjësimin për përgjegjësitë dhe sfidat e përbashkëta.⁸

Ky realitet përbën një realizim praktik të thirrjes kuranore për unitet: *“Dhe kapuni të gjithë për litarin e Allahut dhe mos u përçani...”* (Ali Imran, 103). Në këtë kuptim, haxhi nuk mbetet vetëm një akt adhurimi individual, por shndërrohet në një mekanizëm efektiv për konsolidimin e unitetit kolektiv, duke e përkthyer këtë parim themelor nga një normë teorike në një përvojë të jetuar.

3. Haxhi si platformë komunikimi dhe ndërveprimi

Haxhi mund të konsiderohet si një platformë globale e komunikimit dhe shkëmbimit kulturor, ku dimension i shpirtëror ndërthuret ngushtë me ndërveprimin shoqëror dhe qytetëruar. Gjatë këtij tubimi madhor, myslimanët nga vende dhe kultura të ndryshme kanë mundësi ta njohin njëri-tjetrin, të shkëmbejnë përvoja dhe të krijojnë lidhje që tejkalojnë kufijtë gjeografikë dhe kulturorë, duke kontribuar në zgjerimin e vetëdijes kolektive dhe në forcimin e ndjenjës së përkatësisë ndaj ymetit.

Ky ndërveprim ndihmon në tejkalimin e paragjyqimeve dhe në ndërtimin e një kulture të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit, duke u mbështetur në parimin kuranor: *“... dhe ju kemi bërë popuj dhe fise që të njiheni ndërmjet vete...”* (El Huxhurat, 13), i cili e orienton diversitetin drejt njohjes reciproke dhe jo drejt përçarjes. Në këtë kuptim, haxhi përfaqëson një realizim praktik të këtij parimi, duke krijuar një hapësirë ku njohja dhe bashkëpunimi materializohen në mënyrë konkrete dhe marrin një rol aktiv në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme, të bazuar në mirëkuptim, respekt dhe bashkëpunim të ndërsjellë.

4. Forcimi i marrëdhënieve shoqërore

Një element tjetër i rëndësishëm i dimensionit social të haxhit është ndikimi i tij në përmirësimin e marrëdhënieve ndërpersonale. Para nisjes për në haxh, besimtarët nxiten të kërkojnë falje dhe të zgjidhin konfliktet, duke reflektuar një ndërgjegjësim të thellë etik mbi rëndësinë e pastrimit të marrëdhënieve njerëzore përpara përkushtimit në adhurim. Ky veprim nuk ka vetëm karakter individual, por kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e harmonisë dhe kohezionit shoqëror.

Po ashtu, gjatë kryerjes së ritualeve të haxhit zhvillohet një ndjenjë e theksuar solidariteti, ku besimtarët ndihmojnë njëri-tjetrin, tregojnë kujdes për më të dobët dhe veprojnë në frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi.⁹ Ky dimension gjen mbështetje edhe në udhëzimet profetike që nxisin ruajtjen e lidhjeve dhe shmangien e armiqësive ndërmjet besimtarëve. Në këtë kuptim, haxhi funksionon si një mekanizëm praktik për realizimin e objektivave të Sheriatit, që lidhen me forcimin e marrëdhënieve shoqërore dhe promovimin e solidaritetit, duke e shndërruar etikën islame në një përvojë të gjallë dhe të përbashkët.

DIMENSIONI EDUKATIV I HAXHIT

1. Edukimi shpirtëror

Haxhi përfaqëson një proces intensiv të edukimit shpirtëror, i cili e shkëput përkohësisht besimtarin nga rutina e zakonshme e jetës dhe e vendos atë në një gjendje të përkushtimit të plotë ndaj Allahut. Kjo shkëputje nga përditshmëria nuk është vetëm fizike, por edhe psikologjike dhe shpirtërore, duke krijuar kushte të përshtatshme për reflektim të thellë dhe përqendrim në dimensionin e brendshëm të adhurimit.

Përkushtimi i plotë gjatë haxhit kontribuon në pastrimin e zemrës nga ndikimet negative, në forcimin e sinqeritetit dhe në rritjen e ndërgjegjësimin për përgjegjësinë individuale para Allahut. Ky dimension mbështetet edhe në ajetin kuranor: *“Haxhi është në muaj të caktuar, dhe kush vendos ta kryejë haxhin në këta muaj, le të mos bëjë marrëdhënie intime, as mëkate dhe as grindje gjatë haxhit...”* (El Bekare, 197), ku theksohet qartë aspekti edukativ dhe disiplinues i këtij adhurimi. Po ashtu, në traditën profetike thuhet: *“Kush e kryen haxhin dhe nuk bën mëkate e as fjalë të këqija, kthehet (i pastër) sikur ditën që e ka lindur nëna e tij”*, (Buhariu, 1534), çka dësh-

Haxhi përfaqëson një proces intensiv të edukimit shpirtëror, i cili e shkëput përkohësisht besimtarin nga rutina e zakonshme e jetës dhe e vendos atë në një gjendje të përkushtimit të plotë ndaj Allahut.

mon për efektin transformues të haxhit në pastrimin shpirtëror të besimtarit.

Në këtë mënyrë, haxhi nuk mbetet vetëm një përmbushje rituale e një detyrimi fetar, por shndërrohet në një shkollë të mirëfilltë të edukimit shpirtëror, e cila synon reformimin e brendshëm të individit dhe ngritjen e tij në një nivel më të lartë të vetëdijes dhe përkushtimit fetar.

2. Edukimi moral

Një nga dimensionet më të rëndësishme të haxhit është funksioni i tij në edukimin moral të besimtarit. Gjatë kryerjes së këtij adhurimi, besimtari ndalohe nga grindjet, fjalët e këqija dhe çdo formë sjelljeje negative, çka krijon një kornizë të qartë disiplinuese, që synon rregullimin e sjelljes së tij në raport me të tjerët. Ky aspekt mbështetet drejtpërdrejt në ajetin kuranor: "...le të mos bëjë marrëdhënie intime, as mëkate dhe as grindje gjatë haxhit..." (El Bekare, 197), duke e theksuar dimensionin etik të këtij adhurimi.

Në këtë kuadër, haxhi e orienton besimtarin drejt përvetësimit praktik të virtyteve, si: durimi, vetëkontrolli dhe respekti ndaj të tjerëve, të cilat nuk mbeten vetëm kërkesa të përkohshme, por synojnë të shndërrohen në cilësi të qëndrueshme të karakterit. Përforcimi i këtij dimensionit gjen mbështetje edhe në traditën profetike, ku theksohet se haxhi i pranuar reflektohet në përmirësimin e sjelljes dhe largimin nga mëkatet. Në këtë mënyrë, edukimi moral, që realizohet gjatë haxhit nuk kufizohet vetëm në kohën e kryerjes së tij, por synon të vazhdojë si një proces i qëndrueshëm në jetën e përditshme të besimtarit, duke kontribuar në ndërtimin e një etike të lartë individuale dhe shoqërore.¹⁰

3. Edukimi në disiplinë dhe organizim

Haxhi kërkon një nivel të lartë organizimi dhe disipline, duke e shndërruar atë në një përvojë të strukturuar, që e edukon besimtarin në menaxhimin e kohës, respektimin e rregullave dhe përshtatjen me rrethanat e ndryshme. Lëvizjet e shumta ndërmjet vendeve të shenjta, respektimi i orareve të përcaktuara dhe bashkëjetesa me një numër të madh njerëzish, krijojnë një ambient praktik ku individit vihet përballë sfidave që kërkojnë durim, vetëpërmbytje dhe fleksibilitet.

Ky dimension disiplinues gjen mbështetje edhe në natyrën e rregulluar të riteve të haxhit, të cilat kryhen sipas një rendi të caktuar dhe në kohë të përcaktuara, duke reflektuar parimin islam të respektimit të rregullit dhe organizimit në adhurim. Në këtë kuptim, haxhi funksionon si një shkollë praktike e jetës, ku besimtari mëson të harmonizojë sjelljen e tij me kërkesat kolektive dhe të zhvillojë aftësi që tejkalojnë dimensionin ritual, duke ndikuar drejtpërdrejt në formësimin e tij si individ i disiplinuar dhe i përgjegjshëm në jetën shoqërore.

4. Edukimi në tolerancë dhe bashkëjetesë

Një tjetër aspekt i rëndësishëm edukativ i haxhit është ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj diversitetit kulturor. Ky adhurim bashkon besimtarë nga të gjitha anët e botës, me gjuhë, zakone dhe tradita të ndryshme, duke krijuar një hapësirë unike ndërveprimi ndërkulturor. Ky realitet e nxjerr individin nga kufijtë e përvojës së tij lokale dhe e vendos përballë një panorame të gjerë të shumëllojshmërisë brenda bashkësisë islame.

Ky diversitet nuk paraqitet si faktor ndarës, por si element edukues, i cili e mëson besimtarin të kultivojë tolerancën, të respektojë dallimet dhe të ndërtojë marrëdhënie mbi bazën e vlerave të përbashkëta fetare. Në këtë kuptim, haxhi materializon parimin kuranor të njohjes reciproke, duke e orientuar ndërveprimin ndërmjet popujve drejt mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Kështu, ai kontribuon në formësimin e një individi me horizont të zgjeruar dhe me aftësi për të bashkëjetuar në një shoqëri të larmishme, pa cenuar identitetin e tij fetar.

PËRFUNDIMI

Haxhi nuk është vetëm një obligim fetar, por një institucion i fuqishëm social dhe edukativ, që kontribuon në formësimin e individit dhe në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të balancuar. Ai promovon barazinë, unitetin dhe vlerat morale, duke e bërë atë një nga përvojat më transformuese në jetën e besimtarit. Ndikimi i tij nuk përfundon me përfundimin e ritualeve, por vazhdon edhe pas kthimit të besimtarit në jetën e tij të përditshme. Në nivelin shoqëror, haxhi kontribuon në përhapjen e vlerave, si: drejtësia, solidariteti dhe bashkëpunimi.

- 1 Muhamed bin ebi Bekër er Razi, *Muhtar es sihah*, (Mektebetu Lubnan, 1989), f. 108. Muxhemma el luga el arabije, *El Mu 'xhem el vesit*, (Mektebetu esh Shuruk ed Devlije, bot. 4, 2004), f. 156.
- 2 Ali bin Muhamed el Xhurxhani, *Et Ta'rifat*, (rec. Ibrahim el Ebjari, Dar er Rejjan li et Turath), f. 111. Muhamed el Ihsan el Berketi, *Et Ta'rifat el Fikhije*, (Dar el Kutub el Ilmije, 2003), bot. 1, f. 76.
- 3 Shih: Ibën Abidin, *Red el Muhtar*, (rec. prof. dr. Muhamed Bekër Ismail, Dar Alem el Kutub, 2003), 3/455.
- 4 El Kasani, *Bedai es Sanai fi Tertib esh Sherai*, (rec. Ali Muhamed Muavved dhe Adil Ahmed Abdilmevvhud, Dar el Kutub el Ilmije, 2003), 3/39-41.
- 5 Shih: Velijullah ed Dehlevi, *Huxhet Allahi el Baligah*, (rec. Seid Ahmed Jusuf el Balenburi, Dar Ibën Kethir, bot. 2, 2012), 2/202-203.
- 6 Shih: Velijullah ed Dehlevi, *Huxhet Allahi el Baligah*, po aty, 2/203-204.
- 7 Shih: Ibën Abidin, *Red el Muhtar*, po aty, 3/468.
- 8 Shih: Velijullah ed Dehlevi, *Huxhet Allahi el Baligah*, po aty, 2/199.
- 9 Shih: Velijullah ed Dehlevi, *Huxhet Allahi el Baligah*, po aty, 2/208-209.
- 10 Shih: Velijullah ed Dehlevi, *Huxhet Allahi el Baligah*, po aty, 2/194.

Të kuptuarit e haxhit përtej ritualeve

Maulana Vahiduddin Khan

Haxhi është një nga shtyllat themelore të Islamit. Ashtu haxhi format e tjera të adhurimit në Islam, edhe haxhi bazohet në vetëdijen e Zotit. Në të njëjtën kohë, ai ka një veçori unike – është i lidhur me jetën e peygamberit Ibrahim a.s..

Çdo mysliman, i aftë për ta bërë këtë, duhet ta kryejë haxhin të paktën një herë në jetën e tij. Duke u angazhuar në veprime të ndryshme gjatë haxhit, ai shpreh robërinë e tij të plotë ndaj Zotit. Ai kryen në mënyrë simbolike veprime që janë kryer nga peygamberi Ibrahim a.s., duke ndezur zellin te njeriu për t'u modeluar sipas modelit të këtij peygamberi të Zotit.



Pasi ndërtoi Qabenë në Mekë, peygamberi Ibrahim, u bëri thirrje njerëzve ta kryejnë haxhin për hir të Zotit. Udhëtimi në haxh është një përgjigje pohuese ndaj kësaj thirrjeje. Gjatë haxhit, haxhilerët thërrasin “Lebbejk Allahumme lebbejk”, që do të thotë: “Ja ku jam në shërbimin Tënd o Allah, ja ku jam!” Ajri kumbon nga kjo britmë si në përgjigje të thirrjes së peygamberit Ibrahim; pelegrinët dalin para Zotit, me gjithë zemër të gatshëm për të përmbushur çdo urdhër.

Kuptimi i fjalëpërfjalshëm i ‘haxhit’ është ‘të shkosh në vizitë Qabesë’. Sipas Sheriatit islam, haxhi ndodh një herë në vit kur njerëzit bëjnë tavaf Qabenë, ndalen në rrafshin e Arafatit dhe kryejnë veprimet e tjera që janë pjesë e haxhit.

Haxhi është një formë gjithëpërfshirëse e adhurimit. Ai përfshin gjithashtu shpenzimin e pasurisë dhe sforcimit fizik. Ai përfshin rikujtimin e Zotit dhe sakrificat për Zotin gjithashtu. Haxhi është një formë adhurimi në të cilën është i pranishëm edhe fryma e formave të tjera të adhurimit.

Në qendër të haxhit është Shtëpia e Zotit, Qabeja, e vendosur në Mekë. Qabeja është një kujtesë e një jete vërtet të devotshme të një shërbëtori të lartësuar të Zotit, peygamberit Ibrahim a.s.. Është një kujtesë se si një shërbëtor i përkushtuar i Zotit hoqi dorë nga gjithçka për Zotin, e modeloi tërë jetën e tij në përputhje me vullnetin e Zotit dhe iu përkushtua plotësisht misionit të Zotit deri në frymën e tij të fundit.

UDHËTIM DREJT ZOTIT

Haxhi është një udhëtim drejt Zotit, forma përfundimtare e afrimit me Zotin në jetën e dikujt. Kur haxhiu qëndron përballë Qabesë, kjo ia kujton atij se njeriu duhet të qëndrojë

para Zotit. Rreth rrotullimi i Qabesë simbolizon fokusin e haxhiut rreth Zotit për ta gjetur Atë.

Një tipar i veçantë i haxhit është vendndodhja – Meka dhe zonat përreth. Është një vend i zgjedhur nga Zoti pasi ishte qendra e misionit fetar të misionarit të madh, pejgamberit Ibrahim a.s.. Historia e hershme, mbi bazën e së cilës u shpалos Islami, doli këtu. Rreth e rrotull janë përkujtues të revolucionit të madh shpirtëror i nisur nën drejtimin e Pejgamberit Muhamed a.s. rreth 1400 vjet më parë. Këto tradita dhe veçori të veçanta i kanë dhënë Mekës një rëndësi të veçantë. Një atmosferë e veçantë shpirtërore dhe historike përshkon vendin. Askush që shkon atje nuk mund të mbetet i paprekur. Ai që kthehet pas kryerjes së haxhit është si dikush që më parë ishte mbuluar me pisllek dhe pluhur dhe pastaj del nga një lumë i vogël, i larë, i pastër dhe i dëlirë.

Kjo rëndësi e veçantë e haxhit është fryma e tij, dhe jo aq forma e jashtme, apo ritualet. Vetëm shkuarja në Mekë dhe kthimi nuk është haxh. Është për të fituar ato cilësi të veçanta shpirtërore, për të cilat është bërë obligim haxhi. Haxhi është takimi me Zotin. Kur një haxhi udhëton dhe mbërrin në vende që lidhen me haxhin, ai ndihet veçanërisht i frymëzuar. Ai ndien se ka lënë ‘botën e tij’ dhe ka mbërritur në ‘botën e Zotit’, se po vrapon drejt Zotërisë së tij dhe se po udhëton për hir të Tij; se ai po ‘hedh gurë’ mbi Satanën, armikun e tij në rrugën e Zotit, se po i kërkon Perëndisë të gjitha nevojat e tij dhe po merr nga Perëndia gjithçka që i nevojitet.

Qabeja është ndër shenjat e Zotit në tokë. Në Mekë, ku ndodhet Qabeja, Pejgamberi a.s., mori shpallje nga Zoti, të cilat ofrojnë udhëzim për njerëzimin. Por, udhëzim marrin vetëm ata që janë të gatshëm dhe të etur për ta përvetësuar atë. Për njerëzit e tjerë, haxhi është vetëm një lloj turneu. Ata shkojnë në haxh dhe kthehen aspak ndryshe nga sa ishin para se të shkonin.

Sipas një hadithi, haxhi është ndalimi në rrafshin e Arafatit, që tregon rëndësinë e Arafatit. Gjatë haxhit, rrafshi i Arafatit, paraqet një imazh të kuvendit të gjerë të haxhit, është një udhëtim drejt Zotit, forma përfundimtare e afërsisë me Zotin në jetën e dikujt. Në ditën e 9-të të dhulhixhes, një numër i madh i robërve të Zotit arrijnë në rrafshin e Arafatit nga të gjitha drejtimet. Kjo është një pamje e mahnitshme. Çdo person ka të veshur të njëjtën veshje të bardhë dhe të thjeshtë, ihramin, i ka humbur shenjat dalluese dhe shqipton të njëjtat fjalë “Lebbejk Allahumme

lebbejk; Lebbejk Allahumme lebbejk.” Duke e parë këtë pamje, kujtohet ajeti kuranor: “Do t’i fryhet surit dhe ata menjëherë do të ngrihen nga varret e tyre dhe do të nxitojnë të Zoti i tyre.” (36:51).

Haxhi është një formë e madhe adhurimi. Statusi që gëzon Qabeja në të gjitha xhamitë është i njëjtë me atë që gëzon haxhi në të gjitha format e adhurimit.

ASPEKTI PSIKOLOGJIK I HAXHIT

Zoti në Kuran thotë: “Dhe unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit vetëm që të më adhurojnë.” (51:56).

Kjo sugjeron se nxitja për ta adhuruar Zotin është e lindur dhe e rrënjësuar thellë në natyrën njerëzore. Këtë e kërkon vetë natyra e tij. Adhurimi i Zotit është i natyrshëm në natyrën njerëzore. Kjo është arsyeja pse përveç adhurimit të Zotit, asgjë nuk mund t’i japë njeriut kënaqësi të vërtetë.

Ashtu si një fëmijë i vogël që nxiton spontanisht ta përqafojë nënën e tij, i shtyrë nga një nxitje e brendshme e detyrueshme, ashtu edhe i shtyrë nga një zë i brendshëm, njeriu shtyhet të nxitohet drejt Zotit. Njeriu nuk mund ta ndryshojë personalitetin e tij të brendshëm. Prandaj Zoti nuk mund të hiqet nga zemra dhe mendja e tij.

DËSHMI TË ADHURIMIT TË ZOTIT NGA ANTROPOLOGJIA

Antropologët kanë studiuar një sërë shoqëri njerëzore, që nga fillimi i historisë e deri në ditët e sotme. Ata zbuluan, ndër të tjera, një fakt shumë të rëndësishëm – që pavarësisht nga ulje-ngritjet e jetës, njeriu ka qenë gjithmonë një adhurues i Zotit. Zoti dhe feja janë aq pjesë përbërëse të natyrës njerëzore, sa që në asnjë rrethanë nuk mund të ndahen prej saj. Enciklopedia Americana, e përmbledh këtë gjetje me fjalët e mëposhtme: “Që në ditët më të hershme të historisë së botës, njeriu ka qenë pak a shumë një krijesë fetare. Pothuajse pa ndryshim, ai ka pasur një zot, ose disa prej tyre, të cilëve u kërkoi mbrojtje. Herë pas here këto perëndi kanë qenë fetishe të papërpunuara prej druri të mprehtë ose guri të latuar përafërsisht; herë pas here, ata kanë marrë formën e kafshëve ose zvarranikëve ose janë shfaqur si përbindësia mizorë të etur për gjakun e jetës së atyre që i nderonin. Por sido që të kenë ardhur, njeriu i ka adhuruar sepse feja, siç përfaqësohet në adhurimin e fuqisë së mbinatyrshme, është e ndërthurur me të

Kur një haxhi udhëton dhe mbërrin në vende që lidhen me haxhin, ai ndihet veçanërisht i frymëzuar. Ai ndien se ka lënë ‘botën e tij’ dhe ka mbërritur në ‘botën e Zotit’, se po vrapon drejt Zotërisë së tij dhe se po udhëton për hir të Tij.



gjithë strukturën e natyrës njerëzore.” (Encyclopedia Americana, 1961, vëll. XXIII, f. 354).

Është fakt se vetëdija për Zotin është e ngulitur në natyrën e njeriut, duke qenë se si u krijua njeriu. Thënë kjo, kjo vetëdije qëndron e fjetur. Kjo është arsyeja pse kur njeriu nuk e gjen Zotin e vërtetë, ai fillon të adhurojë perëndi artificiale, të vetëkrijuara. Nxitja për të adhuruar lind nga një detyrim i rrënjosur në natyrën e tij. Nëse ai ndjek udhëzimet e pejgamberëve të Zotit, kjo nxitje do të gjejë përgjigjen e saj në formën e adhurimit të Zotit të vetëm. Dhe nëse ai nuk e ndjek këtë udhëzim, ai do të adhurojë qenie të tjera përveç Zotit, duke i trajtuar ato si Zot për ta kënaqur këtë nxitje.

SIMBOLET E VENDOSURA NGA ZOTI

Besimtari kërkon t’i afrohet Perëndisë menjëherë, tani dhe jo dikur në të ardhmen. Si mund të përmbushet ky kërkim i njeriut në këtë botë? Përgjigja për këtë jepet përmes simboleve të vendosura nga Zoti (2:158 Kuran).

Safa dhe Merva ndodhen në Mekë, pesëqind metra larg njëra-tjetrës, pranë Qabesë. Kur pejgamberi Ibrahim solli gruan e tij Haxheren dhe foshnjën Ismail dhe i vendosi këtu – që më vonë u bë qyteti i Mekës – ky vend ishte i pabanuar dhe pa ujë. Ndërsa furnizimi i Haxheres me ujë mbaroi, ajo vrapoi në kërkim të ujit – shtatë herë – midis Safasë dhe Mervas. Zoti u kënaq me Haxheren dhe i shpalli Safanë dhe Mervan si simbolet e Tij – një kujtesë për përkushtimin e saj ndaj

Zotit. Në përkujtim të kësaj, sot haxhilerët vrapojnë shtatë herë ndërmjet Safasë dhe Mervas.

Duke e parë Safanë dhe Mervan, kujtohet historia se si një shërbëtor i devotshëm i Zotit, pejgamberi Ibrahim a.s., la tokën e tij pjellore në Irak dhe erdhi në një tokë të shkretë me gruan dhe fëmijën e tij vetëm për hir të Zotit. Ky është një shembull i përsosur i besimit në Zot.

Gjëra të tjera që lidhen me Qabënë, Haxher’ul esvedi (Guri i Zi në Qabe) dhe haxhi janë gjithashtu shenja të Zotit. Ata janë simbole të monoteistit të vërtetë të orientuar nga Zoti, pejgamberit Ibrahim a.s. dhe të atyre njerëzve në histori, që bënë jetë ideale të përkushtimit ndaj Zotit. Të gjitha ritualet e haxhit kryhen mes disa prej këtyre simboleve të vendosura nga Zoti. Duke qenë në mjedisin e këtyre simboleve, njeriu ndjen se është në mjedisin e Zotit.

‘TAKIMI’ ME ZOTIN

Qabeja është ‘Shtëpia’ e Zotit të Vetëm. Është bërë nga dy pejgamber të mëdhenj të Zotit, pejgamberi Ibrahim dhe djali i tij Ismaili. Jetët e larta të këtyre dy pejgamberëve dhe sakrificat e mahnitshme që ata bënë për hir të Zotit janë të lidhura me këtë ‘Shtëpi’. Dhe më pas, jeta e përkushtimit dhe shërbimit ndaj Zotit nga Pejgamberi i fundit, Muhamedi dhe shokët e tij u shpallën në mjedisin e tij.

Përktheu: N. Ibrahim

Burimi i përkthimit: Maulana Vahiduddin Khan. *Understanding Hajj Beyond Rituals*, në: <https://www.islamicity.org/80165/understanding-hajj-beyond-rituals/>.

Qabeja është
‘Shtëpia’ e
Zotit të Vetëm.
Është bërë nga
dy pejgamber
të mëdhenj të
Zotit,
pejgamberi
Ibrahim dhe
djali i tij
Ismaili.

Normat e ihramit dhe ndikimi i tyre në përgatitjen shpirtërore

Dr. Rijad Imeri


Haxhi është një ndër adhurimet dhe obligimet më madhështore të fesë islame, dhe një ndër pesë shtyllat kryesore, mbi të cilat ndërtohet ajo, e që tregon bukurinë dhe madhështinë e kësaj feje hyjnore, e cila ngërthen në vete një laramani dhe llojllojshmëri të adhurimeve dhe të riteve, nga të cilat rifreskohen dhe rigjallërohen zemrat besimtare dhe njëkohësisht arrijnë ta shijojnë ëmbëlsinë e besimit të drejtë dhe të vërtetë.

Ajo që e dallon Islamin nga çdo fe tjetër dhe e vërteton burimin e saj hyjnor, është se në Islam, Zoti adhurohet ashtu siç dëshiron Ai, e jo siç do njeriu; kur dëshiron Ai, e jo kur dëshiron njeriu; dhe ku dëshiron Ai, e jo ku dëshiron njeriu. Pra, koha, vendi dhe forma janë përzgjedhje ekskluzive e Krijuesit të gjithësisë, të cilat ia përcaktoi dhe ia kumtoi njerëzimit përmes lajmëtarëve (pejgamberëve) të Tij. E, njeriut besimtar i mbetet ta pasoj dhe t'i nënshtrohet vullnetit të Krijuesit të tij dhe ta përmbush obligimin e tij në formën më të bukur.

Pasi që me Pejgamberin e fundit, Muhamedin a.s., u përmbyll profetësia dhe shpallja hyjnore, ai ishte i përzgjedhuri i fundit në mesin e mbarë njerëzimit, i cili kishte legjitimitetin hyjnor për kumtimin e fjalës së Zotit. Kështu që me të drejtë Pejgamberi a.s., thoshte: “Faluni ashtu siç t’më shihni duke u falur...”¹, që nënkupton se çdo veprim, që nuk përkon me veprimet e Pejgamberit a.s. në namaz, e bën atë të pavlefshëm. E njëjta gjë vlen edhe për haxhin dhe çdo adhurim tjetër në Islam. Ai i drejtohej besimtarëve në kohë haxhi me këto fjalë: “Merrni nga unë normat (ritet) tuaja (të haxhit).”²

Përzgjedhja e qytetit të Mekës si vendtakim për besimtarët nga Allahu i Madhëruar është një mirësi dhe urtësi, që e tejkalon logjikën njerëzore. E si jo, kur dihet se Meka është zanafilla e jetës njerëzore mbi sipërfaqen e tokës, ashtu siç është edhe zanafilla e besimit të drejtë dhe adhurimit të Zotit të vërtetë.

Allahu xh.sh., në Librin e Tij famëlartë, thotë: “*Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëz, është ajo në Bekke (Mekë), e uruar dhe udhërrëfyese e popujve.*” (Ali Imran, 96).



Faltorja e parë, për ta adhuruar Krijuesin e gjithësisë, është ndërtuar nga vetë njeriu i parë dhe pejgamberi i parë, Ademi a.s.,³ për të na e dëshmuar se ky besim e ka shoqëruar njerëzimin që nga frymëmarrja e parë në këtë planet dhe do ta shoqërojë atë gjerë në frymëmarrjen e fundit dhe është i lashtë aq sa është vetë njeriu në të.

Kjo faltore e parë, e njohur edhe si Qabeja, është një-herësh edhe foleja shpirtërore e njeriut, dhe ftesa për vizitën e saj, është ftesë për një udhëtim dhe përjetim shpirtëror që do t'i hap njeriut horizonte të reja, botë-kuptime të ndryshme dhe do t'ia ndryshojnë jetën e tij në përgjithësi. Për këtë, Allahu e urdhëroi Muhamedin a.s.⁴ që t'i ftoj njerëzit për ta vizituar këtë epiqendër të besimit dhe të njerëzimit: *“Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijjnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijjnë prej rrugëve të largëta.”* (El Haxh, 27).

Vizita e Qabesë dhe përgjigjja në këtë ftesë është dëshirë e zjarrtë e çdo besimtari, por, pasi që Allahu xh.sh., nuk e ngarkon askënd përtej mundësive të tij, me mëshirën e Tij i liroi ata që nuk kanë mundësi fizike apo financiare për ta përmbushur këtë obligim, duke thënë: *“Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo.”* (Ali Imran, 97).

Por, ata që Allahu i Madhëruar i përzgjedhi për ta vizituar Qabenë, duke ua ofruar atyre mundësitë për një gjë të tillë, duhet të nxitojnë në përmbushjen e këtij obligimi madhor.

Muhamedi a.s., ka thënë: *“Pelegrinët e haxhit dhe të umres janë mysafirët e Allahut, nëse kërkojnë prej Tij, do ua përmbush kërkesat e tyre, nëse i luten Atij, Ai u përgjigjet atyre, dhe nëse kërkojnë falje prej Tij, Ai do t'i fal ata.”*⁵

Mirëpo, me gjithë vlerën dhe rëndësinë që ka kryerja e haxhit, njeriu duhet t'i plotësojë edhe normat e tij, përndryshe rrezikon ta humb shpërblimin e tij, e ndoshta edhe të mos i pranohet fare haxhi i tij.

Fillimisht, besimtari duhet ta kontrolloj zemrën e tij, ta shikoj njetin e tij dhe të mos lejoj që kryerja e haxhit të ketë ndonjë qëllim tjetër përpos kënaqësisë së Krijuesit të Tij.

Pejgamberi a.s., e sqaron bukur rëndësinë e njetit në vepra duke thënë: *“Me të vërtet veprat llogariten sipas qëllimit, dhe çdo njeri do të shpërblehet sipas qëllimit që ka...”*⁶

Andaj sa më i pastër dhe më i sinqertë që është nijeti, aq më e bukur do të jetë vepra, më i lehtë do të jetë pranimi dhe më i madh do të jetë shpërblimi.

Imam Gazaliu, në librin e tij të mirënjohur *“Ihja ulum ed Din”*, duke folur për sinqeritetin e besimtarit në kryerjen e haxhit, e sjell një transmetim rrëqethës, i cili i përshkruan qëllimet e njerëzve në vizitën e Qabesë: *“Kur të vijë fundi i botës, njerëzit që do të dalin për në haxh do të jenë katër lloje: sundimtarët do të dalin për argëtim, të pasurit do të dalin për tregti, të varfrit do të dalin për lypje dhe lexuesit (dijetarët) do të dalin për famë.”*⁷

Ai vazhdon duke thënë: *“Në këtë transmetim ka një tregues të qartë për një sërë qëllimesh të kësaj bote që mund të ndërliken me haxhin. Të gjitha këto janë nga ato që e pengojnë vlerën e haxhit, e ulin virtytin e haxhiut dhe e nxjerrin atë jashtë kornizës së një haxhi të vërtetë dhe të pranueshëm.”*

Pasi besimtari ta pastroj njetin e tij, le të shikojë në pasurinë e tij, se si është fituar ajo, ngase Allahu është i pastër dhe nuk e pranon vetëm se të pastrën, e nëse ajo është fituar përmes padrejtësive dhe mashtrimeve, le të pendohet sinqerisht dhe le t'ua kthej njerëzve të drejtat e tyre, ngase kjo mund të jetë një pengesë serioze në këtë udhëtim shpirtëror. Muhamedi a.s., një ditë, përderisa i këshillonte shokët e tij, e ceku një njeri i cili e zgjati udhëtimin e tij, i rraskapitur e i pluhurosur, i shtriu duart drejt qiellit duke thënë: *“O Zoti im, o Zoti im!”*, ndërkohë që ushqimi i tij ishte haram, pija e tij ishte haram, veshja e tij ishte haram dhe ishte ushqyer me haram, e si mund t'i pranohej lutja atij?⁸

Omeri r.a., ka thënë: *“Nëse një njeri e bën haxhin me pasuri që nuk është e lejuar (haram) dhe thotë: “Lebbejke Allahumme lebbejk” (të përgjigjem ty o Allah të përgjigjem), Allahu thotë: “Nuk ka përgjigje për ty dhe as pranim për ty, kjo (vepër) të është kthyer mbrapsht.”*⁹

E Allahu xh.sh., duke folur për përgatitjet për haxh, i këshillon besimtarët që të furnizohen për rrugëtim dhe i orienton kah ajo që është më sublime në çdo gjë, duke thënë: *“...dhe furnizohuni me çka ju nevojitet për rrugë. Porse furnizimi më i mirë është devotshmëria...”* (El Bekare, 197).

Ngase ai që është i pajisur me devotshmëri do ta kontrolloj zemrën, veprën, pasurinë dhe adhurimin e tij, e nëse ajo mungon, atëherë çdo gjë do të jetë e mangët.

Vizita e Qabesë dhe përgjigjja në këtë ftesë është dëshirë e zjarrtë e çdo besimtari, por, pasi që Allahu xh.sh., nuk e ngarkon askënd përtej mundësive të tij, me mëshirën e Tij i liroi ata që nuk kanë mundësi fizike apo financiare për ta përmbushur këtë obligim.



Pastaj le ta zgjedh rrobën e tij të haxhit (ihramin), edhe pse ihram nuk quhet rroba, por gjendja e haxhiut përgjatë haxhit të tij, me të cilën e fillon me veshjen e rrobës (ihram), gjersa të lirohet prej tij. Rroba duhet të përbëhet prej dy pjesëve, pjesa e poshtme (izar) dhe e epërme (ridaa), të cilat nuk duhet të jenë të qepura (jo të mbyllura), kjo është për meshkuj, përderisa për femra nuk ka rregulla të posaçme, megjithëse për dy palët preferohet ngjyra e bardhë. Muhamedi a.s., i këshillonte shokët e tij të vishnin rrobat me ngjyrën e bardhë: “Vishni nga rrobat tuaja të bardha, sepse ato janë ndër rrobat më të mira tuaja, dhe mbështillni (qefinosni) në to të vdekurit tuaj.”¹⁰

Ngjyra e bardhë tregon pastërti dhe dëlirësi, e kjo veshje duhet t’ia kujtoj njeriut siç është pamja e tij e jashtme e pastër, ashtu duhet të jetë edhe brendësia e tij.

E nga lutjet profetike ishte edhe kjo: “O Allah, më pastro nga gjynahet e mia me ujë, borë dhe breshër, dhe pastroje zemrën time nga gjynahet ashtu siç le të pastrohet rroba e bardhë nga papastërtia dhe largo mes meje dhe gjynaheve të mia ashtu siç ke larguar Lindjen nga Perëndimi.”¹¹

Gjithashtu rroba e bardhë ia kujton njeriut stacionet më të rëndësishme të jetës së tij, ngase kur u lind ai, u lind i çiltër pa mëkate dhe u mbështoll me të bardhë nga prindërit e tij, e në haxh mbështillet sërish me të bardhë, duke synuar që të lirohet nga gjynahet ashtu siç erdhi në këtë botë, pa to, dhe synimi final i tij të jetë dalja prej kësaj bote duke e ruajtur këtë bardhësi dhe pastërti, pikërisht atëherë kur të mbështillet me qefin të bardhë trupi i tij.

I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Kush e kryen haxhin në këtë Shtëpi (të Zotit) dhe nuk flet fjalë të turpshme e nuk bën mëkate, kthehet (pa gjynahe) sikur (atë ditë që) e ka lindur nëna e tij.”¹²

Pra, siç duhet njeriu të jetë i kujdesshëm me rrobën e tij të bardhë, ngase çdo damkë dhe çdo papastërti do të duket qartë mbi të, ashtu duhet të jetë i kujdesshëm me zemrën e tij, me gjuhën e tij dhe me gjymtyrët e tij.

Kjo është edhe kërkesa hyjnore për ata që dëshirojnë ta kryejnë këtë obligim hyjnor: “*Haxhi është në muaj të caktuar. Kush e bën obligim për veten haxhin në këta muaj, atëherë nuk ka fjalë të turpshme (që ftojnë në marrëdhënie intime), as mëkate dhe as grindje gjatë haxhit. Çfarëdo të mire që bëni, Allahu e di...*” (El Bekare, 197).

E gjithë kjo duhet të jetë parapërgatitje për këtë rrugëtim shpirtëror, gjersa këmba e haxhiut të shkel në vendin e shenjtë, aty ku nuk lejohet të lëndohen kafshët,¹³ e as të dëmtohen bimët, e as të shkatërrohen pemët, e as të kërkohet dyluftimi, apo të barten armët, ngase ky vend është burim paqeje dhe duhet të zotëroj paqja në çdo cep të tij, e ndër emrat e bukur të Allahut është “Es Selam” – Paqe, dhe për robërit e Tij përzgjedhi fenë që është paqe, dhe e obligoi përsëritjen në mes nesh me “Es Selam” – paqe. Kështu që, në atë vend, ngjyra, prejardhja, pamja, nuk çojnë peshë, ngase synimi është një i vetëm për të gjithë haxhilerët, që përmes adhurimit të arrijmë të jetojmë në paqe me Krijuesin, me veten dhe me njëri-tjetrin.

Haxhi ua rikujton njerëzve se jemi vëllezër të njëri-tjetrit, dhe se përparësia mes nesh nuk është fizionomia, por devotshmëria e përkushtimi. I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “O ju njerëz! Me të vërtetë, Zoti juaj është Një dhe babai juaj është një. Nuk ka përparësi një arab ndaj një joarabi, e as një joarab ndaj një arabi; as i bardhi ndaj të ziut, as i ziu ndaj të bardhi, përveçse me devotshmëri.”¹⁴

Qëndrimi para Qabesë është një moment ku bebëza e syrit zgjerohet, të rrahurat e zemrës shpejtohen, frymëmarrja

ngadalësohet, e shpirti nga shikimi i saj nuk ngopet. Është një takim i shumëpritur, një ëndërr e kamotshme, që realiteti i saj të bën të duket se ende ajo ëndërr po vazhdon.

Abdullah ibën Umeri r.a., tregon se e kishte parë të Dërguarin e Allahut a.s., duke bërë tavaf rreth Qabesë dhe e kishte dëgjuar duke thënë: “Sa e këndshme je (oj Qabe) dhe sa e këndshme është aroma jote! Sa madhështore je dhe sa madhështore është shenjtëria jote! Beto hem në Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit! Shenjtëria e besimtarit është më e madhe tek Allahu se shenjtëria jote (shenjtëria) e pasurisë dhe gjakut të tij, dhe që për të të mendohet vetëm mirë.”¹⁵

Kjo dashuri që është për këtë shtëpi të Zotit duhet të na përmbush në shumë sfera të jetës dhe ashtu siç e shenjtërojmë atë, duhet ta shenjtërojmë (të mos e cenojmë) pasurinë, gjakun dhe nderin e tjetrit. Ngase themelet e kësaj shtëpie u vunë me sinqeritet nga Ademi a.s., u ngritën me sinqeritet nga Ibrahim i a.s. dhe u mbrojtën me sinqeritet nga Muhamedi a.s..

Allahu i përshkruan momentet e Ibrahimit a.s. me të birin e tij Ismailin a.s. kur ata i ngrinin themelet e Qabesë: “(Dhe kujto atë kohë) kur Ibrahim i dhe Ismaili ngritën themelet e Qabesë (e u lutën): “O Zoti ynë! Prano prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë Ti je ai, që i dëgjon të gjitha dhe që të gjitha i di! O Zoti ynë, na bëje ne të përlulur ndaj urdhrave Tuaja! Dhe bëje që pasardhësit tanë të jenë të përlulur ndaj urdhrave Tua, dhe tregona format e ceremonive të haxhit! Pranoje edhe pendimin tonë, se padyshim, Ti i pranon pendimet dhe je mëshirues i madh!” (El Bekare, 127-128).

E saji (ecja në mes kodrinave Safa dhe Merva) na e rikujton Haxheren, këtë nënë fisnike, dhe na mëson se nëna dhe femra është pjesë e këtij besimi, pjesë e kësaj shtëpie dhe pjesë e kësaj orvatje për ngritjen e këtyre themeleve të besimit dhe lartësimit të fjalës së Zotit dhe se femra në Islam, assesi nuk duhet të anashkalohet dhe të neglizhohet, por duhet të respektohet, të nderohet dhe t’i jepet mundësit që t’i shfrytëzoj potencialet e saja në ngritjen e fjalës së Zotit.

E lirimi prej ihramit, me heqjen e flokëve (ose shkurtimin e tyre), lajmëron për një

Kjo dashuri që është për këtë shtëpi të Zotit duhet të na përmbush në shumë sfera të jetës dhe ashtu siç e shenjtërojmë atë, duhet ta shenjtërojmë (të mos e cenojmë) pasurinë, gjakun dhe nderin e tjetrit.

kapitull të ri në jetën tonë, i cili do të ngritët mbi sinqeritet dhe përulje ndaj të Gjithmëshirshmit, Fuqiploetit. Ashtu siç mbijnë flokë të reja dhe të shëndetshme pas qethjes së tyre, ashtu duhet të “mbijnë” veprat tona të mira dhe të shëndosha. Lirimi nga ihrami tregon se tani jemi të gatshëm që ta vazhdojmë jetën tonë me devotshmëri, gjersa ta dorëzojmë shpirtin tonë dhe të pushojë trupi jonë në pëlhurën e bardhë.

“O Allah, mëshiroj të rruajturit (kokat e tyre)!” bënte lutje i Dërguari i Allahut, “Po ata që i shkurtojnë flokët e tyre?” – e pyetën shokët e tij. Muhamedi a.s., lutej sërish: “O Allah, mëshiroj të rruajturit!” “Po ata që i shkurtojnë flokët e tyre o i Dërguar i Allahut?” “O Allah, mëshiroj të rruajturit!” vazhdoi i Dërguari i Allahut. “Po ata që i shkurtojnë flokët e tyre Pejgamber i Zotit?” “Mëshiroj o Allah edhe ata që i shkurtojnë flokët e tyre”,¹⁶ tha i Dërguari i Allahut duke e përmbyllur lutjen e tij.

- 1 Muhamed Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*. (1, Damask, Dar Ibën Kethir, 1993), 226.
- 2 Muslim b. Haxhaxh, *Sahihu Muslim*. (4, Bejrut, Dar Tuk en Nexhah, 2012), 79.
- 3 Shih Muhamed b. Abdullah el Ezreki, *Akhbaru Mekeh*. (4, Bejrut, Dar Andalus, 1983), 36.
- 4 Sipas mendimit të disa dijetarëve, në mesin e tyre Hasan el Basriu, urdhri në këtë ajet kuranor është për Muhamedin a.s. që t’i ftoj njerëzit për haxhillëk, e jo për Ibrahimin a.s., edhe pse cekja e tij në ajetin e mësipërm mund të aludoj në të. Shih për më shumë Tefsirin e Kurtubiut, v. 12, f. 38.
- 5 Hasan el Basriu, *Fadail Mekkeh*. (Kuvajt, Mektebetu el Felah, 2009), 34.
- 6 Buhariu, *Sahihul Buhariu*, 1, 3.
- 7 Ebu Hamid el Gazali, *Ihja Ulum ed Din*, (1, Bejrut, Dar el Marifeh, 2009), 269.
- 8 Muslimi, *Sahihu Muslim*, 3, 85.
- 9 Dejlemiu, *El Firdeus fil Hitab*, (1, Bejrut, Dar el Kutub el Ilmije, 1986), 295.
- 10 Ahmed b. Hanbel, *Musned Imam Ahmed*, (4, Muesesetu Risaleh, 2001), 94.
- 11 Buhariu, *Sahihul Buhariu*, 5, 2341.
- 12 *Sahihul Buhariu*, 3, 30.
- 13 Me përjashtim të disave që rrezikojnë jetën e njeriut ose ia vështirësojnë jetën e tij, siç janë: minjtë, akrepat, gjarpërinjtë etj..
- 14 Hanbel, *Musned Imam Ahmed*, 38, 474.
- 15 Muhamed Jezid ibën Maxheh, *Xhamiu Sunen*, (Xhebil, Dar es Sidik, 2014), 826.
- 16 Malik b. Enes, *Muvata Malik*, (Mektebeh el Ilmije, 2009), 155.



Kurbani si akt adhurimi - analizë e normave dhe qëllimeve

Dr. Azmir JUSUFI

HYRJJE

Kurbani përbën një nga format më të rëndësishme të adhurimit në Islam, i cili shfaq në mënyrë të dukshme lidhjen ndërmjet besimtarit dhe Zotit të tij. Ky akt kryhet gjatë ditëve të festës së Kurban Bajramit dhe rrënjët e tij lidhen me ngjarjen madhore të sakrificës së peygamberit Ibrahim a.s., i cili ishte i gatshëm të sakrifikoje birin e tij Ismailin a.s., në bindje të plotë ndaj urdhrit hyjnor. Ky ritual nuk duhet kuptuar vetëm si një akt formal i therjes së një kafshe, por si një shprehje e thellë e devotshmërisë (takva), e sakrificës dhe e solidaritetit shoqëror. Në këtë punim, do të trajtohen normat që rregullojnë kurbanin, si dhe qëllimet e tij shpirtërore dhe sociale, duke u mbështetur në burimet themelore islame: Kuranin dhe Sunetin e të Dërguarit a.s..

BAZA KURANORE E KURBANIT

Kurbani ka një themel të fortë në Kuran. Allahu i Madhëruar thotë: “*Ne të dhamë ty (o Muhamed) të mirat e shumta. Andaj fal namaz për Zotin tënd dhe ther kurban.*” (El Keuther, 1–2). Ky ajet e lidh drejtpërdrejt kurbanin me namazin, duke e paraqitur atë si një akt adhurimi të rëndësishëm dhe të lidhur me falënderimin ndaj Zotit.

Një ajet tjetër, që e shpjegon thelbin e kurbanit është: “*Tek Allahu nuk arrin as mishi i tyre dhe as gjaku i tyre, por tek Ai arrin devotshmëria juaj.*” (El Haxh, 37). Kurbani

Ky ritual nuk duhet kuptuar vetëm si një akt formal i therjes së një kafshe, por si një shprehje e thellë e devotshmërisë (takva), e sakrificës dhe e solidaritetit shoqëror.

simbolizon gatishmërinë për të sakrifikuar diçka të vlefshme për hir të një qëllimi dhe besimi më të lartë.

Ne jemi të vetëdijshëm se mishi dhe gjaku i kurbanit nuk do të arrijnë tek Allahu i Lartësuar, siç na udhëzoi Ai, por do të arrijë devotshmëria jonë. Pa devotshmëri, kurbanit e humbet kuptimin dhe qëllimin e tij themelor. Allahu xh.sh., nuk ka nevojë për sakrificën, mish apo gjak. Ai është i pavarur nga gjitha këto. Ai dëshiron nga ne devotshmëri, bindje dhe afërsi ndaj Tij. Vetëm kurbanit i tillë është i vlefshëm tek Allahu xh.sh., dhe vetëm nga të tillët, të devotshmit, do të pranohet kurbanit.

Gjithashtu, rrëfimi i Ibrahimit a.s., dhe Ismailit a.s., në suren Es Saffat (102–107), paraqet modelin më të lartë të bindjes dhe sakrificës: “*O biri im, unë po shoh në ëndërr se po të ther ty, prandaj shiko çfarë mendon!*” Ai tha: “*O babai im, bëj atë që të urdhërohet...*” (Es Saffat, 102-103). Krahas sprovës vjen edhe lehtësimi, e krahas sakrificës vjen edhe shpërblimi: “*O Ibrahim, ti i je përgjigjur frymëzimit në ëndërr, - dhe Ne në këtë mënyrë i shpërblejmë ata që bëjnë vepra të mira, - kjo ishte me të vërtetë një provë e vërtetë!*” (Es Saffat, 104-105).

Ky dialog përfaqëson kulmin e nënshtimit ndaj vullnetit hyjnor dhe përbën bazën simbolike të kurbanit. Gjaku i kurbanit mbron

gjakun tonë dhe gjakun e fëmijëve tanë – ashtu sikur që shpëtoi Ismailin a.s., dhe gjakun e tij.

NORMAT JURIDIKE TË KURBANIT

Therja e kurbanit bën pjesë në veprat me të cilat i afrohem Allahut xh.sh., dhe tregon një gatishmëri për sakrifikim material. Allahu xh.sh., në Kuran, në suren El Keuther, thotë: “Dhe fal namazin në emër të Zotit tënd dhe sakrifiko në emër të Tij!” (El Keuther, 2) Disa komentues të Kuranit, thonë se në ajet përmendet kurbanit, i cili theret pas namazit të Bajramit. Prandaj, sipas mendimit të dijetarëve të shkollës sonë juridike hanefite, therja e kurbanit bie në shkallën e dytë të detyrave fetare – vaxhib.

El Imam Abdullah b. Mahmud el Mevsilij el Hanefij, në librin e tij “El Ihtijaru li ta’lili-l-muhtari”, thotë se: “Therja e kurbanit është vaxhib për çdo mysliman, që është i lirë, në vendin e vet dhe që ka mundësi materiale.” Për sa i përket obligimit, Imam Tahaviu, e ka theksuar faktin se therja e kurbanit është vaxhib tek Ebu Hanifeja, ndërsa është sunet tek Imam Ebu Jusufi dhe Imam Muhamedi.

Hadithi i Muhamedit a.s., thotë: “Therri kurban, sepse është traditë (sunet) e babait tuaj Ibrahimit a.s.” (Ibën Maxhe, Sunen, 3127) Ky është urdhër dhe prej tij del obligimi i therjes së kurbanit.

Transmetohet nga Enesi r.a., se ka thënë: “Edhe Pejgamberi sakrifikoi dy desh të larmë e me brirë. Që të dy i theri me dorën e vet, duke thënë: “Bismilah (me emrin e Allahut)” e duke bërë tekbir (duke thënë: “Allahu Ekber”) dhe duke ua vendosur këmbën në faqe.” (Buhariu, Sahih, 5565, Muslimi, Sahih, 1256)

Ka shumë hadithe që tregojnë për vlerën e therjes së kurbanit, ndër të cilat mund të veçojmë hadithin në të cilin Pejgamberi a.s., thotë: “Nuk ka vepër më të dashur tek Allahu në ditën e Kurbanit Bajramit sesa derdhja e gjakut (të kurbanit).” (Tirmidhiu, El Xhamiu, 1493). Ky hadith tregon vlerën e lartë të këtij akti në aspektin shpirtëror.

Po ashtu, Pejgamberi a.s., ka thënë: “Kush ka mundësi dhe nuk ther kurban, le të mos i afrohet vendit tonë të faljes (musalas).” (Imam Ahmedi, Musned, 8273 dhe Ibën Maxhe, Sunen, 3123. Hakimi thotë se hadithi është i saktë, kurse imamët e tjerë thonë se hadithi është “meukuf”).

Këto fjalë të Muhamedit a.s., shumë qartë na tregojnë se therja e kurbanit është e obliguar, sepse, po të mos ishte kështu, Pejgamberi a.s., nuk do t’ia kishte ndaluar atij që ka mundësi e nuk therë kurban, t’i afrohej musalas – vendit ku e fali namazin Pejgamberi a.s., me sahabët.

KUSHTET E KURBANIT

Përshtatshmëria e atij që e ther kafshën (kurbanin): Çdo mysliman që ka mundësi financiare, i mençur, në moshën madhore.



Kafsha: Duhet të jetë nga llojet e lejuara (dele, dhi, lopë ose deve), pa të meta fizike.

Posedimi i mjetit me të cilin do të kryhet therja: ku përfshihet çdo mjet i mprehtë me të cilin mund të lëshohet gjak, pa marrë parasysh nëse është prej hekuri, guri apo diçkaje të ngjashme.

Koha: Fillon pas faljes së namazit të Kurban Bajramit dhe zgjat deri në ditët e teshrikut.

Nijeti (qëllimi): Duhet të jetë ekskluzivisht për hir të Allahut.

SHPËRNDARJA E MISHIT

Muhamedi a.s., porositi: “Nga kurbanet - hani, shpërndani dhe ruani.” (Buhariu, Edebul Mufred, I, 198). Tradita pejgamberike sugjeron që mishi të ndahet në tri pjesë:

1. Për familjen,
2. Për të afërmit dhe miqtë,
3. Për të varfrit dhe nevojtarët.

SHPËRBLIMI PËR KURBAN

Allahu xh.sh., përmes Pejgamberit a.s., garanton: “Pronari i kurbanit ka shpërblim për secilën qime të kurbanit.” (Ibën Maxhe, Sunen, 3127) dhe thotë: “O njerëz therrni kurban dhe shpresoni në shpërblimin për gjakun e tij, edhe pse bie në tokë gjaku i tij, ruhet tek Allahu i Lartësuar.” (Taberiu).

DIMENSIONI SHPIRTËROR I KURBANIT

Devotshmëria

Siç u përmend në ajetin e 37-të të sures El Haxh: “Tek Allahu nuk arrin as mishi i tyre dhe as gjaku i tyre, por tek Ai



arrin devotshmëria juaj”, thelbi i kurbanit është takvaja – devotshmëria. Kurbanit është një mjet për ta forcuar vetëdijen tonë dhe për ta edukuar shpirtin në sinqeritet. Ky ajet thekson qartë se qëllimi i kurbanit nuk është aspekti material i kurbanit, por sinqeriteti dhe përkushtimi i besimtarit. Pra, dimensionin shpirtëror është ai që i jep vlerë këtij akti.

Sakrifica dhe nënshtrimi

Kurbani përkujton gatishmërinë e Ibrahimit a.s., për të sakrifikuar më të dashurin e tij – Ismailin a.s.. Ky mesazh mbetet aktual për çdo besimtar: gatishmëria për të sakrifikuar dëshirat personale në emër të parimeve hyjnore.

Koncepti i kurbanit dhe viktimës nuk mund të jetë i lidhur me egoizmin, lakminë për pasuri dhe rrëmbimeve kafsharake për të mirat e dynjasë. Kuptimi i kurbanit dhe sakrificës është prirje për të mirën e përgjithshme, për ideale. Për këtë arsye, në rrugën e Allahut, e cila prinë jetën, nuk duhet të kenë ndikim egoizmi dhe lakmia, sepse, atë betejë e bëjnë të pafytyrshme.

DIMENSIONI SOCIAL DHE ETIK I KURBANIT

Kurbani nuk është një akt individual i izoluar; ai ka ndikim të thellë në shoqëri.

Solidariteti dhe sakrifica jetësore

Duke shpërndarë mishin te të varfrit, kurbanit kontribuon në uljen e pabarazive sociale dhe në përmirësimin e mirëqenies së komunitetit. Ai krijon një ndjenjë solidariteti dhe ndihmon në forcimin e lidhjeve ndërmjet njerëzve.

Duke iu afruar Zotit, ne i afrohem njëri-tjetrit përmes kurbaneve tona. Po i afrohem njeriut. Kjo është arsyeja pse ditët e Kurban Bajramit janë gjithashtu ditë të solidaritetit, fisnikërisë, gëzimit dhe vetëdijes së lartë për të mirën e përbashkët dhe komunitetin e njerëzve.

Nga anën tjetër, nuk është qëllimi i kurbanit ekskluzivisht të ndihmojmë të varfër duke iu ndarë atyre copë mishi, siç përmendet zakonisht si qëllim i kurbanit, por, qëllimi kryesor i tij është se kurbanit e përgatit shpirtin për sakrificën dhe e përgatit njeriun për jetën.

Bujaria dhe humanizmi

Bujaria dhe humanizmi janë vlera të rëndësishme që çdo besimtar duhet t'i kultivojë. Kurbanit i mëson besimtarët të jenë bujarë dhe të ndajnë me të tjerët, duke treguar dhembshuri dhe respekt. Duke vepruar kështu, ata zhvillojnë ndjenjë e përgjegjësisë dhe solidaritetit ndaj të tjerëve. Këto vlera e bëjnë besimtarin një shembull të moralit dhe humanizmit në shoqëri.

Ruajtja e traditës fetare

Ruajtja e traditës fetare ndihmon besimtarët t'i lidhin brezat dhe t'i njohin vlerat e tyre shpirtërore. Përmes përkujdesjes për zakonet dhe ritualet, ruhet identiteti fetar dhe kulturor. Kjo ndihmon gjithashtu në edukimin moral dhe shpirtëror të individit. Duke respektuar traditën, besimtarët forcojnë lidhjen me komunitetin dhe Zotin.

Tradita e therjes së kurbanit ruan dhe transmeton një nga praktikatat më të vjetra të fesë islame, duke e lidhur brezin e sotëm me historinë e pejgamberëve dhe me trashëgiminë shpirtërore.

PËRFUNDIMI

Kurbani si akt adhurimi përfaqëson një ndërthurje të thellë të besimit, sakrificës dhe solidaritetit. Ai nuk është vetëm një ritual simbolik, por një praktikë me ndikim të gjerë shpirtëror dhe shoqëror. Përmes respektimit të normave dhe kuptimit të qëllimeve të tij, besimtari arrin të përjetojë një formë të plotë të adhurimit dhe të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më humane.

LITERATURA E KONSULTUAR:

- Kur'ani (përkthim me komentim), botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës për RSS, (Prishtinë, 1988).
- Abullatif ez Zubejdi, *Buharijina zbirka hadisa (sažetak)*, El Kalem, (Sarajevë, 2004).
- Asmir Salihović, *O začudnosti govora 2 (Hutbe hafiza u BiH)*, Bokokline, (Sarajevë, 2010).
- El Imam Abdullah b. Mahmud el Mevsilij el Hanefij, *El Ihtijaru li ta'lil muhtari*, vëllimi 4, përktheu nga arabishtja: Driton Arifi, (Tiranë-Prishtinë-Shkup, 2025).
- El Munziri, *Muslimova zbirka hadisa (sažetak)*, El Kalem, (Sarajevë, 2004).
- Esad Bajić, *Kurban i hadždž*, Sabah-print, (Mostar, 2012).
- Fuad Sedić, *Ogranci imana*, El Kelimeh, (Novi Pazar, 2008).
- Mustafa Fetć, *Kazivanje sa mimbera*, (Novi Pazar, 2006).
- Rešat ef. Plojović, “Klanje kurbana je vadžib-obavezno”, *Glas islama*, (Novi Pazar, 20. shtator 2013).
- Resul ef. Rexhepi, “Disa dispozita të Sheriatit lidhur me Kurbanin”, nga uebfaqja: <https://bislame.net/kurbani/>.
- *Sahih el Buhari (El Buharijeva zbirka hadisa)*, nga arabishtja përktheu: Mahmut Karalić, Vëllimi i 6, (Novi Pazar, 2016).
- Sejid Sabik, *Legjislacioni i traditës së Profetit a.s., (Fikhus-sunneh)*, Vëllimi i dytë, AIITC, (Tiranë, 2008).
- Semir Imamović, “Propisi klanja (uopšteni propisi i propisi klanja kurbana posebno)”, *SAFF*, mars 2001, nr. 51, (Sarajevë, 2001).

E drejta e besimit dhe e adhurimeve të jomyslimanëve në shoqërinë islame

Samir Gjonoviq

Krijesa njeri është krijesa më e dalluar nga Allahu xh.sh., për faktin se Ai xh.sh., e dalloi atë me mendje dhe logjikë. Njeriu lind në frymën e pastër islame, natyrshmërinë e besimit të pastër, ashtu siç na tregon edhe Pejgamberi ynë i dashur, Muhamedi a.s.. Allahu xh.sh. i ka dhënë njeriut liri në këtë botë që ai ta zgjedh besimin e tij. Feja islame është fe e paqes, është fe e cila toleron fetë e tjera, dhe asnjëherë nuk thërret në imponim fetar apo diçka jashtë dëshirës dhe vullnetit të njeriut. Lidhur me këtë, Allahu xh.sh., në Kuranin famëlartë, thotë: “Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota.” (El Bekare, 257).

Jomyslimanët janë të lirë të jetojnë në mesin e myslimanëve, sepse ata, në këtë mënyrë, do ta shohin sjelljen e mirë të myslimanëve dhe kjo mund të bëhet shkak që ata ta përqafojnë Islamin. Sistemi islam i ruan dhe i mbron ata nga çdo e keqe, por natyrisht edhe duke iu siguruar atyre lirinë e plotë fetare. Kjo është e potencuar edhe në ajetet kuranore, prej tyre: “Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë.” (El Mumtehine, 8).

ISLAMI DHE TOLERANCA NDËRFETARE

Islami e pranon lirinë e mendimit të të gjithë njerëzve, pa marrë parasysh angazhimin e tyre fetar, duke ndaluar detyrimin e ndokujt që të besojë në diçka, të cilën nuk e konsideron të drejtë. Ai na mëson se çdo detyrim i besimit, në të vërtetë, është hipokrizi. E drejta e lirisë së shprehjes përfshin edhe të drejtën e lirisë së besimit. Islami është padyshim fe e cila të gjithë njerëzve ua pranoi të drejtën në lirinë e besimit. Islami, jo vetëm që ua ka pranuar këtë të drejtë të gjithë njerëzve, mirëpo gjithashtu urdhëroi edhe një numër të madh të garancive për realizimin e saj.¹

Liria e jomyslimanëve në mesin e myslimanëve është e mjaftueshme që ata të ndjehen të lirë për sa i përket kryerjes se ritualeve dhe besimit të tyre. Obligimi i Pejgamberit a.s. dhe obligimi i myslimanëve është që vetëm t’i paralajmërojnë ata, t’ua ofrojnë shpalljen në mënyrën më të mirë të qartë të njerëzve dhe t’ua mundësojnë atyre lirinë për të zgjedhur Islamin nëse dëshirojnë. Ata nuk janë të obliguar që t’ua imponojnë, sepse në fe nuk ka imponim.²





BASHKËJETESA SI VULLNETI I ZOTIT

Kurani famëlartë, në mënyrë eksplicite, thotë se diversiteti i bindjeve njerëzore është vullneti dhe dëshira e Zotit xh.sh., dhe se Ai është që, jo në këtë, por në botën tjetër, do të gjykojë kush ishte në të drejtën. Deri atëherë, kjo botë është një olimpiadë e punëve të mira. Edhe pse dallimet në vetvete nuk janë të mira, e as për Zotin të dashura, Ai do që ato të ekzistojnë dhe se njerëzit për këtë i ka krijuar. Po të dëshironte Ai, të gjithë njerëzit do të besonin. Kjo është një pikë kthesë vendimtare në të menduarit rreth mundësisë së bashkëjetesës në krahasim me atë të mëparshme.³ Allahu xh.sh., në ajetin kuranor, na tregon dhe thotë: “*Sikur të donte Allahu, do t’ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t’ju sprovtojë në atë që iu dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquini për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është tek Allahu, e ai do t’ju njoftojë me atë që kundërshtoheshi.*” (El Maide, 48).

E DREJTA PËR MBROJTJEN E BESIMIT TË TYRE

Pjesëtarët e një besimi tjetër kanë të drejtë në kryerjen e ritualeve të tyre dhe se ne nuk kemi të drejtë t’i ofendojmë ata për bindjet e tyre. Allahu xh.sh., na porositi në Kuran duke thënë: “*Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur*

Kurani famëlartë, në mënyrë eksplicite, thotë se diversiteti i bindjeve njerëzore është vullneti dhe dëshira e Zotit xh.sh., dhe se Ai është që, jo në këtë, por në botën tjetër, do të gjykojë kush ishte në të drejtën.

(për madhërinë e Tij). Kështu Ne i kemi zbuluar çdo populli veprimin e vet...” (El Enam, 108).

Juristët islamë, gjithashtu, qartësisht përcaktojnë se hebrenjtë nuk duhet të urdhërohen të punojnë të shtunën, as të krishterët të dielën, nëse besojnë se e kanë të ndaluar, dhe kjo e tëra në bazë të deklaratës së Pejgamberit a.s.: “Vetëm juve, hebrenjve, nuk u lejohet të punoni të shtunave.”⁴

Në lidhje me këtë temë, studiuesi anglez Timothy Winter, del me të drejtë në përfundimin që në mënyrë të vazhdueshme myslimanët kanë arritur të sigurojnë një mjedis të përshtatshëm për pjesëtarët e besimeve të tjera, me qëllim që ata t’i jetojnë lirshëm besimet e tyre. Këtë aspekt, e prek edhe historiani i njohur italian Roberto S. Lopez, i cili thotë: “Në të vërtetë, myslimanët i trajtuan të krishterët dhe hebrenjtë me një tolerancë të jashtëzakonshme për atë kohë, por u vunë një taksë të posaçme. Për të mos e paguar, mjaftonte të konvertoheshin, dhe për t’u konvertuar, mjaftonte të eliminoje apo zbusje disa besime dhe të tërhiqesh në një besim që përbëhej nga disa parime elementare të përbashkëta për të gjitha fetë monoteiste.”⁵

E DREJTA E “TË TJERËVE” NË ISLAM

Shteti islam, të huajve, iu dha pothuajse të drejta të njëjta dhe liri si qytetarëve të tij jomyslimanë. Të drejtat e tyre janë të njëjta si



të drejtat e qytetarëve jomyslimanë, përveç disa përjashtimeve që i kërkon vetë natyra e statusit të tyre ligjor, si të drejtat politike. E drejta e të huajve në shtetin islam barazohet nga ligjet e brendshme të shteti islam d.m.th., e drejta e Sheriatit, e jo nga e drejta e përgjithshme ndërkombëtare, siç është sot e zakonshme në botë. Nëse i huaji në shtetin islam hynë me një pasuri të papërfillshme, shteti islam nuk lejohet t'ia imponojë tatimet dhe doganat në vlerë të asaj pasurie, madje edhe kur vendi i tij ka vepruar ashtu si qytetarët e shtetit islam.⁶

Kur Pejgamberi a.s., migroi ne Medine, rreth gjysma e popullit të qytetit të Medinës ishin hebrenj. Pejgamberi a.s., u soll me tolerancë ndaj tyre, në Marrëveshjen e Medinës, i pranoi ata si një pjesë të ymetit dhe i përfshiu në marrëveshje. Përballë këtij qëndrimi pozitiv të tij, në vitin e dhjetë të hixhretit, Abdullah ibën Selami, me familjen e tij e pranoi Islamin. Më pas, në kohë të ndryshme, ka edhe hebrenj të tjerë, që e kanë pranuar Islamin.⁷

Shpeshherë kemi hasur në përçmimin e jomyslimanëve ndaj mysliimanëve, mirëpo porositi tona janë që të sillemi me butësi, sepse, në bazë të kësaj, paraqesim edhe fenë tonë të bukur e gjithashtu edhe shëmbëlltërinë e Pejgamberit a.s.. Nga Kurani mësojmë se në rastin e Nuhut a.s., jobesimtarët i thanë “fenë tënde e mbështesin të varfrit dhe të dobëtit”⁸ dhe Nuhu a.s., nuk veproi asgjë vetë, mirëpo

ia la në dorë Allahut xh.sh. dhe Ai (Allahu) i dënoi ata për gjynahet dhe mosbesimin e tyre.

SJELLJA JONË NË DITËT E SOTME NDAJ JOMYSLIMANËVE

Shëmbëlltëra jonë më e mirë për të na treguar ne rrugën e përshtatshme në raport me tjetrin padyshim është Pejgamberi a.s., i cili është treguar i butë ndaj tyre edhe kur kishte mundësinë të bënte me ata çfarëdo që donte. Mirëpo, siç e dimë, ai është dërguar mëshirë për mbarë botën, dhe të tillë duhet të jemi edhe ne. Në ditët e sotme hasim çdo ditë në bashkëpunim me jomysliimanët, sepse puna dhe rrugët e ndryshme të kësaj botë na bashkojnë. Padyshim sjellja jonë ndaj tyre duhet të jetë toleruese. Shoqëria islame është përgjegjëse për zbatimin e ligjit islam dhe të gjitha normave e përshkrimeve të tij, duke përfshirë edhe ato që kanë lidhje me qytetarët jomysliimanë në shtetin islam.

Shëmbëlltëra jonë më e mirë për të na treguar ne rrugën e përshtatshme në raport me tjetrin padyshim është Pejgamberi a.s., i cili është treguar i butë ndaj tyre edhe kur kishte mundësinë të bënte me ata çfarëdo që donte.

- 1 Sulejman Topoljak, *Përgjigje islame*, (Prishtinë: Dituria Islame, 2013), f. 69-71.
- 2 Ahmed Alibashiq, Muhamed Jusiq, *Dilemat bashkëkohore mysliimane*, (Shkup, Furkan ISM, 2022), f. 31.
- 3 Po aty, f. 30.
- 4 Po aty, f. 49.
- 5 Eduard Caka, *Dialogu ndërjetar*, (Tiranë: West Print, 2015), f. 127-128.
- 6 Sulejman Topoljak, *Përgjigje islame*, f. 76-77.
- 7 Ibrahim Sariçan, *Hz. Muhamedi dhe mesazhi i tij universal*, (Ankara: Publikimet e Presidencës së Çështjeve Fetare, 2018), f. 291.
- 8 Osman Nuri Topbash, *Qytetërim i virtyeteve*, (Shkodër: Progresi, 2021), f. 409.

Krijimi i njeriut nga dheu

- analizë ndërdisiplinore ndërmjet qasjes fetare dhe kimike

Mr. Njomza Sadriu

HYRJE

Çështja e origjinës së njeriut përbën një ndërkohë të rëndësishme në historinë e mendimit njerëzor, duke u trajtuar si në diskursin fetar, ashtu edhe në atë shkencor.

Në kontekstin islam, krijimi i njeriut përshkruhet si një akt hyjnor, ku njeriu formohet nga dheu dhe më pas i jepet shpirti. Në anën tjetër, shkencat natyrore, veçanërisht biokimia, biologjia molekulare dhe antropogjeneza, ofrojnë një shpjegim mbi përbërjen materiale dhe zhvillimin gradual të jetës në tokë.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë konceptin e krijimit të njeriut nga dheu në dy perspektiva: fetare dhe kimike/shkencore, duke shqyrtuar pikat e përputhjes dhe dallimit ndërmjet tyre, si dhe duke argumentuar se këto qasje mund të bashkëjetojnë në mënyrë komplementare.

KRIJIMI I NJERIUT NË PERSPEKTIVËN FETARE ISLAME

Në Islam, krijimi i njeriut përshkruhet në mënyrë të detajuar në Kuran. Në disa ajete përmendet qartë se njeriu është krijuar nga dheu, argjila apo balta: “Ne e krijuam njeriun nga një esencë balte.” (El Muminun, 12–14);

Komentuesit klasikë të Kuranit, si Ibën Kethiri dhe El Kurtubiju, theksojnë se krijimi nga dheu bart një mesazh të fortë moral: njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm për origjinën e tij modeste dhe të mos bjerë në mendjemadhësi.

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një njeri nga balta.” (Sad, 71–72).

Këto përshkrime sugjerojnë një origjinë materiale të trupit njerëzor, duke theksuar lidhjen e tij me tokën. Megjithatë, procesi i krijimit nuk përfundon me aspektin fizik. Kurani thekson se pas formimit të trupit, njeriu i është dhënë shpirti (ruhi), duke e ngritur atë mbi krijesat e tjera materiale.

Hadithet e Pejgamberit Muhamed a.s., e plotësojnë këtë narrativë duke përmendur se njeriu është krijuar nga përzierja e elementeve të tokës, gjë që shpjegon dallimet fizike dhe karakteriale ndërmjet njerëzve. Ky interpretim i jep dimension antropologjik dhe etik konceptit të krijimit.

Komentuesit klasikë të Kuranit, si Ibën Kethiri dhe El Kurtubiju, theksojnë se krijimi nga dheu bart një mesazh të fortë moral: njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm për origjinën e tij modeste dhe të mos bjerë në mendjemadhësi. Kjo qasje e vendos njeriun në një raport të drejtpërdrejtë me Krijuesin, duke e lidhur ekzistencën e tij me përgjegjësinë morale dhe shpirtërore.

PËRBËRJA KIMIKE E DHEUT DHE TRUPIT NJERËZOR

Nga perspektiva shkencore, dheu është një përzierje komplekse mineralesh dhe



elementesh kimike. Argjila, si një nga përbërësit kryesorë të dheut, përmban kryesisht oksigjen, silikon, alumin, hekur, kalcium dhe magnez. Këto elemente janë të rëndësishme për strukturën e tokës dhe për ciklet biogjeokimike.

Ndërkohë, trupi i njeriut përbëhet nga një numër relativisht i kufizuar elementesh, ku katër prej tyre – karboni, hidrogjeni, oksigjeni dhe azoti (CHON) – përbëjnë mbi 95% të masës trupore. Këto elemente janë bazë për formimin e molekulave organike si:

- Proteinat, të cilat ndërtojnë indet dhe kryejnë funksione enzimatiqe;
- Lipidet, që shërbejnë si burim energjie dhe komponentë të membranave qelizore;
- Karbohidratet, që sigurojnë energji të shpejtë;
- Acidet nukleike (ADN dhe ARN), që mbartin informacionin gjenetik.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se elementet që përbëjnë trupin e njeriut gjenden në natyrë dhe janë pjesë e cikleve të Tokës. Për shembull, karboni qarkullon në atmosferë, tokë dhe organizma të gjallë përmes ciklit të karbonit, ndërsa azoti përmes ciklit të azotit.

NGA MATERIA INORGANIKE TE JETA – PERSPEKTIVA BIODIMIKIJE

Një nga çështjet më të rëndësishme në shkencë është kalimi nga materia jo e gjallë (inorganike) në materie të gjallë (organike), e njohur si abiogjenezë. Eksperimente si ai i Miller-Urey (1953), kanë treguar se në kushte të caktuara, molekulat organike bazë mund të formohen spontanisht nga përbërës inorganikë.

Ky proces sugjeron se jeta mund të ketë lindur nga përbërës të thjeshtë kimikë që gjenden në tokë – një ide që rezonon në mënyrë interesante me konceptin fetar të krijimit nga dheu. Megjithatë, shkencën ende nuk ka një përgjigje përfundimtare mbi mënyrën se si u formuan sistemet komplekse biologjike si qeliza.

Në biologjinë moderne, theksohet se organizmat e gjallë janë sisteme shumë të organizuara, ku ndërveprimi ndërmjet molekulave ndjek ligje të sakta fiziko-kimike. Ky kompleksitet i lartë ngre pyetje filozofike mbi natyrën e jetës dhe origjinën e saj.

Diskutim: përputhshmëria dhe dallimet ndërmjet dy qasjeve

Në shikim të parë, qasja fetare dhe ajo shkencore mund të duken të ndryshme, pasi njëra bazohet në shpalljen hyjnore, ndërsa tjetra në metodat empirike. Megjithatë, një analizë më e thellë tregon se ato trajtojnë nivele të ndryshme të realitetit.

Perspektiva fetare fokusohet në:

- kuptimin e ekzistencës njerëzore,
- qëllimin e jetës, dhe
- dimensionin moral dhe shpirtëror.

Ndërsa perspektiva shkencore merret me:

- përbërjen materiale të trupit,
- proceset biologjike dhe kimike, dhe
- mekanizmat e funksionimit të jetës.

Koncepti i “dheut” në tekste fetare mund të interpretohet jo vetëm në mënyrë literale, por edhe si një metaforë për burimin natyror të elementeve që përbëjnë trupin e njeriut. Në këtë mënyrë, shkencën dhe feja nuk janë në konflikt, por ofrojnë dy perspektiva të ndryshme që plotësojnë njëra-tjetrën.

Analiza e krijimit të njeriut nga dheu në perspektivë fetare dhe kimike tregon se:

- Feja thekson dimensionin shpirtëror, moral dhe qëllimin e ekzistencës njerëzore, dhe
- Shkencën shpjegon përbërjen materiale dhe proceset që e mundësojnë jetën.

Pavarësisht metodologjive të ndryshme, të dyja qasjet bashkohen në një pikë të përbashkët: njeriu është i lidhur ngushtë me natyrën dhe elementet e saj. Ky përfundim hap rrugë për një dialog konstruktiv ndërmjet fesë dhe shkencës, duke promovuar një kuptim më të plotë të qenies njerëzore.

Referencat

- Alberts, Bruce, Alexander Johnson, Julian Lewis, David Morgan, Martin Raff, Keith Roberts, dhe Peter Walter. *Molecular Biology of the Cell*. 6th ed. New York: Garland Science, 2015.
- Al-Qurtubi. *Al-Jami' li Ahkam al-Qur'an*. Cairo: Dar al-Kutub al-Misriyya, n.d.
- Ibn Kathir, Ismail ibn Umar. *Tafsir al-Qur'an al-Azim*. Beirut: Dar al-Fikr, 1999.
- Miller, Stanley L. “A Production of Amino Acids Under Possible Primitive Earth Conditions.” *Science* 117, no. 3046 (1953): 528–529.
- Nelson, David L., dhe Michael M. Cox. *Lehninger Principles of Biochemistry*. 8th ed. New York: W.H. Freeman, 2021.
- “The Chemical Composition of the Human Body.” *Journal of Chemical Education* 91, no. 12 (2014): 2135–2140.
- The Qur'an. Përkthime të ndryshme (p.sh. Sahih International ose Pickthall).

Përgjegjësia fetare dhe verifikimi i informacionit në epokën digjitale

Festim Rizanaj, PhD

Në rrjetet sociale qarkullojnë shpesh citime të shkëputura nga konteksti, interpretime të shtrembëruara të teksteve fetare apo edhe lajme të rreme që pretendohen se lidhen me fenë.

Në epokën e mediave sociale dhe komunikimit të menjëhershëm, informacioni përhapet me një shpejtësi, që dikur ishte e paimagjinueshme. Megjithatë, bashkë me shpejtësinë e informacionit është rritur edhe rreziku i keqinformimit. Kjo bëhet veçanërisht problematike kur informacionet lidhen me fenë, një fushë që prek identitetin, besimin dhe ndjenjat e thella të njerëzve. Në këtë kontekst, verifikimi i informacionit fetar në sferën digjitale nuk është vetëm një praktikë gazetareske apo akademike, por edhe një nevojë shoqërore dhe morale.

Në rrjetet sociale qarkullojnë shpesh citime të shkëputura nga konteksti, interpretime të shtrembëruara të teksteve fetare apo edhe lajme të rreme që pretendohen se lidhen me fenë. Një video e manipuluar, një citat i rremë apo një fotografi e nxjerrë jashtë kontekstit, mund të krijojë brenda pak orësh një valë reagimesh emocionale dhe tensione shoqërore. Në shumë raste, këto përmbajtje përdoren për qëllime politike, propagandistike apo për të nxjerrë përçarje ndërmjet komuniteteve fetare.

VERIFIKIMI I INFORMACIONIT, PËRGJEGJËSI E PËRDORUESVE TË MEDIAVE SOCIALE

Verifikimi i informacionit është edhe përgjegjësi e çdo përdoruesi të mediave sociale. Çdo klikim, çdo shpërndarje dhe çdo

koment, mund të kontribuojë në përhapjen e së vërtetës ose, për fat të keq, të keqinformimit.

Në rrjetet sociale shpesh gjenden faqe, që përdorin elemente fetare për t'i dhënë legjitimitet përmbajtjeve që publikojnë. Këto faqe mund të përfshijnë emërtime që përdorin terminologjinë islame, si Kuran, hadith, ose simbole fetare, por nuk ka informacion të qartë se kush qëndron prapa tyre. Si rezultat, ato nuk mund të merren si burime të besueshme për informacion fetar. Përmbajtja e tyre krijon një "mjegulli informative" rreth çështjeve fetare, duke goditur autoritetin e dijes së vërtetë dhe duke ndikuar në perceptimin e besimtarëve dhe lexuesve.

Një shembull ilustrues së fundmi është përhapja në rrjetet sociale e një imazhi ku kryeministri i Spanjës, Pedro Sánchez, shfaqet me Kuran në dorë, shoqëruar me pretendimin se në Spanjë është miratuar një rregull i ri, sipas të cilit kushdo që fyen Pejgamberin Muhamed a.s., ose nuk respekton Kuranin dënohet me deri në 5 vjet burg. Verifikimi tregon se imazhi është i manipuluar dhe pretendimi i pavërtetë; një ligj i tillë nuk ekziston në Spanjë, ndërsa Kodi Penal parashikon vetëm gjoba për ofendimin e ndjenjave fetare, jo 5 vjet burg.

Në dekonstrukcion të këtij shembulli, vërehen dy elementë thelbësorë: imazhi me Kuran në dorë dhe referenca e drejtpërdrejtë tek Islami dhe Pejgamberi Muhamed a.s.. Për shkak të ndjeshmërisë së këtyre elementeve,

përdoruesit shpesh nuk ndihen të autorizuar të verifikojnë informacionin, por e marrin të mirëqenë dhe e shpërndajnë me të tjerët. Kjo sjell një përhapje masive të keqinformimit dhe ndikon në formimin e perceptimeve të pasakta për fenë dhe besimtarët.

Në këtë peizazh informativ ka edhe keqinformime rreth statusit ose deklaratave të figurave fetare që nuk janë thënë realisht. Një citim i manipuluar, madje edhe pa asnjë burim të qartë, qarkullon si “fjala e dijetarit” në shumë grupe dhe kanale, duke mos dhënë asnjë mundësi për verifikim të pavarur. Këto raste, jo vetëm deformojnë botëkuptimin e fesë, por edhe nxisin polarizim dhe ndarje brenda komuniteteve.

Një problem tjetër i madh në sferën digjitale është përdorimi selektiv i citateve fetare për të justifikuar qëndrime ideologjike apo politike. Shpesh citohen fragmente nga tekstet fetare pa kontekstin historik, interpretimin teologjik apo rrethanat në të cilat janë shpallur. Për shembull, një hadith apo një ajet nga Kuran mund të paraqitet i shkëputur nga dialogu i përgjithshëm, qëllimet morale të tij, ose ligji që ka krijuar rrethanën e shpalljes. Kjo mund të çojë në keqkuptime serioze dhe në krijimin e stereotipave për një fe apo komunitet të caktuar, duke përhapur paragjykime që nuk kanë bazë. Për përdoruesit e zakonshëm të rrjeteve sociale, këto përmbajtje duken të besueshme, sepse shoqërohen me elemente fetare dhe simbole autoritative, por në realitet ato janë dezinformata selektive që manipulojnë perceptimet.

Prandaj, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje të ndjeshme, si konflikti ose temat fetare, përdoruesit duhet të kenë parasysh se gjetja e informacionit të saktë kërkon një qasje aktive dhe kritike.

NDJESHMËRIA NDAJ ZHVILLIMEVE NË LINDJEN E MESME DHE PËRGJEGJËSIA PËR VERIFIKIMIN E INFORMACIONIT

Në konfliktet ndërkombëtare, sidomos në Lindjen e Mesme, rrjetet sociale shpesh mbushen me imazhe dhe video që pretendojnë se tregojnë situatën në Gaza, Izrael, Iran apo tensionet ndërkombëtare midis ShBA/Izrael dhe Iranit. Shumë prej këtyre përmbajtjeve nuk lidhen realisht me ngjarjet aktuale; ato mund të jenë materiale të vjetra, të manipuluar ose të krijuara nga inteligjenca artificiale (AI). Megjithatë, për shkak të ndjeshmërisë fetare dhe emocionale që ato përmbajnë – referenca në Kuran, hadith, ose simbolika fetare, shumë përdorues i shpërndajnë pa verifikim, duke rritur përhapjen e keqinformimit.

Në praktikë, kjo do të thotë se edhe përmbajtjet që duken dramatike ose “të lidhura drejtpërdrejt” me ngjarjet reale shpesh nuk reflektojnë të vërtetën. Edhe pse disa përmbajtje janë reale, problemi kryesor mbetet keqinformimi. Për shkak të volumit të madh të informacionit dhe emocionit që ato

përmbajnë, përdoruesit shpesh nuk arrijnë të bëjnë dallimin ndërmjet realitetit dhe përmbajtjes së manipuluar.

Prandaj, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje të ndjeshme, si konflikti ose temat fetare, përdoruesit duhet të kenë parasysh se gjetja e informacionit të saktë kërkon një qasje aktive dhe kritike. Kontrolli i burimeve, kërkimi i kontekstit, krahasimi me informacione të besueshme dhe qëndrimi i gatshëm për të mos shpërndarë materiale para se të verifikohen janë të domosdoshme. Kjo nuk është thjesht një



çështje teknike; është një përgjegjësi morale dhe shoqërore, që ndihmon në ruajtjen e njësisë, drejtësisë dhe paqes në komunitet, duke kufizuar ndikimin e keqinformimit që shpesh përhapet përmes mediave sociale.

PARIMET FETARE PËR VERIFIKIMIN E INFORMACIONIT NË RAPORT ME REALITETIN E MEDIAVE SOCIALE

Parimet fetare për verifikimin e informacionit bëhen edhe më të qarta kur krahasohen me realitetin e sotëm të mediave sociale, ku informacioni shpesh përhapet më shpejt sesa verifikohet. Siç u theksua më sipër, në hapësirën digjitale qarkullojnë shpesh përmbajtje të pasakta, citime të manipuluar, imazhe të nxjerra jashtë kontekstit apo pretendime që lidhen me fenë dhe konfliktet ndërkombëtare. Kjo situatë e bën të domosdoshëm zhvillimin e një gjykimi kritik dhe të përgjegjshëm ndaj informacionit që lexojmë dhe ndaj mënyrës se si e shpërndajmë atë. Pikërisht në këtë pikë, udhëzimet e Kuranit dhe thëniet e Pejgamberit Muhamed a.s., ofrojnë një kornizë etike dhe praktike për diskutimin dhe shpërndarjen e informacionit.

Në suren El Huxhurat, theksohet qartë nevoja për verifikimin e lajmit: *“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.”* (El Huxhurat, 6).

Ky ajat nënvizon se çdo informacion që arrin te një individ duhet të trajtohet me kujdes dhe të analizohet para se të besohet apo të shpërndahet. Në epokën digjitale, ku një postim viral mund të arrijë mijëra apo miliona njerëz brenda pak minutash, ky udhëzim është më aktual se kurrë. Ai paralajmëron për pasojat morale dhe sociale të përhapjes së lajmeve të rreme dhe tregon se përgjegjësia nuk përfundon te konsumimi i informacionit, por edhe te mënyra e diskutimit dhe shpërndarjes së tij.

Në këtë kontekst, Pejgamberi Muhamed a.s., na la një hadith që lidhet direkt me epokën e rrjeteve sociale: *“Mjafton për një njeri që të llogaritet gënjeshtar, nëse ai rrëfen të gjitha ato që dëgjon.”* (Transmeton Muslimi).

Ky hadith është jashtëzakonisht i qartë: nuk ka nevojë ta shpikësh lajmin për t’u konsideruar gënjeshtar; mjafton ta shpërndash atë pa verifikim. Çdo individ që bëhet urë për përhapjen e një gënjeshtre bëhet pjesë e saj. Në një epokë ku shpejtësia e shpërndarjes së informacionit është prioritet për shumë përdorues, ky udhëzim ka një vlerë praktike të jashtëzakonshme: ai na mëson rëndësinë e maturisë dhe reflektimit përpara veprimit.

Pejgamberi a.s., gjithashtu thekson se nxitimi për veprime pa mendim është i dëmshëm: *“Maturia (mos nxitimi) është prej Allahut, ndërsa nxitimi është prej shejtanit.”* (Trasmeton Tirmidhiu).

Në kontekstin e rrjeteve sociale, kjo do të thotë se nxitimi për të klikuar “share” pa lexuar ose verifikuar informacionin është pikërisht ai nxitim që prodhon kaos, përhap keqinformim dhe rrit tensionet brenda komuniteteve.

Kjo lidhet edhe me udhëzimet kuranore në suren El Isra: *“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.”* (El Isra, 36).

Ky ajat forcon idenë se përgjegjësia individuale ndaj informacionit është e madhe. Çdo veprim që lidhet me marrjen, diskutimin dhe shpërndarjen e informacionit ka pasoja morale. Individët duhet të ndalojnë, të kontrollojnë burimet dhe të pyesin veten: *“A e di me siguri se kjo është e vërtetë?”* Nëse përgjigja është “jo” ose “ndoshta”, zgjedhja më e mençur është heshtja dhe kërkimi i mëtejshëm i së vërtetës.

Kurani thekson gjithashtu rrezikun e përhapjes së lajmeve pa analizë nga autoritetet kompetente. Allahu xh.sh. në Kuran, thotë: *“Kur atyre u vjen ndonjë lajm i rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë ose frikën, ata e përhapin (pa e vërtetuar mirë). Por, në qoftë se këtë lajm do t’ia përcillnin (për shqyrtim) të Dërguarit dhe parisë, hulumtuesit do ta merrnin vesh prej tyre (se çfarë lajmi duhet përhapur e çfarë jo)...”* (En Nisa, 83).

Ky ajat kritikon ata që nxitojnë të përhapin lajme, pa ia lënë specialistëve dhe njerëzve me autoritet të analizojnë informacionin. Në epokën digjitale, ku secili përdorues mund të bëhet shpërndarës i menjëhershëm, mesazhi është më i rëndësishëm se kurrë: informacioni duhet të analizohet dhe verifikohet nga burime të besueshme para se të shpërndahet. Ky është një udhëzim i qartë për përgjegjësinë individuale dhe kolektive ndaj fjalës dhe informacionit, duke ndihmuar në kufizimin e keqinformimit dhe polarizimit.

Një shembull praktik është incidenti i shpifjes (el ifku) në kohën e Pejgamberit a.s.. Lidhur me këtë, Allahu xh.sh., në Kuran thotë: *“Kur e dëgjuat këtë përgojim, përse besimtarët dhe besimtarët nuk menduan mirë për njëri-tjetrin dhe të thoshin: ‘Kjo është shpifje e qartë?!’”* (En Nur, 12).

Mesazhi është i qartë: reagimi i parë nuk duhet të jetë përhapja e lajmit, por mirëbesimi dhe reflektimi, duke i dhënë përparësi mbrojtjes së nderit dhe dinjitetit të tjetrit. Në epokën digjitale, ku postimet që dëmtojnë reputacionin përhapen shpejt, ky parim është më i rëndësishëm se kurrë.

Si përmbledhje e kësaj, themi se parimet fetare për verifikimin e informacionit, udhëzimet për diskutimin dhe thëniet e Pejgamberit a.s., ofrojnë një udhëzues të qartë për jetën digjitale: zhvillim gjykimi kritik, verifikim të burimeve dhe refuzim për të shpërndarë përmbajtje të pa verifikuara. Ky kombinim, përgjegjësi morale dhe praktike, ndihmon jo vetëm në ruajtjen e së vërtetës, por edhe në promovimin e një hapësire publike më të drejtë, më të ndershme dhe më të respektueshme ndaj të tjerëve.

Ndryshoje veten dhe fjalët tua para se ta ndryshosh botën!

Elfete Sinanaj

NDIKIMI I FJALËS SË MIRË NË SHËNDETIN MENDOR DHE SHPIRTËTOR

Ne jetojmë mes fjalëve. Zgjohe mi me to. Rritemi me to. Formohemi prej tyre. Një “ti nuk mjafton”, mund të bëhet zëri i brendshëm i dikujt. Një “unë besoj në ty”, mund të bëhet forca që të ngre nga rrezimi. Fjala nuk është ajër që kalon, ajo është farë. Dhe çdo farë mbin diku në mendje, në zemër, në karakter.

Këtë e shohim çdo ditë në jetën tonë. Një prind që i thotë fëmijës “ti mundesh”, i ndërton atij vetëbesim për vite të tëra. Një

bashkëshort që përdor fjalë të mira në shtëpi, krijon qetësi dhe siguri emocionale. Një fjalë e mirë në vendin e punës, mund ta ndryshojë krejt atmosferën e ditës. Po ashtu, një koment i ashpër apo nënvlerësues, mund të mbetet në mendjen e dikujt shumë më gjatë sesa e imagjinojmë.

Sot shkenca e vërteton atë që zemra e ka ditur gjithmonë: fjala ndryshon trurin, prek trupin dhe formëson identitetin. Islami e thekson këtë me përgjegjësi të plotë. Çdo fjalë ka peshë, çdo fjalë llogaritet dhe çdo fjalë është dëshmi për ose kundër nesh. Islami e trajton fjalën si amanet.

Pejgamberi
a.s., ka thënë:
“Fjala e mirë
është sadaka.”



Pejgamberi a.s., ka thënë: “Fjala e mirë është sadaka.” Po ashtu, buzëqeshja jote në fytyrën e vëllait tënd është sadaka.

Kjo na tregon se Allahu nuk e ka kufizuar sadakanë vetëm në pasuri, por e ka bërë edhe buzëqeshjen dhe fjalën e mirë sadaka. Ne shpesh mendojmë se ndryshimi fillon me veprime të mëdha, por në fakt ndryshimet mund të fillojnë edhe me diçka shumë të thjeshtë, me mënyrën si flasim.

Realiteti që po përjeton ymeti mysliman në këto njëqind vitet e fundit është një realitet i hidhur. Për shkak të gjendjes së përgjithshme dhe sëmundjeve sociale të akumuluar, kemi shumë të rinj që ndihen të pashpresë, të dëshpëruar, të stresuar dhe pesimistë. Madje, kemi filluar të humbasim besimin edhe në vetvete.

Për ta përballuar këtë gjendje, Islami nuk ka sjellë vetëm adhurime individuale, por edhe mekanizma të fuqishëm, që forcojnë lidhjet ndërmjet njerëzve. Me qëllim që të forcohen lidhjet ndërmjet myslimanëve, Allahu ka bërë namazin me xhemat pesë herë në ditë, ku myslimanët falen së bashku në xhami. Një herë në javë është obligim që myslimanët e një lagjeje të bashkohen dhe të falin namazin e xhumasë.

Nëse një mysliman hyn në xhami dhe e gjen rreshtin të mbushur, nuk i lejohet të falet i vetëm në rresht, ai duhet të tërheqë dikë që të falen bashkë. Po ashtu, nuk lejohet të falen dy xhemate në të njëjtën kohë, me qëllim që të mos krijohet atmosferë përçarjeje.

Ramazani është një obligim për tridhjetë ditë rresht, ku i gjithë ymeti mysliman agjëron, nis ushqimin bashkë dhe e ndërpret atë sikur të ishte një familje e vetme. Ndërsa haxhi është momenti kur myslimanët takohen dhe bashkohen, të gjitha lëvizjet e tyre bëhen në të njëjtën kohë dhe veshja e tyre është e njëjtë.

Të gjitha këto veprime që Zoti i ka caktuar për robërit e Tij na bëjnë një trup të vetëm, të bashkuar dhe të pandashëm. Ashtu siç ka thënë Pejgamberi a.s.: “Shembulli i besimtarëve në dashurinë, mëshirën dhe dhembshurinë mes tyre, është si një trup i vetëm, kur një pjesë e tij sëmuret, i gjithë trupi reagon.”

Kjo lidhje nuk ndërtohet vetëm me prezencë fizike, por edhe me mënyrën si mendojmë për njëri-tjetrin. Islami na mëson të kemi mendim të mirë për tjetrin (husn edh dhann). Sa herë që dëgjojmë diçka për dikë, apo shohim një veprim që mund të keqkuptohet, ne kemi zgjedhjen: ta interpretojmë në mënyrë negative apo ta justifikojmë me të

*Allahu xh.sh.,
thotë: “Allahu
nuk e
ndryshon
gjendjen e një
populli derisa
ata ta
ndryshojnë
vetveten.”*

(Er Rad, 11).

mirë. Kjo zgjedhje ndikon drejtpërdrejt në fjalët që përdorim dhe në marrëdhëniet që ndërtojmë.

Edhe studimet psikologjike e mbështesin këtë realitet. Ato tregojnë se njerëzit që jetojnë në komunitete me mbështetje ndaj njëri-tjetrit kanë më pak stres dhe më pak sëmundje. Në të kundërt, rritet rreziku për depresion dhe probleme fizike. Kjo tregon se uniteti dhe kujdesi për njëri-tjetrin nuk është vetëm çështje fetare, por edhe nevojë biologjike dhe psikologjike.

Megjithatë, sot jemi të bombarduar nga kritika të vazhdueshme. Kjo nuk ka lidhje vetëm me të qenit konsumator, por është bërë pjesë e kulturës sonë. Na pëlqen të kritikojmë mësuesin, ligjëruesin, kolegët. Nuk ka rëndësi se kë, por kjo dukuri është bërë trend.

Kjo vihet re sidomos në përditshmëri në rrjete sociale, në biseda mes miqsh, madje edhe brenda familjes. Shpesh reagimi ynë i parë është kritika, e jo mirëkuptimi. Në vend që të pyesim çfarë ka dashur të thotë, ne nxitojmë të gjykojmë. Në vend që të arsyetojmë, ne etiketojmë.

Nëse i shikojmë komentet sot, pjesa më e madhe vetëm kritikojnë dhe e shikojnë tjetrin me syrin kritik. Ky është një reagim i zakonshëm, por nuk duhet të lejohet. Secili ka të drejtë të ketë mendimin e vet, sepse të gjithë kemi përvojat dhe perspektivat tona. Të mendosh ndryshe nuk do të thotë se je më pak i rëndësishëm, apo se je armiku i dikujt dhe nuk ke vlerë. Përkundrazi, respektimi i mendimeve të ndryshme është baza e një shoqërie të shëndetshme. Kur nënvlerësojmë dikë, ne humbasim mundësinë për të bashkëpunuar dhe për të kuptuar më mirë njëri-tjetrin. Liria e shprehjes është themeli i respektit në marrëdhënie shoqërore, dhe çdo individ duhet të ndihet i lirë të flasë pa frikë nga tallja ose kritika e padrejtë. Duke dëgjuar dhe vlerësuar mendime të ndryshme, ne krijojmë një ambient ku secili ndihet i respektuar dhe ku mund të rriten ide të reja dhe ta përmirësojnë jetën tonë të përbashkët. Çdo njeri dëshiron ndryshim për të mirën dhe përparimin e ymetit mysliman. Por, ndryshimi i vërtetë fillon nga vetja. Kur secili prej nesh përmirëson veten, atëherë forcohet edhe shoqëria.

Në këtë drejtim, edhe shkenca na jep një pasqyrë të qartë

Fjalët negative rrisin:

- kortizolin (hormoni i stresit),
- aktivitetin e amigdalës,
- reagimin “fight or flight”.



Fjalët pozitive, përkundrazi, nxisin:

- dopaminën (motivimin),
- oksitocinën (ndjenjën e lidhjes),
- uljen e stresit.

Kjo do të thotë se fjala ndërton ose shkatërron jo vetëm psikikën, por edhe balancën biokimike të trupit. Pra, para se të ndërtojme shoqërinë, ne ndërtojme fjalinë. Dhe para se të shërojmë dikë tjetër, ne duhet ta shërojmë gjuhën tonë.

Psikologjia sociale thotë sot se njerëzit kanë nevojë për lidhje të ngushta me të tjerët për të ndërjerë siguri. Takimi me njerëzit dhe ndihma reciproke e ulin stresin dhe depresionin.

Megjithatë, shumë prej nesh mendojnë se një fjalë jona, një ndërhyrje apo një akt, nuk mund ta ndryshojë realitetin, prandaj i bashkohemi karvanit. Edhe pse ndoshta nuk ndryshon gjithçka, prej nesh kërkohet të jemi pozitivë dhe aktivë. Kjo fillon me gjëra shumë të vogla, me një përsëritje të ngrohtë, me një mesazh inkurajues, me një falje kur gabojmë, me një koment që ndërton dhe jo që rrëzon. Ndonjëherë, mjafton të ndalemi dhe të mendojmë, nëse unë do të isha në vendin e tij, si do të doja të më flisnin.

Ndryshimi që kërkojmë në shoqëri nuk fillon me zhurmë, por me vetëdije. Nuk fillon me të tjerët, por me ne. Fjala jonë është një nga mjetet më të fuqishme që kemi, ajo mund të shërojë ose të lëndojë, të bashkojë ose të ndajë, të japë shpresë ose ta shuajë atë. Prandaj, para se të kërkojmë një botë më të mirë, le të fillojmë me një gjë të thjeshtë, por të thellë, ta

përmirësojmë fjalën tonë dhe mendimin tonë për tjetrin. Sepse një shoqëri e shëndetshme ndërtohet nga njerëz që flasin me mirësi, mendojnë me drejtësi dhe veprojnë me përgjegjësi.

Omeri r.a., ka thënë: “Nëse veprohen punët e liga, por në fshehtësi, ato dëmtojnë vepruesin, por nëse veprohen haptazi dhe njerëzit nuk reagojnë që të ndryshojnë, ato dëmtojnë gjithë shoqërinë. Kur individi bëhet më i mirë, ai ndikon pozitivisht te të tjerët, kur përmirësohen individët përmirësohet shoqëria. Dhe vetëm atëherë, ndryshon edhe gjendja e një populli.”

Allahu xh.sh., thotë: “Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ata ta ndryshojnë vetveten.” (Er Rad, 11).

Ndryshimi i vërtetë nuk nis nga jashtë, por nga brenda njeriut. Çdo përmirësim personal në mendim, sjellje dhe vepra reflektohet natyrshëm në rrethin shoqëror. Kur individi bëhet më i mirë, ai ndikon pozitivisht te të tjerët, kur përmirësohen individët, përmirësohet shoqëria. Dhe vetëm atëherë, ndryshon edhe gjendja e një populli.

Nëse duam një shoqëri më të mirë, nuk fillojmë me ndryshimin e botës. Fillojmë me ndryshimin e një fjale. Ndoshta nuk mund ta ndryshojmë botën menjëherë, por secili prej nesh mund ta ndryshojë fjalën e tij. Dhe kur ndryshon fjala, ndryshon edhe zemra.

Nga kujtimet e mia studentore në universitetin mijëravjeçar “Al Az’har”

Ejup Ramadani

Është evidente se, pas tërheqjes së Perandorisë Osmane nga vendet e Ballkanit Perëndimor, popullata myslimane u orientua drejt përtëritjes së kuadrove fetare dhe kulturore në Egjipt. Ndoshta ndër shkaqet kryesore ishte pozita gjeografike e Egjiptit si shtet mesdhetar. Udhëtimi për atje bëhej lehtë me anije përmes Detit Mesdhe.

Një tjetër arsye që tërhoqi vëmendjen ishte edhe ngritja e dinastisë shqiptare, e udhëhequr fillimisht nga Mehmet Ali Pasha. Fitoret e njëpasnjëshme të tij mundësuan një shkallë mëvetësie për Egjiptin dhe krijuan një klimë stabiliteti dhe sigurie. Kjo e bëri vendin një destinacion tërheqës për ata që synonin qendrat e njohura të dijes dhe shkencës islame, por jo vetëm, ndërkohë që Egjipti mbetej i famshëm edhe për historinë e tij magjepsëse dhe misterioze të faraonëve.

Të shumtë janë ata që u diplomuan në fakultetet e ndryshme të Universitetit Al Az’har, kryesisht në Sheriat dhe Usuludin. Po ashtu, janë të shumta edhe shkrimet për këta studiues. Këtu po i referohem kolegut tim, rahmet pastë, z. Qemajl Morinës, i cili ka bërë një shkrim të detajuar për studentët e Al Az’harit, të botuar në Takvimin e vitit 2010.

Andaj, dua të kaloj te përvoja ime personale. Pas vitit akademik 1966-67, e krevë Medresenë e Mesme “Alaudin” në Prishtinë, e cila asokohe ishte pesëvjeçare. Sikur të gjithë moshatarët, brenga se çfarë duhej bërë më tutje filloi të më shqetësonte mjaft. Më kujtohet fjala e fundit e hoxhës tonë, Hasan efendi Nahit: “Mbështetuni në forcat tuaja!”

U nisëm për në Beograd për ta përkthyer dokumentacionin e nevojshëm në arabisht. Më pas, në konsultim me shokët e klasës për orientimin e mëtejshëm, u dakorduam pesë shokë që t’ia mësyjmë Bagdadit: Nuhi Hajrullahu nga Gjilani, Muhamet Demiri nga Podujeva, Adem Hoxha nga Ferizaj, unë, Ejup Ramadani nga Podujeva, dhe Zejnullah Sallahu nga Ferizaj, i cili kishte shkuar disa ditë më herët.

Atje gjetëm studentë nga gjeneratat e mëhershme: Vese Dautin nga Kumanova dhe Ruzhdi Shabanin nga Tetova.

Arritëm në Bagdad me tren nga Stambolli, pas tri ditësh udhëtimi. Të lodhur dhe të rraskapitur, u vendosëm në një hotel të lirë. U përpoqëm t’i gjenim studentët e mëhershëm, por kur shkua në administratën e fakultetit kuptuam se regjistrimi për atë vit kishte përfunduar dhe ne duhej të regjistroheshim në kurset e gjuhës arabe në kuadër të Universitetit të Bagdadit.

Lajmi tjetër shqetësues ishte se, gjatë ndjekjes së kursit të gjuhës, nuk kishim të drejtë të kërkonim bursë. Ambienti i ri dhe pengesat administrative na bënë mjaft të dëshpëruar.

Pas një sugjerimi nga vendasit, filluam përpjekjet për t’u regjistruar drejtpërdrejt në fakultet. Kjo procedurë zgjati rreth dy muaj, duke kaluar nga një ministri në tjetrën, nga një zyrë në tjetrën.

Në fund, vendimi ishte si vijon: Dy nga studentët e grupit, Nuhi Hajrullahu dhe Muhamet Demiri, mund t’i vazhdonin studimet në Universitetin privat El Mustansirije, ndërsa tre të tjerët, Adem Hoxha, Zejnullah Sallahu dhe unë, Ejup Ramadani, mund t’i vazhdonim studimet në Universitetin e Basrës, i cili ndodhej pranë kufirit me Kuvajtin dhe ishte qyteti i tretë për nga madhësia në Irak, pas Bagdadit dhe Mosulit.

Një gjë ishte e qartë: kishim kërkuar fakultet dhe fakultet morëm, por jo në Bagdad, ku mbetën shokët tanë.

Pas disa ditësh, ne të tre u nisëm për në Basra me tren. Ishte një qytet i vogël dhe universiteti sapo ishte hapur. Gjithçka na dukej e zymtë. U regjistruam dhe filluam studimet. Ndërkohë, kishim bërë kërkesa për bursa dhe duhej të prisnim. Kur erdhi muaji maj, ne morëm çantat dhe u kthyem.

U rikthyem në shtëpi të dëshpëruar. Sërish ishim në një udhëkryq. Më pas morëm vesh se kërkesa jonë për t’u kthyer



në Bagdad ishte refuzuar, por një lajm i mirë ishte se na ishin ndarë bursat për të gjithë.

Në shtator u nisëm sërish. Me të arritur në Bagdad, i tërhoqëm bursat për gjithë vitin, një shumë e konsiderueshme për ne të tre.

Shpejt morëm një vendim: Unë propozova të shkonim në Kajro, gjë me të cilën u pajtuan edhe Zena dhe Ademi. Në ditët në vijim fluturova nga Bagdadi për në Kajro.

Shkuam në Medinetul Buuth, konvikt për studentë të huaj, ku takuam Abdu Setarin, Zoti e mëshiroftë. Ai na shtroi një drekë të shijshme, si një mjeshtër i vërtetë kuzhine, pasi ishim shumë të uritur.

U vendosëm në pensionin “Roma”, në qendër të Kajros, dhe filluam të njiheshim me kryeqytetin e Egjiptit, i cili asokohe numëronte rreth 12 milionë banorë. Pas disa ditësh, Zena dhe Ademi, vendosën të ktheheshin, ndërsa unë mbeta.

Paraqita kërkesën për t’u pranuar në Universitetin “Al Az’har”, por duhej pritur mbledhja e komisionit të pranimit, e cila pritej të mbahej në janar ose shkurt të vitit pasues.

Dëshpërimi sa vinte e shtoej. Në fakultet nuk mund të regjistroheshe pa bursë. Në shkurt doli bursa. Por tash përballëshim me një dilemë tjetër: çfarë të regjistronim?

Me Zenën ishim të një mendimi: nuk donim të regjistroheshim në Fakultetin e Sheriatit apo në Usuludin, ku ishin regjistruar shumica e studentëve nga Kosova.

Dikush na propozoi një fakultet të ri, ku mësoheshin gjuhë të huaja dhe që kishte një degë për përkthim simultan. Nga informacionet që morëm, na thanë se arabishten e zotëronim në nivel fillestar, ndërsa anglishtja fillonte nga e para.

Zgjedhja e fakultetit ishte një dilemë e madhe, pasi studimet zgjatnin katër vjet. Në fund vendosëm të regjistroheshim në “Kullijetu’t-Terxheme” – Fakultetin e Përkthimit Simultan.

Ligjëratat zhvilloheshin pasdite. Në ligjëratën e parë, të letërsisë angleze, profesori erdhi, u ul pranë nesh dhe na përshëndeti në anglisht. Ai mbante titullin doktor shkence dhe ligjëroi tërësisht në anglisht. Me Zenën u shikuam sy më sy, në shenjë mirëkuptimi.

Të nesërmen shkuam për të tërhequr dokumentet, por na thanë se duhej të bënim kërkesë dhe se shqyrtimi mund të zgjaste me muaj. Ishim para një fakti të kryer. E kuptuam se duhej t’i përvilnim mëngët. Vitin e parë e përfunduam me shumë vështirësi. Anglishtja ishte ajo e Shekspirit, jo e gazetave.

Disa lëndë profesionale i zhvillonim me profesorët tanë, por për shkak të mungesës së pajisjeve adekuate për audio-incizime dhe mikrofonë, orët i zhvillonim në Universitetin Amerikan në Kajro. Në vitet e mëvonshme, fakulteti u zhvendos në Medinet Nasr dhe u pajis me teknologji më moderne.

Vitin tjetër shkova në Gjermani, ku punova dy muaj dhe fitova disa të ardhura. Prej aty shkova në Londër, në Kilburn High Road Polytechnic. Paradite punë, pasdite kurs gjuhe. U ktheva me një njohuri më të mirë të anglishtes dhe iu përkushtova studimeve. Në qershor të vitit 1979 u diplomova në këtë fakultet.

Si përfundim, fakulteti ishte shumë i vështirë dhe me një numër të madh lëndësh. Megjithatë, ne krijuam një sistem pune pa kompromis, duke u aftësuar në artin e komunikimit ndërgjuhësor. Vlen të theksohet se gjuha arabe dhe ajo angleze janë ndër gjuhët më të vështira dhe jashtëzakonisht të strukturuar. Në mungesë të fjalorëve arabisht–shqip, ne shërbeheshim me gjuhë të tjera, si boshnjakishtja apo frëngjishtja, duke përdorur fjalorë të ndryshëm për të gjetur termin më adekuat.

Në vitet e mëvonshme pata fatin të punoja si mësimdhënës, duke u përqendruar në metodën e mësimin të gjuhëve të huaja përmes përdorimit të fjalorëve. Në vijim do të paraqes lëndët e secilit vit, për të ilustruar përmbajtjen studimore të fakultetit.

Shënim: Në vitin 1979 u diplomuam së bashku me Zenën.

Pas shumë vitesh, në këtë fakultet u regjistrua edhe një nxënës i imi, Nexhdet Simnica, i cili u diplomua në vitin 2003. Përveç tij, nuk pati studentë të tjerë nga Kosova në këtë drejtim.

*Ejup Ramadani
Prishtinë, 18 mars 2026*



Shteti laik dhe neutraliteti fetar në praktikën e jurisprudencës evropiane dhe Kushtetutës së Kosovës

Zyhdi Hajzeri

Shteti laik, ose *secular state*, është një koncept i thellë politik dhe juridik, që buron nga parimi i **laicitetit** – ideja që institucionet shtetërore duhet të mbeten neutrale ndaj çështjeve të fesë dhe nuk duhet ta favorizojnë asnjë fe apo besim të caktuar, përfshirë jofetarizmin. Ky neutralitet i institucionalizuar synon të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh besimin, bindjet fetare apo mosbesimin e tyre, duke shmangur çdo formë privilegji apo diskriminimi bazuar në përkatësi fetare. Laiciteti nuk do të thotë përjashtim i fesë nga jeta publike apo armiqësi ndaj saj; përkundrazi, ai synon të krijojë një mjedis ku të gjitha komunitetet fetare mund të ushtrojnë lirshëm aktivitetet e tyre, ndërsa institucionet shtetërore ruajnë neutralitetin dhe paanshmërinë e tyre.

Parimi i neutralitetit fetar bazohet në idenë thelbësore se statusi juridik dhe politik i qytetarëve nuk mund të përcaktohet nga besimi i tyre. Qytetarët trajtohen si individë, jo si përfaqësues të një feje, dhe gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime para ligjit. Ky parim është themelor për barazinë, mos diskriminimin dhe bashkëjetesën civile në shoqëritë pluraliste dhe demokratike. Nga ky

Lehtësirat e tilla mund të përfshijnë fleksibilitet në oraret e punës apo shkollës gjatë festave fetare, përdorimin e hapësirave publike për rite fetare dhe mbështetje administrative ose financiare për komunitetet fetare.

këndvështrim, laiciteti nuk pengon, por përkundrazi mbështet lirinë e besimit dhe të praktikës fetare, duke hapur hapësira ku shteti mund të ofrojë lehtësira të arsyeshme për ushtrimin e riteve fetare, festat dhe aktivitetet e komuniteteve fetare, për aq kohë sa këto lehtësira nuk favorizojnë një fe të vetme dhe nuk cenojnë neutralitetin institucional.

Lehtësirat e tilla mund të përfshijnë fleksibilitet në oraret e punës apo shkollës gjatë festave fetare, përdorimin e hapësirave publike për rite fetare dhe mbështetje administrative ose financiare për komunitetet fetare. Qëllimi nuk është promovimi i fesë, por mbrojtja e të drejtës themelore për ushtrimin e lirë të besimit, në pajtim me parimet kushtetuese të barazisë qytetare dhe respektimit të lirive individuale. Në këtë mënyrë, laicizmi krijon një pikë ekuilibri mes neutralitetit institucional dhe respektimit të lirive fetare, duke siguruar që çdo ndërhyrje apo lehtësi të jetë e proporcionale, e paanshme dhe e justifikuar.

Shembuj praktikë nga Evropa demonstrojnë qartë se shtetet laike mund të ofrojnë mbështetje të barabartë për festat dhe ritualet fetare pa cenuar neutralitetin e tyre insti-



tucional. Në Francë, një prej shembujve klasike të shtetit laik (laïcité), megjithëse nuk ekziston një religjion shtetëror, shumë festa krishtere janë pushime zyrtare për administratën publike, si Krishtlindjet apo Pashkët, dhe institutet fetare përfitojnë lehtësira të organizimit. Kjo mbështetje nuk konsiderohet favorizim fetar, sepse ajo zbatohet në kuadër të një sistemi të rregulluar dhe i ofrohet në mënyrë të barabartë edhe komuniteteve të tjera fetare që plotësojnë kriteret ligjore.

Në Gjermani, marrëveshjet e ndërprera midis shtetit dhe bashkësive fetare historikisht sigurojnë financimin edhe të pagave të klerikëve për komunitetet myslimane, hebreje dhe të tjera, në kuadër të respektimit të parimit të barazisë fetare. Edhe në Mbretërinë e Bashkuar, edhe pse monarku është formalisht kryetar i Kishës së Anglisë, komunitetet jofetare dhe fetare të tjera, gëzojnë të drejtën e plotë për të zhvilluar aktivitetet e tyre në mënyrë të lirë dhe shpesh përfitojnë lehtësira në arsimin publik, duke pasur qasje në hapësira shtetërore për observime fetare.

Këto raste praktike tregojnë se laïciteti nuk është pengesë për festat dhe ritualet fetare, përkundrazi, ai krijon mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët për të ushtruar bindjet e tyre në mënyrë të lirë dhe të respektuar nga sistemi juridik.

Republika e Kosovës funksionon po ashtu si një shtet laik dhe demokratik, ku neutraliteti institucional dhe ndarja e pushtetit nga institucionet fetare janë themelore për garantimin e të drejtave themelore të qytetarëve. Sipas neni 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “Republika e Kosovës nuk ka fe shtetërore”, duke siguruar një mjedis të barabartë dhe të paanshëm për të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësisë së tyre fetare apo jofetare. Komentari i Kushtetutës thekson se ky neutralitet është i domosdoshëm për

funksionimin demokratik të shtetit, si dhe për ruajtjen e pluralizmit fetar dhe kulturor.

Neutraliteti i shtetit shfaqet në dy aspekte: si neutralitet formal, ku institucionet shtetërore nuk favorizojnë ndonjë besim specifik, dhe si neutralitet material, ku vendimet shtetërore bazohen në ligjin pozitiv dhe interesin publik, duke shmangur ndikimin e autoriteteve fetare në rendin juridik. Një neutralitet i tillë kërkon që edhe kur shteti ndërmerr masa për të lehtësuar praktikimin e fesë, këto masa të jenë të disponueshme në mënyrë të njëjtë për të gjitha komunitetet fetare dhe jo vetëm për disa prej tyre.

Neni 38 i Kushtetutës garanton lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit, duke përfshirë të drejtën për të zgjedhur apo refuzuar përkatësinë fetare dhe të drejtën për të manifestuar besimin si publikisht, ashtu edhe privatisht. Komentari i Kushtetutës thekson se këto dispozita krijojnë një balancë ndërmjet lirisë individuale dhe interesit publik, duke lejuar praktikimin e fesë pa u diskriminuar fare dhe duke kufizuar ndërhyrjen shtetërore vetëm kur kjo është e domosdoshme për sigurinë, rendin publik, shëndetin apo të drejtat e të tjerëve.

Kjo nënkupton integrimin e një niveli të kujdesëshëm juridik, që respekton liritë themelore, por që gjithashtu siguron që praktikat fetare nuk përdoren për të cenuar të drejtat e qytetarëve të tjerë ose funksionimin e institucioneve shtetërore.

Për më tepër, neni 39 i Kushtetutës garanton autonominë e bashkësive fetare për organizimin dhe administrimin e çështjeve të tyre të brendshme. Kjo autonomi ua mundëson komuniteteve fetare të përcaktojnë strukturat organizative, ritualet dhe aktivitetet e tyre, përfshirë edukimin dhe menaxhimin e çështjeve financiare, brenda kuadrit ligjor që respekton rendin kushtetues. Shteti nga ana e tij ruan



neutralitetin dhe njëkohësisht mbështet barazinë mes qytetarëve, duke siguruar që asnjë bashkësi fetare të mos favorizohet apo diskriminohet në mënyrë të padrejtë.

Gjithashtu, jurisprudenca ndërkombëtare evropiane ka luajtur një rol thelbësor në interpretimin dhe zbatimin e neutralitetit dhe lirive fetare në praktikën shtetërore. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka zhvilluar një sërë vendimesh që nxisin balancimin mes lirisë fetare dhe interesave publike. Rasti Osmanoglu dhe Kocabaş kundër Zvicrës është një shembull ilustrues i mënyrës se si shtetet laike duhet të balancojnë lirinë e besimit fetar me interesin publik dhe parimet e barazisë. Në këtë rast, prindërit e dy vajzave myslimane kërkuan që fëmijët e tyre të mos merrnin pjesë në mësimin e notit me bashkëmoshatarë meshkuj, duke argumentuar se kjo binte ndesh me bindjet dhe praktikën fetare islame që kërkonin ndarje gjinore gjatë aktiviteteve fizike.

Shteti zviceran, duke vepruar sipas ligjeve të arsimit, refuzoi këtë kërkesë, duke argumentuar se edukimi i përbashkët i të gjithë nxënësve është thelbësor për garantimin e barazisë, integritet social dhe mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh përkatësinë fetare.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) shqyrtoi çështjen dhe konkludoi se kufizimi i kërkesës fetare ishte i justifikuar dhe proporcional me nevojën për të mbrojtur interesat e përgjithshme publike, përfshirë barazinë gjinore dhe standardet e arsimit publik. Megjithatë, gjykata gjithashtu theksoi se shteti mund të ofrojë zgjidhje të arsyeshme duke lehtësuar praktikimin e fesë, si organizimi i grupeve vetëm për vajza ose lejet për veshje të përshtatshme gjatë mësimin, pa cenuar neutralitetin institucional.

Ky vendim nënvizon një parim kyç të shtetit laik: liria fetare nuk është absolute dhe mund të kufizohet në mënyrë të arsyeshme kur ndërhyt me interesin publik, por kufizimi duhet të jetë proporcional, i paanshëm dhe i bazuar në ligj. Në këtë kuadër, rasti pasqyron qartësisht parimin e

neutralitetit shtetëror dhe barazisë, duke e krahasuar me mjedisin ligjor të Kosovës, ku nenet 8 dhe 38 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe komentari i tyre përcaktojnë se shteti nuk ka religjion zyrtar, garanton lirinë e besimit dhe ndërgjegjes, dhe mundëson praktikimin e fesë brenda kuadrit të ligjit dhe interesit publik. Ky model tregon se neutraliteti i shtetit nuk pengon lehtësimin e ritualeve dhe festave fetare, por krijon një ekuilibër të domosdoshëm ndërmjet lirive individuale, barazisë qytetare dhe harmonisë shoqërore.

Një tjetër çështje e GjEDNj, ashtu si në Church of Scientology Moscow kundër Rusisë, trajton refuzimin arbitrar të regjistrimit të një bashkësie fetare, duke vendosur se një shtet laik duhet të respektojë neutralitetin e tij institucional dhe të mos refuzojë njohjen e komuniteteve që kërkojnë të funksionojnë lirshëm, pa diskriminim. Vendimet e tilla theksojnë se neutraliteti nuk mund të përdoret si mjet për të penguar lirinë e organizimit të bashkësive fetare, por duhet të garantojë një trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjitha besimet.

Në praktikë, modeli laik i Republikës së Kosovës, nuk e kufizon praktikimin e fesë; përkundrazi, ai kërkon që askush të mos privilegohet ose të pengohet për shkak të bindjeve fetare. Në këtë kuadër, Kosova dhe shtetet e tjera laike të Evropës zhvillojnë mekanizma të barabartë për mbështetjen e festave dhe ritualeve fetare. Për shembull, në Francë dhe Belgjikë, myslimanët shpesh gëzojnë fleksibilitet në orarin e punës dhe shkollës gjatë festave si Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami, ndërkohë që komunitetet katolike dhe ortodokse kanë pushime të caktuara për Pashkët, Krishtlindjet dhe festa të tjera. Praktika e ofrimit të ditëve të pushimit apo fleksibilitetit për festat fetare në disa vende evropiane është shembull se si neutraliteti shtetëror harmonizohet me respektin ndaj diversitetit fetar.

Andaj, modeli i shtetit laik dhe i neutralitetit institucional, i zbatuar në përputhje me parimet kushtetuese, jurisprudencën evropiane dhe praktikën shtetërore, tregon se neutraliteti dhe barazia fetare nuk janë në konflikt, por janë elementë të pandashëm të një demokracie funksionale. Laiciteti, kur zbatohet me kujdes dhe respekt për parimet bazë të barazisë, lirive dhe neutralitetit, nuk pengon praktikimin e fesë, përkundrazi, ai krijon një hapësirë të sigurt, të barabartë dhe të respektuar për të gjithë qytetarët që të ushqejnë, manifestojnë dhe praktikojnë bindjet e tyre fetare në harmoni me njëri-tjetrin dhe me institucionet shtetërore.

Malli që nuk harxhohet, shtohet

Anita Gërguri

Në takimin e parë me të, për një moment, harron gjithçka veç pamjes së bukur të Qabesë. Falënderon me zemër Allahun që ta mundësoj këtë takim dhe lutjet vërshojnë njëra pas tjetrës. Hera-herës kjo pamje turbullohet se sytë dëshmojnë që zemra paska pasur shumë mall për këtë takim...

Sytë shohin bukuri, zemra dorëzohet, fillon të qash si fëmijë, pa frikën në mos keqkuptohesh.

Ti je thjesht një mysafir, ama mysafir Mbreti. Të ftoi ky Mbreti Bujar, që pranë shtëpisë së Tij, ta shpalosësh zemrën, të kërkosh me zemër të dorëzuar, falënderuese dhe super të gëzuar që po kërkon pranë Qabesë së bekuar.

E më falni ju lutem, kush tha se lumturia nuk është një vend i caktuar?

Kush tha se lumturia nuk është destinacion, që ti, kur sheh Qabenë, në moment, humb konceptin e kohës, do ta përqafosh, do të



Kërkon
Xhenetin me
po këtë
mëshirë që të
ka sjellë deri
në këtë vend.



çmallesh e t'i thuash se po, më ke munguar shumë, ani pse ky mund të jetë takimi i parë.

Ndjenja e lutjeve pranë Qabesë përjetohet ndryshe.

Gjen copëza të lutjeve, që janë strukur me vite nëpër qoshet e zemrës.

Pastaj kujton njerëz nëpër lutjet tua, që në jetën e përditshme kalojnë ditë, javë a muaj dhe nuk të kujtohen.

Flet me zërin e zemrës, fal e arsyeton këdo që ndaj teje gaboi, se dëshiron të ndiesh pastërti në zemrën tënde që nuk e ke ndier më parë, se sheh me sytë e tu se çka vërtet paska rëndësi nga kjo botë, ti dhe punët tua, andaj kërkon përulësisht faljen e Falësit Fisnik.

Kërkon Xhenetin me po këtë mëshirë që të ka sjellë deri në këtë vend.

Sa gëzim kur kujton se erdhe me mëshirën e të Mëshirshmit, prandaj kërkon pa ndal pranë derës së Tij, se Ai është Bujari.

Zgjat me lutjet tua, se zemra veç fillon të ndiejë mallin e ndarjes.

Është vendi ku sytë nuk mjaftohen me atë pamje, e zemra nuk mjaftohet me ato emocione.

E shikojnë sytë dhe ndjenja e shikimit kalon nëpër emocione të ndryshme: e shikon duke

Te Qabeja
shkon me
mijëra lutje,
dhe në
momentin e
ndarjes, të
mbetet veç një:
ta takosh edhe
një herë, edhe
shumë herë.

qarë, e shikon duke buzëqeshur, e shikon me shpresë, dëshirë e dashuri, se është Qabe.

Bërja e tavafit të fundit është moment që më nuk të largohet nga sytë, ai fillimi i largimit nga Qabeja duke e shikuar thellësisht, e duke lutur Allahun që nëse ma bën rrësk ta shohë edhe një herë, do ta dua edhe më shumë, po nëse ky është takimi ynë i fundit, bëje ta dëshmojë për mua se shumë e kam dashur takimin me të dhe pranë saj kam qarë e jam lutur me çdo lutje që kam pasur në zemër.

Tashmë i beson idesë që, te Qabeja shkon me mijëra lutje, dhe në momentin e ndarjes, të mbetet veç një: ta takosh edhe një herë, edhe shumë herë.

E në atë moment kur sytë ndahen nga ajo pamje, kupton që kjo bukuroshe qenka mall që nuk harxhohet, shtohet.

Gjallëria e atij vendi të rri nëpër vesh me ditë e javë të tëra.

Analizon çdo detaj pastaj, dhe po, e kupton se kjo botë ka disa stacione lumturie, janë të shkurtra, por freskia dhe gjurmët në zemër mbesin përjetësisht dhe nuk harrohen.

Festa e Bajramit – traditë dhe përjetim shpirtëror në kulturën tonë

Ramadan Shkodra

Festa e Bajramit është ndër festat më të dashura dhe më të përjetuara në kulturën tonë, e rrënjosur thellë në identitetin shpirtëror, fetar dhe shoqëror të popullit tonë. Edhe pse në periudha të ndryshme historike janë bërë përpjekje për të zbehur rolin e besimit, qoftë përmes presioneve ideologjike apo sistimore, ai ka mbetur i gjallë në shpirtin e njerëzve, duke u manifestuar fuqishëm në festa të tilla si Bajrami.



Kjo festë vjen pas një muaji të bekuar si Ramazani, i cili është përjetuar me agjërim, përkushtim, vetëpërmbytje, sakrificë, solidaritet dhe humanitet. Bajrami shënon përmbylljen e kësaj periudhe të veçantë reflektimi dhe afrimi me Zotin, duke sjellë me vete një ndjenjë gëzimi, lehtësimit dhe shprese për shpërblim hyjnor.

Atmosfera festive fillon që në iftarin e fundit të Ramazanit, në natën e Bajramit, kur zemrat mbushen me gëzim dhe mirënjohje. Besimtarët e presin këtë moment me emocion të veçantë, duke ndjerë se sakrificat e tyre është pranuar dhe se po hyjnë në një ditë të bekuar.

Përgatitjet për Bajramin në familjet tona kanë qenë gjithmonë të hershme dhe plot gjallëri. Qysh në fillim të Ramazanit, interesi për datën e festës dhe kohën e faljes së namazit të Bajramit ishte i madh, ndërsa me afrimin e fundit të muajit të agjërit, sidomos pas Natës së Kadrit, fillonin përgatitjet intensive. Shtëpitë pastroheshin me kujdes të veçantë, rregulloheshin oborret dhe ambientet përreth, duke reflektuar pastërtinë dhe bukurinë që i shkon kësaj feste.

Një vend të veçantë zinte përgatitja e sofrës së Bajramit. Gratë e shtëpisë, me përkushtim dhe mjeshtëri, përgatishnin ëmbëlsira tra-

Përgatitjet për Bajramin në familjet tona kanë qenë gjithmonë të hershme dhe plot gjallëri.



dicionale si bakllavaja, e cila mbetet simbol i kësaj feste, si dhe pite të ndryshme e gatime të tjera karakteristike. Për fëmijët, gëzimi shtohet edhe më shumë me rrobat e reja dhe dhuratat modeste, që e bënin festën edhe më të veçantë.

Dita e Bajramit nis herët, që në agim. Besimtarët zgjohen, pastrohen, marrin abdes dhe vishen me rrobat më të mira për t'u drejtuar drejt xhamive. Pas faljes së namazit të sabahut dhe ligjëratës së imamit, falet namazi i Bajramit, një akt adhurimi me karakter festiv, i cili pasohet nga urimet e përzemërta dhe përqafimet ndërmjet besimtarëve.

Atmosfera jashtë xhamive është po aq e gjallë dhe e ngrohtë. Në shumë vende, festa shoqërohet me aktivitete të ndryshme shoqërore dhe sportive, si gara në vrapim, hedhje guri, kërcime apo edhe gara me kuaj. Këto aktivitete jo vetëm që e gjallëronin festën, por edhe forconin lidhjet ndërmjet njerëzve dhe komunitetit.

Pas kthimit në shtëpi, Bajrami vazhdon në rrethin familjar. Një traditë e ruajtur ndër breza është vizita në varrezat e të afërmeve, ku bëhen lutje dhe përkujtohen ata që nuk janë më, duke e bërë festën edhe një moment reflektimi dhe lidhjeje shpirtërore me të kaluarën.

Më pas, familjet mbledhen rreth sofrës së Bajramit, të mbushur me gatime tradicionale dhe ëmbëlsira. Vizitat ndërmjet familjarëve, miqve dhe fqinjëve janë pjesë thelbësore e kësaj dite. Kudo që shkon apo pret mysafirë, tryeza shoqërohet me bakllava, kafë, pije dhe fruta, duke krijuar një atmosferë mikpritjeje dhe dashamirësie.

Fëmijët, si gjithmonë, janë ndër më të gëzuarit, duke marrë dhurata simbolike si bonbone apo para të vogla, që e shtojnë edhe më shumë harenë e tyre.

Një vend të veçantë Festa e Bajramit zë edhe në krijimtarinë tonë popullore. Ajo është pasqyruar gjerësisht në letërsi, në këngë, në tregime dhe në folklor, ku paraqitet herë si një festë e shenjtë që duhet çmuar e respektuar, e herë si një pikë referimi në jetën e përditshme. Në shumë rrëfime dhe shprehje popullore, Bajrami shërben si orientim kohor – “para Bajramit” apo “pas Bajramit” – duke dëshmuar për rëndësinë e tij të madhe në kujtesën kolektive dhe në

organizimin e jetës shoqërore. Kjo prani e fuqishme në krijimtarinë shpirtërore të popullit tonë tregon se Bajrami nuk është vetëm një festë fetare, por edhe një vlerë e trashëguar kulturore që jeton ndër breza.

Ndikimi i Bajramit në traditën dhe kulturën tonë ndër shekuj ka qenë aq i thellë, sa që ai ka lënë gjurmë edhe në jetën familjare dhe në emërtimet personale. Në shumë raste, fëmijët që kanë lindur gjatë ditëve të kësaj feste i kanë emërtuar me emrin “Bajram”, si shenjë gëzimi, bekimi dhe përkujtimi të kësaj dite të madhe, duke dëshmuar kështu lidhjen e ngushtë ndërmjet festës dhe identitetit tonë kulturor.

Edhe në periudha të vështira historike, si gjatë komunizmit, kur u tentua të zbehej roli i fesë, Bajrami arriti të ruajë frymën e tij dhe të mbetet një simbol i kohezionit shoqëror dhe identitetit kulturor.

Një vlerë thelbësore e kësaj feste është kujdesi për kategoritë në nevojë. Bajrami na obligon që të ndajmë nga të mirat tona, në mënyrë që edhe ata të përjetojnë gëzimin dhe begatitë e kësaj dite. Kjo frymë solidariteti dhe ndihme është pjesë e pandashme e mesazhit të Bajramit.

Në përmbyllje, Bajrami nuk është vetëm një festë, por një përjetim i thellë shpirtëror dhe një trashëgimi e çmuar kulturore. Ai vazhdon të fisnikërojë individin, të forcojë lidhjet familjare e shoqërore dhe të kultivojë vlerat më të larta njerëzore, duke e bërë shoqërinë tonë më të ndritur dhe më të bashkuar.



REPORTAZH

Promovimi i veprave “Akaidi Islam: parimet, zhvillimi dhe shkollat” dhe “Ixzazetnamet e Haxhi Sherif Ahmetit” si dëshmi e institucionalizimit të dijes dhe vazhdimësisë së mendimit islam shqiptar

Dija që lidh brezat – trashëgimia e gjallë e haxhi Sherif ef. Ahmetit

Të enjten e 23 prillit 2026, që përkonte edhe me Ditën Ndërkombëtare të Librit, në Fakultetin i Studimeve Islame në Prishtinë, u mbajt një ngjarje e veçantë kulturo-akademike. Përmes promovimit të dy veprave me rëndësi të veçantë, vëmendja në atë ditë u kthye te trashëgimia e një dijetari që la gjurmë në pashlyeshme në mendimin islam, te myderrizi i shquar, haxhi Sherif ef. Ahmetit. Veprat, “Akaidi Islam: parimet, zhvillimi dhe shkollat” dhe “Ixzazetnamet e Haxhi Sherif Ahmetit”, përmes fjalëve të referuesve, myftinjve, profesorëve dhe ish-studentëve të haxhi Sherif ef. Ahmetit, dëshmuar edhe njëherë se haxhi Sherifi nuk ishte vetëm një mësues, por edhe një udhërrëfyes shpirtëror dhe intelektual, i cili me punën dhe angazhimin e tij e ngriti mendimin islam në një nivel tjetër kombëtar dhe akademik.

Ligjëratat e haxhi Sherifit për akaidin, të mbajtura për studentët e brezit të parë të Fakultetit të Studimeve Islame, u përshkruan si një metodë e të menduarit kritik, e bazuar në burimet islame, Kuran dhe Sunet, në logjikë, si dhe në aftësinë për t'i përballuar sfidat e kohës, teksa në mënyrë të veçantë u nënvizua rëndësia e ixhazetnameve të tij, si dokumente tradicionale që i japim legjitimitet dijes së transmetuar dhe që e lidhin atë me zinxhirin e pandërprerë të dijetarëve islamë deri te Pejgamberi ynë i fundit a.s.. “Ixzazetnamet e haxhi Sherif ef. Ahmetit”, të përkthyer dhe të dokumentuara për herë të parë në gjuhën shqipe, u cilësuan si një thesar i çmuar për historinë intelektuale të myslimanëve shqiptarë.

Figura e haxhi Sherif ef. Ahmetit, në këtë ngjarje, u paraqit si shembull i dijetarit që jetoi me dije dhe për dije, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në kulturën, besimin dhe identitetin





e shqiptarëve. Në këtë mënyrë, veprat e tij mbeten jo vetëm kujtim i së kaluarës, por edhe si udhërrëfyes i gjallë për të tashmen dhe të ardhmen, duke ndërlidhur traditën me modernen.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij vlerësuese kushtuar librit “Akaidi Islam: parimet, zhvillimi dhe shkollat”, tha se haxhi Sherif ef. Ahmeti, përfaqëson figurën e dijetarit që mishëron në praktikë parimin pejgamberik, ngase veprimtaria e tij dëshmon përkushtim të thellë ndaj ruajtjes dhe transmetimit të dijes islame. Ai tha se si një ish-nxënës i haxhi Sherif ef. Ahmetit, puna në redaktimin e këtij libri, ishte një privilegj, por edhe një përgjegjësi për të. “Si ish-nxënës i haxhi Sherif ef. Ahmetit dhe, njëkohësisht, si vazhdues i misionit që ai e konceptoi dhe e mishëroi me përkushtim të jashtëzakonshëm në mësimdhënien e lëndës së Akaidit, si në Medrese ashtu edhe në Fakultetin e Studimeve Islame, redaktimin e këtyre ligjëratave e konsiderova si një privilegj të veçantë dhe një nder të thellë për mua, si dhe për kolegët e mi, që kontribuuan në përgatitjen, redaktimin dhe botimin e këtij korpusi ligjërimesh, e e cila përfaqëson një trashëgimi të çmuar intelektuale dhe teologjike” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Duke folur për përmbajtjen e këtij libri, Myftiu Tërnavë tha se ligjëratat e përmbledhura këtu ofrojnë një trajtim të gjerë dhe të thelluar të çështjeve themelore të besimit islam, duke u fokusuar në dimensionin teologjik, etik dhe praktik të tyre. Ai tha se: “Në qendër të këtyre ligjëratave qëndron njohja e Njëshmërisë së Zotit xh.sh., si parimi themelor i besimit, i cili shtjellohet në lidhje të ngushtë me ndjeshmërinë fetare, me emrat dhe cilësitë e Zotit të Madhëruar, si dhe me ndikimin që këto koncepte kanë në formimin e vetëdijes te besimtari dhe sjelljes njerëzore. Një vëmendje e veçantë i kushtohet problematikës së lirisë dhe përgjegjësisë njerëzore, raportit ndërmjet vullnetit të lirë dhe kaderit (caktimit hyjnor), si dhe

çështjes së mëkatit dhe pasojave të tij. Ligjëratat ofrojnë një kornizë konceptuale, që ndihmon lexuesin të kuptojë se besimi nuk e përjashton veprimin aktiv dhe të ndërgjegjshëm, por përkundrazi e fuqizon atë.”

Myftiu po ashtu nuk la pa përmendur kujdesin që kishte haxhi Sherif efendiu në argumentimin e ligjëratave të tij, duke potencuar faktin se ai gjithnjë bazohej në burimet kryesore sheriatike, në Kuran dhe Sunet, por edhe në mendimet e ndryshme të dijetarëve islamë, gjithnjë duke i lënë hapësirë edhe logjikës dhe arsyes, e për të cilën thoshte se është një ndër mjetet thelbësore për kuptimin dhe përvetësimin e të vërtetave të besimit. Haxhi Sherif efendiu, siç potencon Myftiu Tërnavë, thoshte gjithnjë se në Kuranin fisnik, nuk ka asgjë që bie ndesh me logjikën e shëndoshë, përkundrazi, shpallja hyjnore është në harmoni të plotë me arsyen njerëzore.

Në fund të fjalës së tij, Myftiu Tërnavë, përmendi edhe kontributin e haxhi Sherif efendiu në Medresenë “Alauddin”, punën si drejtor i saj e pastaj edhe atë si myfti i Prishtinës, duke përmendur më pas edhe kulminacionin e veprimtarisë së tij shkencore, atë të përkthimit dhe komentimit të Kuranit fisnik, më 1988. “Kulmi i veprimtarisë së tij shkencore është padyshim përkthimi dhe komentimi i Kuranit fisnik më (1988), një ndër veprat themelore të literaturës islame në gjuhën shqipe. Kjo biografi e pasur e myderriz haxhi Sherif ef. Ahmetit na bën të qartë se botimi në fjalë nuk është një përmbledhje e zakonshme ligjëratash, por një thesar i mendimit të një dijetari me përvojë të gjerë, i cili ka ditur të ndërthurë traditën, argumentin dhe saktësinë shkencore me qartësinë, butësinë dhe metodologjinë pedagogjike.”

Reisi i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, hafëz Shaqir ef. Fetahu, në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, çmoi lart figurën e një prej personaliteteve të rralla, teologut,



myderrizit, alimit dhe reformatorit të mendimit islam, haxhi Sherif ef. Ahmetit.

Ai evokoi kujtime nga të qenët nxënës i tij, duke e konsideruar atë si një nga nderet më të mëdha. “Kam pasur fatin dhe privilegjin e veçantë të jem nxënës i tij për disa vite. Ky mbetet një nga nderet më të mëdha të jetës sime. Përveç kësaj, kam qenë edhe ndjekës i përkushtuar i mendimeve të tij të shkruara, të cilat edhe sot flasin me një freski dhe aktualitet të rrallë. Prandaj, me bindje të plotë mund të them se jo vetëm unë, por mbarë shqiptarët dhe më gjerë, kanë pasur fatin të kenë një mendimtar të këtij kalibri” – tha ndër të tjera reisi Fetahu.

Për sa i përket mendimit të haxhi Sherif efendi Ahmetit, reisi Fetahu, potencoi se ai mbështetj në disa dimensione dhe ishte i ndërthurur në mënyrë harmonike. “Së pari, ai e mbështeste të gjithë veprimtarinë e tij në pastërtinë burimore të Kuranit famëlartë dhe në Sunetin e Pejgamberit Muhamed a.s.. Për të, këto nuk ishin vetëm burime fetare, por themeli i çdo ndërtimi intelektual dhe moral; Së dyti, ai i dha mendimit islam një dimension të fuqishëm racional; Së treti, qasja e tij ndaj Kuranit ishte gjithëpërfshirëse. Ai e trajtonte atë si burim të pashtershëm të udhëzimit moral, etik, pedagogjik, psikologjik, filozofik, kulturor dhe shkencor; Së katërti, ai kishte një vizion të qartë për të ardhmen; Së pesti, ai e konsideronte dijen dhe profesionalizmin si themelin e zhvillimit të shoqërisë; Dhe së fundi, ai ishte një reformator i mendimit islam. Ai e shihte reformën si domosdoshmëri të çdo kohe dhe kundërshtonte imitimimin e verbër.”

Në fund, reisi Fetahu, haxhi Sherifin e vendosin në radhën e reformatorëve më të mëdhenj të botës, bashkë me Xhemaludin Afganin, Muhamed Abduhun, Rashid Ridanë, etj., krahas figurave të ndritura shqiptare, si: hafëz Ali Korça e haxhi Vehbi Dibra.

Në fjalën e drejtorit për Kulturë dhe Veprimtari Botuese të Bashkësisë Islame të Kosovës, Ramadan Shkodra, u potencua se botimi i veprave me karakter akademik dhe didaktik përbën një ndër misionet themelore të institucioneve shkencore dhe botuese, duke qenë se një botim i mirëfilltë nuk reduktohet në një akt të thjeshtë publikimi, por përfaqëson një proces kompleks, përmes të cilit dija e vlefshme sistemohet, dokumentohet dhe transmetohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të verifikueshme te brezat e ardhshëm.

Ai tha se: “Në këtë kontekst, ky botim përforcon faktin se trashëgimia e Haxhi Sherif Ahmetit nuk është e kufizuar vetëm në dorëshkrime apo kujtime individuale, por ajo jeton dhe vazhdon përmes brezave të nxënësve të tij, të cilët sot janë personalitete të shquara në fushën akademike dhe fetare.”

Promovimi i këtyre veprave, i organizuar në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, sipas z. Shkodra, i jep këtij aktiviteti një dimension të veçantë simbolik dhe historik. “Duke qenë se pikërisht në këtë institucion Haxhi Sherif Ahmeti ka ligjëruar në fillimet e tij akademike, ndërsa ligjëratat e tij të asaj kohe tashmë janë përmbledhur në një vëllim të veçantë, duke u shndërruar në një trashëgimi të çmuar për mendimin islam në hapësirën tonë; kjo e shton edhe më tej peshën dhe rëndësinë e këtij promovimi, pasi veprat e tij prezantohen sot para ish-nxënësve dhe studentëve të tij, kolegëve, bashkëpunëtorëve, familjarëve, lexuesve të përkushtuar, si dhe para studentëve dhe pedagogëve aktualë të Fakultetit të Studimeve Islame, duke përforcuar lidhjen ndërmjet brezave dhe vazhdimësinë e traditës akademike”, potencoi ndër të tjera drejtori Shkodra.

Ai në fund tha se këto dy botime përfaqësojnë një kontribut të rëndësishëm në dokumentimin dhe zhvillimin e mendimit islam në gjuhën shqipe, e që lidhin natyrshëm traditën me kohën moderne të sotme.



Për veprën “Ixzhetnamet e haxhi Sherif Ahmetit”, më në detaje foli profesori i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkupt, dr. Ziber Lata, i cili tha se çdo fjalë e bukur që sot u tha për veprat dhe veprimtarinë e haxhi Sherif efendiut, nuk do të bartte peshën e duhur nëse nuk do të kuptohej rëndësia e ixhazetnameve. “Ixzhetnamet përfaqësojnë katër gjëra të rëndësishme për teologjinë myslimane-shqiptare: Së pari, ato përfaqësojnë mekanizmin kryesor të legjitimitit të dijes. Nëpërmjet ixhazetnameve, hoxhallarët tanë, ndër ta edhe haxhi Sherifi, morën autorizim të drejtpërdrejtë nga mësuesit për të transmetuar një disiplinë të caktuar, një libër të veçantë apo gjithë dijen e tyre, duke u bërë kështu pjesë e një zinxhiri të pandërprerë që lidhet me burimin e dijes islame e gjegjësisht me të Pejgamberin tonë a.s.; Së dyti, ixhazetnamet kanë rëndësi të veçantë në ruajtjen e metodologjisë tradicionale të arsimit; Së treti, ixhazetnamet janë burime të rëndësishme për historinë intelektuale dhe kulturore të muslimanëve shqiptarë; Së katërti, ixhazetnamet kanë edhe një dimension etik dhe shpirtëror, sepse ato nuk japin vetëm autorizim teknik, por edhe një lloj dëshmie për karakterin dhe përgatitjen morale të nxënësit.”

Meqë në fillim të fjalës së tij, dr. Lata, vlerësoi lart rëndësinë që ka një ixhazetname, ai në fund edhe shtroi pyetjen se përse haxhi Sherifi nuk vazhdoi t’u jepte ixhazetname nxënësve të tij? Ai tha se: “Haxhi Sherifi jetoi në dy epoka të rëndësishme: epokën e shkollimit klasik dhe atë modern. Ai i kuptoi shumë mirë rrethanat dhe rrjedhat e kohës, prandaj ai bashkë me hoxhallarët tjerë, arritën që dijen e ixhazetnameve ta shndërrojë dhe ta përkthejnë në institucione të rëndësishme. Ai nuk shpejtoi të japë letra të cilat mbase nuk do të kishin vlerë të madhe për kohërat që pasonin, por u angazhua që ato letra t’i kthente në institucione të rëndësishme që nxirrnin kuadro dhe literaturë të frytshme për shqiptarët myslimanë gjithandej. Haxhi Sherifi me shokët e idealit vazhduan të ngrinin në këmbë institucionet shkollore, shkencore dhe

intelektuale të shqiptarëve myslimanë, të cilat sistemi monist u zu frymën. Medreseja e Nalt u mbyll, por këta e ngritën fuqishëm medresenë “Alaudin”, komunistët mbyllën revistën “Zani i Naltë” dhe “Kultura islame”, por këta me në krye Haxhi Sherifin i dhanë jetë revistës “Edukata islame” dhe gjithë atyre veprave dhe institucioneve që buruan nga nxënësit e këtyre kolosëve të dijes islame.”

Ish-studenti i haxhi Sherif ef. Ahmetit, dr. Sadik Mehmeti, njëherësh edhe përmbledhës i ligjëratave të haxhi Sherif efendiut dhe autor i veprës “Ixzhetnamet e haxhi Sherif Ahmetit”, në fjalën e tij, nën emocionet për ngjarjen, tha se pikërisht këtu, në këtë vend ku jemi sot të mbledhur, para gati tri dekadash e gjysmë, u formua një pjesë e rëndësishme e rrugëtimit tonë. Këtu u njohëm për herë të parë edhe me myderrizin tonë të nderuar, haxhi Sherif ef. Ahmetin, dhe nga ligjëratat e tij për ne, studentët e brezit të parë të Fakultetit të Studimeve Islame.

“Sot, kur i shikojmë këto ngjarje nga distanca e kohës, e kuptojmë më thellë peshën dhe vlerën e atyre momenteve që na formësuan, na frymëzuan dhe na udhëzuan. Pikërisht kështu e kam ruajtur për vite me radhë këtë material si një amanet të çmuar, deri në ditën e sotme, kur ndjej lehtësim dhe gëzim që ai tashmë bëhet pronë e lexuesit, studiuesit dhe brezave të ardhshëm” – tha ndër të tjera prof. Mehmeti.

Ai përmbylli fjalën e tij, duke thënë se: “Disa njerëz nuk largohen kurrë plotësisht nga kjo botë, sepse mbeten të pranishëm në fjalët që kanë thënë, në dijen që kanë dhënë dhe në gjurmët që kanë lënë në zemrat e nxënësve të tyre. Haxhi Sherif efendi Ahmeti është një ndër ata njerëz. Pikërisht ashtu siç na mëson edhe Kurani, se: fjala dhe vepra e mirë jetojnë dhe japin fryte përtej kohës së tyre, si një pemë e mirë, rrënjët e së cilës janë të forta dhe degët e saj shtrihen lart në qiell.”

Përgatiti: Bajram Zeqiri

Reportazh nga vizita e Myftiut Naim ef. Tërnavë në Ankara

Zhvillimi i partneriteteve institucionale në fushën fetare, arsimore dhe kulturore

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, si dhe drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, nga data 20 deri më 22 prill 2026, realizoi një vizitë zyrtare në Ankara të Turqisë.

Gjatë kësaj vizite, përveç takimit me homologun e tij, kryetarin e DIJANET-it, dr. Safi Arpagush, delegacioni vizitoi edhe një sërë institucionesh të tjera, që veprojnë në kuadër të këtij institucioni dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Turqisë, të cilat janë të pranishme edhe në Kosovë përmes projekteve të ndryshme.

Në të gjitha takimet e zhvilluara, Myftiu Tërnavë diskutoi me drejtuesit e këtyre institucioneve për iniciativa konkrete që synojnë shtimin e projekteve të përbashkëta, si dhe

thelimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve përkatëse turke.

Kjo vizitë u vlerësua si një hap i rëndësishëm në forcimin e lidhjeve institucionale dhe në avancimin e bashkëpunimit në fushën fetare, arsimore dhe kulturore ndërmjet dy vendeve.

MYFTIU NAIM EF. TËRNAVA U PRIT NGA KRYETARI I DIJANET-IT, DR. SAFI ARPAGUSH

Gjatë vizitës zyrtare në kryeqytetin e Turqisë, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, më 21 prill 2026, u prit në takim nga kryetari i DIJANET-it të Republikës së Turqisë, dr. Safi Arpagush.

Takimi u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë dhe vëllazërore, ku u diskutua për bashkëpunimin ndër-institucional dhe për avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe DIJANET-it të Turqisë.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë, shprehu mirënjohjen e tij për pritjen e ngrohtë, si dhe falënderoi DIJANET-in për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Bashkësisë Islame të Kosovës dhe besimtarëve në vend. Ai theksoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme, veçanërisht në zhvillimin e jetës fetare, arsimit islam dhe aktiviteteve kulturore.

Nga ana e tij, kryetari i DIJANET-it, dr. Safi Arpagush, vlerësoi lart marrëdhëniet e deritanishme ndërmjet dy



institucioneve, duke shprehur gatishmërinë e plotë për zgjerimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit dypalësh. Ai theksoi se DIJANET-i do të vazhdojë të mbështesë projektet që kontribuojnë në avancimin e jetës fetare dhe në forcimin e lidhjeve ndërmjet dy vendeve.

Gjatë takimit, bashkëbiseduesit diskutuan edhe për projekte konkrete të përbashkëta, si dhe për mundësitë e rritjes së bashkërendimit në të ardhmen. Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe rrjedhës së ndërtimit të Xhamisë Qendrore në Prishtinë, me ç'rast u theksua nevoja për vazhdimin e punimeve sipas dinamikës së paraparë dhe shqyrtimin e mundësive për përshejtimin e tyre, me qëllim përfundimin sa më të shpejtë të këtij projekti të rëndësishëm.

VIZITA NË SELINË QENDRORE TË TIKÀ-S



Myftiu Naim ef. Tërnavë, më 20 prill 2026, u prit në selinë qendrore të Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) nga kryetari i saj, z. Abdullah Eren, së bashku me bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë takimit, kryetari Eren e njohu Myftiun Tërnavë me aktivitetet, projektet dhe programet që TIKA ka realizuar dhe po realizon, duke theksuar veçanërisht projektet e zbatuara në Kosovë dhe ato që pritet të nisnin në të ardhmen e afërt. Ai gjithashtu e falënderoi Myftiun për vizitën dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, shprehu mirënjohjen e tij të thellë për kontributin e TIKA-s në Kosovë, duke vlerësuar lart mbështetjen në fusha të rëndësishme si trashëgimia kulturore, arsimit, shëndetësia dhe zhvillimi ekonomik. Bashkëbiseduesit diskutuan në mënyrë të veçantë për projektet e ardhshme, me fokus në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë materiale me vlera të rëndësishme kulturore dhe historike.

VIZITA NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË VAKËFEVE

Në vijim të vizitës zyrtare në Ankara, më 20 prill 2026, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, qëndroi për vizitë në Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve të Republikës së



Turqisë, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit, ku u prit nga drejtori i përgjithshëm, z. Sinan Aksu.

Me këtë rast, Myftiu Tërnavë, falënderoi Drejtorinë për kontributin e çmuar në restaurimin dhe ruajtjen e objekteve të trashëgimisë islame në Kosovë, të cilat bartin vlera të rëndësishme monumentale, kulturore dhe historike në shumë qytete dhe lokalitete të vendit. Gjatë takimit u diskutua gjithashtu për projekte të reja që synojnë avancimin e mëtejshëm të kësaj fushe.

Myftiu Tërnavë theksoi nevojën e vazhdueshme për mbështetje në restaurimin dhe rifunksionalizimin e objekteve të trashëgimisë, shumë prej të cilave janë dëmtuar nga koha dhe mungesa e kujdesit institucional në periudha të caktuara.

Nga ana e tij, drejtori Aksu shprehu gatishmërinë e plotë të institucionit që drejton për të vazhduar programet restauruese në Kosovë. Ai bëri të ditur se në të ardhmen e afërt pritet të fillojë restaurimi i disa objekteve të rëndësishme, përfshirë Xhaminë e Atikut në Gjilan, Xhaminë Gazi Ali Bej në Vushtrri dhe Xhaminë e Hasan Agës në Rogovë të Hasit, të cilat përfaqësojnë vlera të veçanta kulturore, artistike dhe arkitektonike, si dhe një trashëgimi të pasur historike.

Në përmbyllje, Myftiu Tërnavë, shprehu falënderime të veçanta për mbështetjen e vazhdueshme që Drejtoria e Vakëfeve i ka ofruar edhe Shoqatës Humanitare “Bereqeti”.

VIZITA NË YTB

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, gjatë qëndrimit në Ankara, më 21 prill 2026, ka vizituar edhe YTB-në, ku është pritur nga kryetari Abdylhadi Turus, me të cilin biseduan për



bashkëpunimin në ruajtjen e trashëgimisë së përbashkët, pastaj për bashkëpunimin në arsim, rritjen e projekteve kulturore, si dhe aktivitetet rinore dhe sociale, të cilat po shënojnë çdo ditë rritje dhe bashkërendim.

Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve u vlerësua si vëllazëror, me mundësi për shtim dhe zgjerim të mëtejshëm.

PRITJA NË FONDACIONIN DIJANET

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, gjatë qëndrimit të tij në Ankara, më 21 prill 2026, ka vizituar edhe Fondacionin DIANET të Turqisë, ku është pritur nga drejtori i përgjithshëm, z. İzani Turan.

Myftiu Tërnavë e falënderoi drejtorin e përgjithshëm të Fondacionit për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës dhe institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Nga ana e tij, drejtori i Fondacionit shprehu gatishmërinë që në të ardhmen të rritet bashkëpunimi me institucionet e BIK-ut, si dhe të shtohet bashkërendimi dhe mbështetja për këto institucione.

Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan lart raportet dhe bashkëpunimin ndër-institucional.



VIZITA NË DREJTORINË E BOTIMEVE FETARE NË ANKARA

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, më 21 prill 2026, vizitoi Drejtorinë e Përgjithshme të Botimeve Fetare – Departamentin për Botime në Gjuhë të Huaja në kuadër të DIJANET-it të Turqisë, ku u prit nga drejtori Şükrü Çetin me bashkëpunëtorë.

Gjatë takimit, Myftiu u njoh me veprimtarinë botuese në gjuhë të huaja, planet zhvillimore dhe shpërndarjen ndërkombëtare të botimeve. Theks i veçantë iu kushtua përkthimit të Kuranit në gjuhë të ndryshme, ndërsa u bë e ditur se është në përgatitje edhe botimi i përkthimit në gjuhën shqipe nga myderrizi Haxhi Sherif Ahmeti, i cili pritet të dalë së shpejti si një botim cilësor.



Myftiu Tërnavë vlerësoi punën e këtij institucioni në botimin e literaturës islame në gjuhë të huaja, duke theksuar rëndësinë e shpërndarjes së Kuranit fisnik dhe nevojën që përkthimi në shqip të jetë sa më cilësor.

Gjatë qëndrimit në Ankara, delegacioni vizitoi edhe ambientet e “Diyanet TV”, ku u njoh me projektet dhe programet e këtij televizioni.

VIZITA NË FONDACIONIN “MÜSDAV” NË ANKARA



Më 22 prill 2026, në kuadër të vizitës zyrtare në Ankara, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, vizitoi fondacionin turk për bashkëpunim ndërkombëtarë “MÜSDAV”.

Delegacioni u prit nga drejtuesit e fondacionit, në krye me Bunjamin Albayrak, ish-këshilltar për çështje fetare në Ambasadën e Turqisë në Prishtinë dhe njohës i afërt dhe përkrahës i shqiptarëve.

Gjatë takimit, Myftiu u njoh me aktivitetet dhe projektet e fondacionit në mbështetje të komuniteteve myslimane në vende të ndryshme të botës. Ai shprehu mirënjohje për angazhimin e tyre, ndërsa të dyja palët u dakorduan të shqyrtojnë mundësitë për bashkëpunim në fusha si kultura, arsimi, teknologjia dhe turizmi.

Përgatiti: Ramadan Shkodra

MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARI I FERIZAJT



Më 2 prill 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tij, u prit në takim nga kryetari i Ferizajt, z. Agim Aliu.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet dy institucioneve, si dhe për intensifikimit e këtij bashkëpunimi në të ardhmen, gjithnjë për të mirën e qytetarëve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM IMAMIN E XHAMISË “BASHKIMI”, SEVGANI EF. ASANIN

Më 3 prill 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim imamin e xhamisë shqiptare “Bashkimi” në Nuremberg të Gjermanisë, Sevgani ef. Asanin, i cili shoqërohej nga bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë këtij takimi u bisedua për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe xhamive shqiptare në diasporë, si dhe për mundësitë e thellimit të këtij bashkëpunimi, gjithnjë për të mirën e përbashkët të besimtarëve tanë në diasporë.



Myftiu Tërnavë falënderoi imamin Asanin dhe, nëpërmjet tij, edhe të gjithë imamët, kryetarët e qendrave dhe përfaqësuesit e xhamive në diasporë për

angazhimin dhe kontributin e tyre në kultivimin, ruajtjen dhe përcjelljen e traditave fetare e kombëtare të bashkëatdhetarët tanë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DOM STEPHAN FORSTER

Më 7 prill 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në një takim dom Stephan Forster, famullitar dhe njëkohësisht prodekan në Dekanatin Laaber-Regenstauf të Dioqezës së Regensburgut në Gjermani.

Gjatë këtij takimi, u diskutua për rëndësinë e bashkëjetesës ndërfaqetare në Kosovë, duke theksuar traditën e vyer të popullit tonë për harmoni dhe respekt të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve fetare.

Myftiu Tërnavë vuri në pah rolin e rëndësishëm që luan Bashkësia Islame



e Kosovës në kultivimin dhe forcimin e kësaj bashkëjetese, përmes angazhimeve të vazhdueshme në promovimin e dialogut, mirëkuptimit dhe tolerancës.

Nga ana e tij, dom Stephan Forster, vlerësoi lart modelin e bashkëjetesës ndërfaqetare në Kosovë, duke e konsideruar atë si një shembull të mirë për rajonin dhe më gjërë.

U INAUGURUA PROGRAMI PËR SHPËRNDARJEN E HURMAVE

Më 7 prill 2026, Bashkësia Islame e Kosovës, në bashkëpunim me Qendrën e Mbretit Selman të Arabisë Saudite, kanë inauguruar programin e ri për shpërndarjen e 25 ton hurmave në Kosovë.

Në hapje të këtij programi mori pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, Fejsal Hivzi, të cilët edhe nënshkruan marrëveshjen e pranimit-dorëzimit.

Në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, Myftiu Tërnavë falënderoi Arabinë Saudite për një bashkëpunim të shkëlqyer dhe një mbështetje të vazhdueshme përgjatë viteve.

“Vetë ky program humanitar dhe prania e ambasadorit janë një mesazh i qartë i miqësisë që ekziston mes dy popujve. Pavarësisht distancës fizike, ne e ndiejmë afërsinë, prezencën dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme. Falë institucioneve përkatëse në Riad, edhe



kjo ndihmë e madhe, vjen në një kohë të rëndësishme dhe me një simbolikë të veçantë për popullin tonë. Kjo nuk është thjesht mbështetje materiale, ajo përfaqëson një dëshmi të gjallë të vëllazërisë dhe miqësisë sonë” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Nga ana e tij, ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, Fejsal Hivzi, u shpreh se: “Mbretëria e Arabisë Saudite, nën udhëheqjen e Kujdestarit të Dy Xha-

mive të Shenjta, e mbështet këtë program të dhurimit të hurmave, në veçanti për Kosovën si një vend mik dhe i afërt për ne. Kjo dhuratë është vetëm një dëshmi e vogël për marrëdhëniet tona shumë të mira në shumë fusha, ku edhe kemi një bashkëpunim të shkëlqyer me Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës.”

TELEGRAM NGUSHËLLIMI

Me dhembshuri mora lajmin për ndarjen nga jeta të mikut të madh të popullit tonë, kongresistit të shquar amerikan Eliot Engel.

Ai nuk ishte thjesht një mbështetës i çështjes shqiptare, por një zë i fuqishëm, i palodhur dhe i sinqertë, që qëndroi pranë nesh në momentet më të vështira të historisë sonë. Në kohën kur Kosova kishte më së shumti

nevojë për miq, ai ishte ndër të parët që na besoi, na dha kurajë dhe ngriti zërin për të drejtën tonë.

Kam pasur nderin dhe privilegjin ta takoj disa herë, si në Prishtinë ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara, dhe çdo takim me të mbetet kujtim i veçantë dhe frymëzim i thellë. Fjalët e tij ishin gjithmonë të mbushura me mençuri,

shpresë dhe një përkushtim të rrallë e të sinqertë për të ardhmen e Kosovës.

Humbja e tij është e madhe për popullin tonë. Ne humbëm një mik të çmuar, një përkrahës të palëkundur dhe një zë që nuk u lodh kurrë së mbrojturi të vërtetën dhe drejtësinë për Kosovën.

Megjithatë, trashëgimia e tij do të jetojë gjatë në kujtesën dhe rrugëtimin tonë, si dritë që na udhëzon drejt forcimit të shtetit dhe së ardhmes sonë.

Kosova do ta kujtojë përjetë me mirënjohje të thellë, respekt dhe dashuri mikun e saj të madh, kongresistin Eliot Engel.

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 13 prill 2026



U MBAJT TRYEZA E DIALOGUT NDËRFETAR ME TEMË “BASHKËJETESA NDËRFETARE NDËR NE, VIRTYT HYJNOR APO DOMOSDOSHMËRI SHOQËRORE”



Më 16 prill 2026, organizuar nga Fondacioni “Drita”, në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, u mbajt Tryeza e dialogut ndërfetar me temën “Bashkëjetesa ndërfetare ndër ne, virtyt hyjnor apo domosdoshmëri shoqërore”, e cila rreth vetes mbloodhi përfaqësues të komuniteteve fetare, institucioneve dhe jetës publike në vend.

Kjo tryezë u mbajt për vitin e dytë me radhë, ndërsa kësaj here nikoqire ishte Bashkësia Islame e Kosovës.

Nikoqiri i kësaj Tryeze, Myftiu Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij përshëndetëse tha se respektimi i besimit të tjetrit nuk është vetëm vlerë shoqërore, por edhe mësim nga i Dërguari i Zotit. Ai tha se kjo nismë përfaqëson një vlerë të çmuar dhe një përpjekje të sinqertë për të afirmuar dimensionin hyjnor dhe njerëzor të bashkëjetesës. “Ne jemi sot këtu për të reflektuar mbi një realitet që populli ynë e ka ndërtuar ndër shekuj: harmoninë dhe mirëkuptimin ndërfetar” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, tha se diversiteti ndërfetar mbetet një nga shtyllat themelore të Kosovës, duke vlerësuar kështu rolin dhe kontributin e prijësve fetarë për kultivimin

e bashkëjetesës dhe tolerancës ndërfetare.

Zef Gashi, kryetar i Fondacionit “Drita”, tha se organizimi dhe mikpritja kaq e ngrohtë nga Bashkësia Islame e Kosovës është dëshmia më e mirë e frymës bashkëpunuese dhe tolerancës ndërfetare në Kosovë.

Përfaqësuesi i KFOR-it, kapelani Hornback, tha se prijësit fetarë janë ata që kanë fuqinë të bashkojnë njerëzit dhe të shmangin ndarjet mbi baza fetare, duke shtuar se në Kosovë qytetarët e kanë bërë të ndihet si në shtëpinë e tij, duke i dhënë një shembull të bashkëjetesës.

Tryeza e dialogut ndërfetar, tashmë në edicionin e saj të dytë, për synim kishte forcimin e mëtejshëm të frymës së tolerancës dhe bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve fetare në Kosovë, duke e kthyer këtë vlerë në një shembull për rajonin dhe më gjerë.

Në kuadër të Tryezës u mbajtën tri panele, të cilat prekën disa prej elementeve kryesore të bashkëjetesës dhe tolerancës ndër fetare në vendin tonë.

Në panelin e parë e titulluar “Përvoja e dialogut rreth nesh”, përfaqësues të komuniteteve të ndryshme fetare nga rajoni ndan përvojat e tyre mbi dialogun ndërfetar dhe sfidat që e shoqërojnë atë.

Në këtë panel u paraqitën këndvështrime nga Kisha Katolike, Bashkësia Islame dhe Kisha Protestante, duke sjellë shembuj konkretë të bashkëpunimit dhe bashkëjetesës në kontekste të ndryshme shoqërore.

Në panelin e dytë, i cili trajtoi në mënyrë më të thelluar vetë temën e tryezës. Përfaqësues të komuniteteve islame, katolike, ortodokse dhe protestante, si dhe nga fusha akademike, ofruan analiza dhe reflektime mbi rolin e fesë në shoqëri, duke e parë bashkëjetesën ndërfetare si një vlerë identitare, por edhe si një nevojë të domosdoshme për stabilitetin dhe zhvillimin shoqëror.

Paneli i tretë ishte një panel i hapur i dialogut ndërmjet liderëve fetarë, ku u shkëmbyen ide dhe qëndrime mbi forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve fetare në Kosovë. Në këtë panel mori pjesë, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, Sh.T Dodë Gjergji nga Kisha Katolike, Artur Krasniqi nga Kisha Protestante Ungjillore dhe Andrej Sajc nga Kisha Ortodokse.

Kjo Tryezë u përmbyll me leximin e një rezolute ku mes të tjerash të gjithë prijësit fetarë u zotuan se do të punojnë në drejtim të bashkëjetesës pa dallime fetare dhe në veçanti drejt paqes dhe larg gjuhës së urrejtjes.

U MBAJTËN GARAT E MEMORIZIMIT TË KURANIT FISNIK NË VENDET E BALLKANIT

Më 18 dhe 19 prill 2026, organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, në bashkëpunim me Ambasadën e Arabisë Saudite në Sarajevë, përkatësisht me Ministrinë për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, u mbajtën Garat e memorizimit të Kuranit për vendet e Ballkanit, përkatësisht për Kosovë. Ky aktivitet, me karakter fetar, edukativ dhe kulturor, dëshmoi edhe njëherë përkushtimin institucional ndaj ruajtjes dhe kultivimit të traditës së mësimit përmendsh të Kuranit fisnik.

Në këto gara morën pjesë gjithsej 85 garues nga e gjithë Kosova, të cilët garuan në memorizimin e dy, pesë dhe dhjetë xhuzave nga Kurani fisnik. Pjesëmarrja e tyre ishte dëshmi e dashurisë së madhe që brezat e rinj kanë për Librin e Allahut, si dhe e punës së palodhshme të mësuesve, imamëve dhe familjeve në përgatitjen e tyre.

Në ceremoninë përmbyllëse mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fejsal Hifzi, atasheu për Çështje Fetare nga Arabia Saudite në Sarajevë, Abdulatif Husejn, garuesit pjesëmarrës, familjarët e tyre, si dhe mysafirë të tjerë.

Myftiu Tërnavë, në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve, tha se memorizimi i Kuranit është një prej traditave fisnike të popullit tonë, e cila me përkushtim dhe dashuri vazhdon edhe në ditët e sotme. Ai theksoi se hafëzët dhe nxënësit e Kuranit janë pasuri shpirtërore e shoqërisë sonë dhe shembull frymëzimi për brezat e ardhshëm.

Ambasadori i Arabisë Saudite, z. Fejsal Hifzi, tha se organizimi i përbashkët me Bashkësinë Islame të Kosovës dëshmon më së miri përkushtimin ndaj Kuranit fisnik, si dhe lidhjet e mira të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve fetare dhe diplomatike në shërbim të vlerave të përbashkëta islame.



Në fund të garave, u shpallën edhe fituesit e tri vendeve të para në secilën prej tri kategorive, atë të mësimit përmendsh të dy, pesë dhe dhjetë xhuzave nga Kurani fisnik. Ceremonia e shpalljes së fituesve u përcoll me emocione të veçanta, duartrokitje dhe urime për të gjithë pjesëmarrësit.

Në kategorinë e mësimit përmendsh të dy xhuzave, nga djemtë, i pari doli Abdurrahman Sadiku, vendin e dytë e zuri Rejan Morina, ndërsa vendin e tretë Enis Elshani.

Muhamed Morina zuri vendin e parë në mësimin përmendsh të pesë xhuzave, ndërsa Daris Smajli dhe Butrint Sylja zunë vendin e dytë, respektivisht të tretin.

Ndërsa Amar Gjokolli doli fitimtar në kategorinë e mësimit përmendsh të dhjetë xhuzave, teksa Enfal Dërmaku zuri vendin e dytë dhe Ahmed Maloku të tretin.

Sa i përket kategorisë së mësimit të dy xhuzave, nga vajzat, vendin e parë e zuri Arjeta Avdulli, ndërsa vendin e dytë dhe të tretë Merjemi Qazimi dhe Aksa Shaqiri.

Semra Bashani ishte e para në kategorinë e mësimit përmendsh të pesë xhuzave, ndërsa Daria Smajli dhe Erva Dërguti zunë vendin e dytë, respektivisht të tretin.

Në kategorinë e mësimit të dhjetë xhuzave, e para doli Ediona Murati, vendin e dytë e fitoi Suhejla Franca, ndërsa vendin e tretë Hana Maloku.

E veçanta e këtyre garave ishte pjesëmarrja e 5-vjeçarit nga Prishtina, Shuajb Rrahmani, i cili garoi në kategorinë e mësimit përmendsh të dy xhuzave. Pjesëmarrja e tij u vlerësua si një shembull i bukur i dashurisë së hershme për Kuranin dhe si nxitje për fëmijët e tjerë që të afrohen me mësimin e tij.

Në fund të garës, gjithë pjesëmarrësit u pajisën me certifikatë pjesëmarrjeje, duke ua rikujtuar edhe njëherë se në garën për mësimin përmendsh të Kuranit, të gjithë pjesëmarrësit, në një formë apo tjetër, janë fitimtarë. Ky aktivitet u përmbyll me urime, mirënjohje dhe me shpresën që gara të tilla të vazhdojnë edhe në të ardhmen, duke nxitur dashurinë për Kuranin dhe edukimin fetar të brezave të rinj.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM LAMTUMIRËS Z. FEJSAL HIFZI

Më 19 prill 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në një takim lamtumirës ambasadorin e Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fejsal Hifzi, i cili shoqërohej nga atasheu për Çështje Fetare i Arabisë Saudite në Sarajevë, Abdulatif Husejn.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë e falënderoi ambasadorin Hifzi për bashkëpunimin e deritanishëm, duke vlerësuar mbështetjen e tij të vazhdueshme në realizimin e projekteve me karakter fetar, arsimor dhe humanitar. Ai çmoi lart angazhimin dhe përkushtimin e ambasadorit gjatë misionit të tij diplomatik, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe të marrëdhënieve të mira ndër-institucionale në projekte të ndryshme me interes të përbashkët

Myftiu Tërnavë po ashtu nënvizoi se kontributi i ambasadorit Hifzi ka qenë



i rëndësishëm në forcimin e lidhjeve të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse, veçanërisht në fushat që lidhen me jetën fetare, arsimin dhe përkrahjen humanitare.

Në fund të takimit, Myftiu Tërnavë i uroi ambasadorit Fejsal Hifzi suksese të mëtejshme, shëndet dhe punë të mbarë në misionet dhe angazhimet e tij të ardhshme.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E TIKA-S, Z. YAHYA COŞKUN

Më 24 prill 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim nënkryetarin e TIKA-s, z. Yahya Coşkun, i cili shoqërohej nga koordinatoreja, znj. Fuliya Aslan.

Gjatë këtij takimi, u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe TIKA-s, si dhe për mundësitë e zgjerimit të tij në fusha me rëndësi të veçantë institucionale dhe shoqërore

Myftiu Tërnavë i falënderoi përfaqësuesit e TIKA-s për përkushtimin, punën dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme në projekte të rëndësishme për vendin tonë, duke vlerësuar lart projektet e realizuara dhe kontributin e çmuar në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore e fetare.

Po ashtu, pjesë e diskutimit ishte edhe projekti i radhës, restaurimi i Xhamisë së Bajraklisë në Prizren, projekt ky që



synon ruajtjen e një prej objekteve me vlerë të veçantë historike, kulturore dhe fetare për Kosovën.

Të dyja palët shprehën gatishmërinë për thellimin e mëtejshme të bashkë-

punimit dhe realizimin e projekteve të tjera në të ardhmen, në shërbim të ruajtjes së trashëgimisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm institucional.

MYFTIU TËRNAVA NDAU MIRËNJOHJE PËR IMAMIN XHEVAT EF. FETAHI

Më 27 prill 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ndau mirënjohje për imamin e njohur nga Bresana e Dragashit Xhevat ef. Fetahi, si imam i dalluar i vitit me motivacionin për kontributin e tij në shërbim të fesë dhe besimtarëve.

Imami Xhevat ef. Fetahi shquhet për përkushtimin e tij të madh në shërbim të xhematit me punë të palodhshme, sidomos në fushën e mësim-besim për çfarë kishte fituar edhe garat republikane të mësim-besimit.

Si një nga imamët më të rregullt, që nuk mungon në asnjë vakt të namazit

në xhaminë e njohur historike të Kukli begut, ka fituar zemrat e gjithë besimtarëve që prej kur ka filluar punën si imam në shërbim të xhamisë e besimtarëve e deri më sot.

Shembulli i Xhevat ef. Fetahit është modeli më i mirë i një imami, i cili me devotshmërinë e modestinë e tij frymëzon gjeneratat e reja të imamëve të cilët dëshirojnë t'i shërbejnë fesë, besimtarëve e atdheut.

Lusim Zotin e Madhëruar që Xhevat ef. Fetahit t'i falë shëndet e mbarësi në jetë, e t'i shtojë njerëzit si ai.



U PROMOVUA MONOGRAFIA “MYDERRIZ HAKI EFENDIU”

Më 28 prill 2026 është promovuar monografia “Myderriz Haki efendiu”, kushtuar jetës dhe veprës së myderriz Haki ef. Sermaxhajt, me autorë Aliriza Selmani dhe hfz. Avni Aliu. Ky ribotim rikthen në vëmendje një nga figurat e rëndësishme të dijes, besimit dhe çështjes kombëtare.

Në promovimin e kësaj monografie morën pjesë personalitete të jetës fetare, akademike dhe publike, të cilët vlerësuan lart figurën dhe kontributin e Haki efendiut. Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan, Naim Aliu, tha se Haki efendiu zë një vend të veçantë në histori, duke e cilësuar si shembull të besimit dhe sakrificës.

Kryetari i Gjilanit, z. Alban Hyseni, theksoi se trajtimi i figurave të tilla është i nevojshëm, pasi ato përfaqësojnë sakrificën e njerëzve që jetën ia kushtuan besimit dhe atdheut.

Në fjalën e tij, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, e cilësoi Haki efendiun si personalitet të rrallë, që mishëronte intelektin, besimin dhe dashurinë për atdheut. Ai tha se figura e Haki efendi Sermaxhës përfaqëson trinomin themelor të identitetit tonë kolektiv: arsimimin, besimin dhe atdhedashurinë. “Ai përfaqëson tipologjinë e dijetarit erudit që lindi dhe u formësua në gjirin e popullit, duke ia kushtuar jetën edukimit të brezave, konsolidimit të identitetit fetar dhe ruajtjes së vetëdijes kombëtare” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Panelistja Sabile Keqmezi-Basha u ndal te dimensionin historik i figurës së Haki efendiut, duke theksuar se historia e tij nuk është vetëm individuale, por dëshmi e qëndresës kolektive. Ajo vlerësoi se ribotimi i kësaj monografie është i domosdoshëm për të mos u harruar e kaluara.

Ramadan Shkodra foli për rolin e tij në arsim, duke theksuar se nga puna e Haki efendiut dolën nxënës të shumtë që kontribuan në shoqëri, si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë kombëtar.

Bashkautorit Aliriza Selmani tha se nuk është e lehtë të përshkruhet jeta dhe vepra e një figure të tillë, ndërsa Irfan Sermaxhaj, djali i tij, u shpreh mirënjohës që figura e prindit të tij po vlerësohet vazhdimisht.

Myderriz Haki ef. Sermaxhaj nga Hogoshti ishte dijetar, edukator dhe veprimtar i çështjes kombëtare. Pas Luftës së Dytë Botërore, ai u përfshi në përpjekjet për liri dhe bashkim kombëtar, duke u dalluar si organizator dhe udhëheqës. U arrestua në vitin 1946 dhe u dënua me 20 vjet burg. Vdiq në burgun e Mitrovicës së Sremit në vitin 1948.

Figura dhe kontributi i tij vazhdojnë të kujtohen si shembull i dijes, besimit, sakrificës dhe përkushtimit ndaj atdheut.



DREJTORIA E HAXHIT MBAJTI TAKIM ME UDHËHEQËSIT E HAXHILERËVE

Më 15 prill 2026, në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, u mbajt takim ndërmjet udhëheqësve të Haxhit të Kryesisë së BIK-ut dhe udhëheqësve të haxhilerëve nga Këshillat lokalë

Kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, njëherësh drejtor i Haxhit në Kryesinë e BIK-ut, kërkoi nga udhëheqësit që të shtojnë përkushtimin në shërbim të haxhilerëve dhe të jenë të gatshëm t'u përgjigjen me përgjegjësi kërkesave dhe nevojave të tyre gjatë këtij udhëtimit shpirtëror.

Ai theksoi rëndësinë e koordinimit ndërmjet Kryesisë dhe Këshillave lokalë, me qëllim të një organizimi sa



më të suksesshëm dhe një përvojë të dinjitetshme për haxhilerët në vendet e shenjta. Gjatë takimit u diskutuan edhe çështje që lidhen me përgatitjet logjistike, udhëzimet fetare dhe kujdesin ndaj haxhilerëve.

Ky takim u mbajt në prag të përgatitjeve finale për Haxhin 2026, duke dëshmuar angazhimin e BIK-ut për organizim të përkushtuar dhe të suksesshëm.

KRYEIMAMI SAHITI TAKOI KRYEIMAMËT E KËSHILLAVE TË BI-SË

Më 7 prill 2026, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, zhvilloi një takim pune me kryeimamët e Këshillave të BI-së së Kosovës.

Gjatë takimit u diskutua për aktivitetet e realizuara gjatë muajit të Ramazanit dhe u vlerësua angazhimi i kryeimamëve, imamëve dhe mualimeve në organizimin e jetës fetare, shërbimeve për besimtarët dhe edukimin fetar të gjeneratave të reja.

Kryeimami Sahiti shprehu mirënjohje për përkushtimin dhe punën e palodhshme të kryeimamëve, duke i inkurajuar që të vazhdojnë angazhimin për mirëqenien shpirtërore dhe sociale të besimtarëve, me përgjegjësi, sinqeritet dhe përkushtim të vazhdueshëm.



KA FILLUAR RESTAURIMI I XHAMISË SË VJETËR TË ORLLANIT

Xhamia e vjetër e Orllanit, e ndërtuar në shekullin XVIII, ndërsa me strukturë ekzistuese që nga vitet '60, ka filluar që të restaurohet. Restaurimi synon ta ruajë xhaminë në gjendjen ekzistuese si strukturë arkitekturore, duke mbrojtur edhe gjurmët e saj si dëshmi historike për brezat që vijnë.

Më 24 prill 2026, ministrja e Kulturës dhe Turizmit, znj. Saranda Bogujevci, e shoqëruar edhe nga kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, vizituan dhe panë nga afër objektin e xhamisë së vjetër në Orllan.

Pas përfundimit, objekti do të funksionalizohet dhe muzealizohet si hapësirë e vizitueshme për komunitetin dhe vizitorët, me karakter prezantues të historisë së saj dhe xhamive të tjera të shkatërruara gjatë luftës.

Kujtojmë se gjatë luftës së fundit më 1999, xhamia u dogj tërësisht nga forcat serbe dhe ka mbetur në gjendje të rënduar deri sot.



Ky restaurim po mundësohet nga Ministria e Kulturës dhe Turizmit në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës.

KRYEIMAMI SAHITI U PRIT NË TAKIM NGA MINISTRJA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Më 29 prill 2026, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, u prit në një takim nga ministrja e Kulturës dhe Turizmit, znj. Saranda Bogujevci.

Në këtë takim u diskutua për bashkëpunimin në fushën e trashëgimisë kulturore islame dhe për restaurimin e xhamive të vjetra, si dhe për projektet që janë duke u realizuar bashkë në disa qytete të vendit, si dhe për planet për vazhdimin e këtij bashkëpunimi.

Gjatë takimit u theksua edhe rëndësia e ruajtjes së kësaj trashëgimie për brezat e ardhshëm.



DREJTORIA E FINANCEVE MBAJTI MBLEDHJE ME ARKËTARËT E KËSHILLAVE TË BI-SË

Më 21 prill 2026, Drejtoria e Financave në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti takim pune me arkëtarët e Këshillave të BI-së nga e gjithë Kosova, ku u diskutua procesi i digjitalizimit të anëtarësisë.

Drejtori i Financave, z. Tanseli Rogova, në emër të Myftiut Naim ef. Tërnavë, përgëzoi arkëtarët për përkushtimin e tyre në menaxhimin financiar dhe administrativ.

Gjatë takimit u prezantua aplikacioni i ri për digjitalizimin e anëtarësisë, i cili synon lehtësimin e evidentimit, rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e shërbimeve për besimtarët.



DREJTORI SIMNICA MORI PJESË NË TURBINËN ISLAME ME TEMË “ÇDO KONTRIBUT ËSHTË DRITË PËR TË ARDHMEN”

Më 26 prill 2026, me ftesë të Qendrës Islame Shqiptare “Drita” në Blaubeuren të Gjermanisë, drejtori për Diasporë në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, mori pjesë në tribunën islame me temën “Çdo kontribut është dritë për të ardhmen”.

Në këtë organizim morën pjesë përfaqësues të jetës fetare nga vendlindja dhe diaspora, duke dëshmuar angazhimin dhe unitetin e komunitetit shqiptar mysliman në Evropë.

Drejtori Simnica përshëndetjet e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të Myftiut Naim ef. Tërnavë, ndërsa foli për rëndësinë e xhamive në diasporë si qendra të ruajtjes së fesë, identitetit dhe bashkimit shpirtëror. Ai uroi kryetarin e xhamisë, z. Sadulla Xhemaili, sekretarin z. Shemsi Tahiri, imamin, Kryesinë dhe xhematin për



blerjen e xhamisë, duke shpresuar që ajo të jetë pikëbashkimi dhe fuqizimi për komunitetin shqiptar në Blaubeuren.

Edhe kësaj radhe, shqiptarët e Blaubeurenit dhe më gjerë dëshmuar

zemërgjerësinë dhe gatishmërinë për të kontribuar për shtëpitë e Allahut.

Në fund u shkëmbyen dhurata dhe mirënjohje për këtë xhami, të cilat i pranuan kryetari Sadulla Xhemaili dhe sekretari Shemsi Tahiri.



- "Etika e Besimtarit të Ri" me ilustrime për fëmijë, nga Dr. Zenel Hajdini, botuar nga Dituria Islame, është një libër edukativ që synon formimin moral dhe shpirtëror të fëmijëve në frymën e vlerave islame. Përmes temave të afërta me botën e tyre, fëmijët mësojnë si të sillen me familjen, shokët dhe fqinjët, si të respektojnë rregullat e rrugës, edukatën e bisedës, thjeshtësinë në veshje, sjelljen e mirë gjatë lojës dhe kujdesin për mjedisin si amanet nga Allahu.
- Çdo temë është trajtuar me gjuhë të thjeshtë, të butë dhe të kuptueshme për moshën e fëmijëve, e shoqëruar me ilustrime tërheqëse që ua afrojnë mesazhin edhe më shumë. Veçantia e këtij libri qëndron edhe në faktin se në fund të çdo njësie janë përfshirë pyetje, detyra dhe pjesë argëtuese, të cilat e bëjnë leximin më tërheqës, më praktik dhe më të dobishëm për fëmijët.
- Ky libër është i përshtatshëm si për përdorim në shtëpi, ashtu edhe si material ndihmës për mësim-besim në xhami, duke qenë një mjet i vlefshëm në edukimin e brezit të ri me besim, moral dhe kulturë të mirë.
- Librin e gjeni në librarinë "Dituria Islame" në rrugën "Bajram Kelmendi"
- Mund të bëni porosinë online. në adresen: https://www.facebook.com/librariadituriaislame/?ref=page_internal.

DITURIA ISLAME • Nr. 426 MAJ 2026